

UDHËZUES PËR PROCEDURËN E KONFLIKTIT ADMINISTRATIV

Përgatitur nga:

Hasan Shala - Kryetar i Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe
Delushe Halimi - Gjyqtare e Gjykatës së Apelit të Kosovës

Prishtinë, 2020

I publikuar nga

Akademia e Drejtësisë së Kosovës

Autorët:

Hasan Shala, Delushe Halimi

© 2020 Hasan Shala, Delushe Halimi dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës

Të gjitha të drejtat rezervohen. Akademia e Drejtësisë së Kosovës dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH nuk pranojnë kurrfarë përgjegjësie për përmbajtjen e pasqyruar dhe nuk janë përgjegjës për aktualitetet, korrektësinë, tërësinë apo cilësinë e informacioneve të paraqitura. Prandaj do të refuzohen të gjitha pretendimet rreth dëmit të shkaktuar nga shfrytëzimi i informatave të dhëna, përfshirë edhe informatat të cilat janë të pakompletuara apo të pasakta.

Informacion

Të drejtat e autorit për materialet e krijuara nga autorët dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës janë të rezervuara. Nuk lejohet kopjimi / shumëzimi i materialit apo shfrytëzimi i objekteve, siç janë imazhet etj. në publikimet e tjera pa pëlqimin shprehimor nga Akademia e Drejtësisë së Kosovës dhe autorët.

Nëse ndonjë pjesë apo shprehje individuale në tekst nuk është e ligjshme apo korrekte, përmbajtja apo vlefshmëria e pjesëve të tjera mbetet e paprekur nga ky fakt.

Shtypur në Prishtinë

Hartimi dhe botimi i kësaj Përmbledhje është mundësuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH, Projekti për Reformë Ligjore dhe Administrative në Kosovë, në emër të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (BMZ) dhe Akademia e Drejtësisë së Kosovës.

PARATHËNIE

Konflikti Administrativ - është një procedurë gjyqësore e cila udhëhiqet nga gjyqësori duke përfshirë tre shkallëshmërinë në gjykata, dhe në të njëjtën kohë përpos shqyrtimit të ligjshmërisë së vendimeve të organeve administrative, të cilën procedurë e zhvillon përmes padive të cilat ushtrohen nga palët e pakënaqura kundër një vendimi përfundimtar në procedurë administrative në të njëjtën kohë është një procedurë e cila shërben edhe si Instrument për kontroll të punës së organeve administrative gjatë vendosjes lidhur me kërkesat e palëve me rastin e shqyrtimit të kërkesës e deri te marrja e vendimit ku në këtë procedure edhe vlerësohet ligjshmëria e akteve administrative, e që edhe i jep rëndësinë e institucionit të veçantë Konflikti Administrativ, si garancion në realizimin e të drejtave dhe interesave të qytetarëve në një procedurë të veçantë dhe nga një organ i pavarur gjyqësor dhe procedurë gjyqësore. Udhëzuesi ka ardhur në shprehje për tu punuar dhe hartuar si rezultat i nevojës për të siguruar literature lidhur me procedurën e konfliktit administrative, e cila procedurë zhvillohet në gjykatë mirëpo përveç Ligjit për Konfliktet Administrative nr. 03/L-2012 i shpallur në Gazetën zyrtare në Tetor 2010, nuk kemi hasur në ndonjë botim apo modul i cili do të ishte i dobishëm për interesin e qytetarëve avokatëve apo edhe gjyqtarëve të cilët merren me këtë procedure në punën e tyre. Përmbajtja e këtij udhëzuesit është edhe në harmoni me procedurën e cila edhe aktualisht zhvillohet në Gjykatë por edhe me Ligjin aktual në fuqi.

Përmes këtij udhëzuesi do të trajtohen përveç procedurës gjyqësore e cila zhvillohet në gjykatën e shkallës së parë, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, do të sqarohen edhe mjetet e rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike e cila si procedure zhvillohet në gjykatën e shkallës së dytë Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme, si shkallë e tretë.

Qëllimi i hartimit të këtij udhëzuesi sa i përket procedurës së konfliktit administrative është që të krijohet një material në mënyrë që të lehtësojë punën e gjykatave në këtë procedure, si dhe të gjithë akterve të cilët merret në një mënyrë ose tjetër me procedurën e konfliktit administrative, e me këtë formë të njohurive do të mund të mbikëqyret në mënyrë më të lehtë se Organet administrative në përmbushje të detyrave të tyre a i kanë respektuar të drejtat dhe detyrat e tyre ligjore gjatë vendosjes lidhur me një të drejtë të qytetarit ose palës në procedure administrative, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre. Të respektosh të drejtat e njeriut në nivel administrativ do të thotë që administrata të veprojë në përputhje me standardet e kërkuara kushtetuese për një veprimtari administrative. Organet administrative duhet të respektojnë dhe zbatojnë parimet kushtetuese, që me veprimtarinë e tyre të mundësojnë ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe shtetit demokratik për të garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Përfundim edhe atëherë kur organet administrative nuk respektojnë dhe zbatojnë ligjin duke cenuar të drejtën e njeriut, duke vepruar në kundërshtim me Ligjin e procedurës

së përgjithshme Administrative dhe Ligjeve të natyrave të çështjeve që rregullojnë materien përkatëse.

Ligji për Konfliktet Administrative ka paraparë mbrojtjen gjyqësore përmes parashtrimit të padisë në konfliktin administrative, për të shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të organit administrative, të secilës natyrë të çështjes e cila hynë në domenin e çështjeve që krijon një raport administrativo - juridik.

Ky udhëzues qëllim kryesorë e ka tu shërbejë gjykatave, organeve administrative, avokatëve, si dhe juristëve dhe njohësve të kësaj natyre në përgjithësi por edhe studentëve në Universitet, pasi që në këtë material do të sqarohet nocioni dhe kuptimi i Konfliktit Administrativ, e gjithë procedura gjyqësore në gjykatë e cila fillon me padi, e që gjatë zhvillimit të kësaj procedure lindin lloje të ndryshme të veprimeve procedural e të cilat veprime duhet të vendosen me një vendim gjyqësorë e me procesverbale të seancave gjyqësore e deri te marrja e vendimit përfundimtar, çoftë ai Aktvendim apo Aktgjykim, e për të cilën procedure nuk flitet dhe e njëjta përmbajtje nuk gjendet as në Librat dhe Literaturën e Universitetit, e as në Ligjet bazike aktuale të cilat janë në zbatim lidhur me çështjen e konfliktit administrative.

Andaj e vlerësojmë shumë përkrahjen dhe kontributin që GIZ-i, po bënë me botimin e këtij Udhëzuesi me një vlerë jashtëzakonisht të rëndësishëm me për plotësimin e punës praktike lidhur me procedurën dhe vendimmarrjen, hartimin dhe arsyetimin e akteve të ndryshme gjyqësore lidhur me procedurën e cila zhvillohet në konflikt administrativ, e cila ka shumë mungesë në implementimin e praktikës gjyqësore në bazë të legjislacionit i cili është aktualisht në fuqi, e që një udhëzues i tillë shumë i nevojshëm nuk ekziston akoma në dispozicion të akterëve që merren me këtë çështje.

Përmbajtja

Hyrje	7
Burimet	8
Konflikti Administrativ - Nocioni	9
Parimet themelore të Ligjit për Konfliktet Administrative.....	9
Konflikti Administrativ në Kuptimin Material dhe Formal.....	10
Objekti i Konfliktit Administrativ - Akti administrativ	11
Heshtja e administratës	13
Palët në Konfliktin Administrativ.....	13
Padia në Konfliktin Administrativ.....	14
Afati, Dorëzimi, Përmbajtja e Padisë.....	15
Format me shembuj të padive në Konfliktin Administrativ	17
Padia e parregullt	39
Forma-shembuj të Aktvendimeve procedurale për parregullsinë e padisë.....	40
Procedura Paraprake në Konfliktin Administrativ.....	62
Forma-shembuj të Aktvendimeve lidhur me çështjen paraprake.....	64
Seanca e shqyrtimit kryesor në Konfliktin Administrativ	66
Forma-shembuj të procesverbaleve të shqyrtimit gjyqësorë.....	68
Aktgjykimi në Konfliktin Administrativ	73
Forma-shembuj të Llojeve të aktgjykimeve në këtë procedurë	75
Mjetet Juridike në Konfliktin Administrativ	99
Forma-shembuj të Ankesës.....	101
Forma shembuj të vendimeve të Gjykatës së Apelit.....	106
Mjetet e Jashtëzakonshme në Procedurën e Konfliktit Administrativ	120
Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit	120
Forma-shembulli i kërkesës	121
Forma-shembuj të vendimeve të Gjykatës Supreme lidhur me kërkesën.....	124
Kërkesa për Mbrojtjen e Ligjshmërisë.....	133
Forma-shembulli i kërkesës	134
Forma-shembuj të vendimeve të Gjykatës Supreme për kërkesën	137
Rishikimi	146
Forma-shembulli i kërkesës për rishikim.....	148
Forma-shembuj të vendimeve gjyqësore lidhur me kërkesën për rishikim	151
Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të organit administrativ (masa e sigurisë)	158
Forma-shembulli i kërkesës	159
Format-shembuj të ankesës dhe Vendimeve të gjykatave të tri instancave lidhur me kërkesën.....	162
Përfundimi	183

H Y R J E

Më 16 shtator 2010, Kuvendi i Republikës së Kosovës, miratoi Ligjin nr. 03/L-202, i publikuar në gazetën zyrtare më 21 tetor 2010, i cili ka hyrë në fuqi 15 ditë pas shpalljes publike në gazetë zyrtare të Republikës së Kosovës, e me të cilin është rregulluar procedura gjyqësore për Konfliktet Administrative, i cili ligj edhe aktualisht vazhdon të jetë në fuqi.

Me qenë se ligjet zakonisht kanë vështirësinë e tyre në aplikimin e dispozitave ligjore gjatë punës së përditshme të gjyqtarëve në konfliktin administrativ, dhe nga vet fakti se numri i padive të cilat parashtrihen në gjykatë nga palët është mjaft i madhë dhe i llojeve të ndryshme, lidhur me çështje të ndryshme administrative, e që kanë qasje të vazhdueshme dhe kërkesa për një të drejtë ose detyrim, te një organ i caktuar publik e që janë të përditshme, lind nevoja e përgjigjes në këto lloj kërkesa dhe marrja e një numri të madh të akteve administrative, varësisht nga çështja e cila është në kërkesë ose në aktin e detyrueshëm.

Duke e pasur parasysh se në kohën në të cilën jemi duke vepruar kur kemi përball një ligj pothuajse të mangët sidomos sa i përket procedurës gjyqësore e cila zhvillohet në gjykatë lidhur me udhëheqjen e seancave gjyqësore dhe marrjes së vendimeve procedurale lidhur me veprimet e caktuara varësisht nga rrjedha e procedurës e cila zhvillohet, është më se e nevojshme për qartësimin dhe modifikimin e një praktike të llojit të tillë, në mënyrë që puna dhe zhvillimi i procedurës të bëhet më i lehtë për gjyqtarët dhe atyre që janë pjesë e procedurës në konflikt administrativ si dhe për qytetarët (personave fizik dhe juridik) palë në procedurë gjyqësore, për të pasur në dispozicion një udhëzues për të realizuar sa më lehtë dhe më shpejtë të drejtën e tyre të kërkuar ose për të kundërshtuar një detyrim të caktuar nga organi administrativ.

Në këtë udhëzues përdoren metodat e shpjegimit, duke u bazuar në raste dhe duke përdorur shembuj konkret. Materiali i këtij udhëzuesi do t'iu shpërndalet gjithë gjyqtarëve, avokatëve, organeve administrative e veçanërisht atyre që merren me çështjen e konfliktit administrativ, e të cilët do ta zbatojnë drejtë për drejtë për punën e tyre, i cili material do të përmban, nocione, akte të ndryshme për të gjithë procedurën e cila zhvillohet në gjykatë, komente, shënime, shembuj praktik mbi parimet dhe rregullat kryesore të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Burimet:

Për përgatitjen e këtij Udhëzuesi janë shfrytëzuar këto materiale:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji për Konfliktet Administrative;
- Praktika gjyqësore në konfliktin administrativ, e deri tanishme në Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës.

KONFLIKTI ADMINISTRATIV - NOCIONI

Konflikti administrativ lind si rrjedhojë e marrëdhënieve juridike administrative në rastin kur me aktin administrativ përfundimtar të organit shtetëror, është shkelur ligji në dëm të personit fizik apo personit juridik.

Me aktin administrativ përfundimtar pala e pakënaqur kundër vendimit përfundimtar, nuk mund të përdor mjete të rregullta juridike atëherë lind konflikti midis palës dhe organit të cilin e ka nxjerr aktin administrativ përfundimtar. Ky konflikt lind si rrjedhojë e ligjshmërisë së aktit përfundimtar me të cilin organi shtetëror vendos mbi të drejtën, detyrimin ose interesin juridik të personit fizik apo juridik. Procedura e konfliktit administrativ është e rregulluar me ligjin nr. 03/L-202 i miratuar nga Parlamenti i Kosovës me dt. 16. shtator 2010. Me këtë ligj rregullohen kompetenca, përbërja e gjykatës dhe rregullat e procedurës, në bazë të të cilave gjykatat kompetente vendosin për ligjshmërinë e akteve administrative me të cilat organet kompetente të administratës publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik dhe të palëve tjera, si dhe për ligjshmërinë e veprimeve të organeve administrative.

Qëllimi i këtij ligji për konfliktet administrative është sigurimi i mbrojtjes gjyqësore të të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me vendime individuale ose me veprime të organeve të administratës publike.

Parimet themelore të Ligjit për Konflikte Administrative janë:

- **Parimi i ligjshmërisë:** për çka gjykata është kompetente të vendos në bazë të kushtetutës dhe ligjeve.
- **Parimi i deklarimit të palës:** para nxjerrjes së aktgjykimit gjykata është e obliguar që ti jap mundësinë e deklarimit secilës palë, mbi të gjitha kërkesat dhe pretendimet e palëve të tjera dhe mbi të gjitha faktet dhe çështjet juridike që janë objekt i shqyrtimit në konfliktin administrativ. Gjukata mund të vendos lidhur me çështjen e konfliktit administrativ pa dhënien e mundësisë palës për tu deklaruar, vetëm në ato raste kur ligji e ka paraparë një gjë të tillë.
- **Parimi i shqyrtimit verbal:** në procedurën gjyqësore gjatë shqyrtimit të kërkesës lidhur me konfliktin administrativ gjykata vendos në bazë të shqyrtimit verbal të drejtpërdrejt dhe publik. Që do të thotë se gjykata duhet të vendos në formë transparente gjatë gjithë procedurës përveç në ato raste kur ligji e ka paraparë që të vendos me seancë të mbyllur.

- **Parimi i efikasitetit gjykata:** me rastin e inicimit të konfliktit administrativ nga ana e palës është e obliguar që sa më shpejtë dhe pa zvarritje ta zhvillojë procedurën e konfliktit administrativ duke iu shmangur veprimeve dhe shpenzimeve të panevojshme, me çka e pamundëson keqpërdorimin dhe zvarritjen e realizimit të drejtave të palëve, të pjesëmarrësve të tjerë në konflikt administrativ duke i nxjerr në afat të parashikuar vendimin.
- **Parimi i ndihmës së palës së painformuar:** gjykata gjatë procedurës lidhur me konfliktin administrativ kujdeset që mos informimi i palës dhe pjesëmarrësve të tjerë në konflikt administrativ, të mos jetë në dëm të drejtave të cilat i kanë në bazë të ligjit.

KONFLIKTI ADMINISTRATIV NË KUPTIMIN FORMAL DHE MATERIAL

Në teorinë juridike nuk ekzistojnë pikëpamje unike lidhur me përkufizimin e nocionit të konfliktit administrativ, andaj edhe dallohen:

1. Nocioni formal
2. Nocioni material

Konflikti administrativ në kuptim formal- përkufizohet me ndihmën e karakteristikave të jashtme formale, organizative. Edhe për përkufizimin e konfliktit administrativ ekzistojnë pikëpamje të ndryshme. Sipas një pikëpamje nocionin e konfliktit administrativ e lidh me natyrën e organeve të cilat i zgjidhin konfliktet administrative, konflikt administrativ do të ishte ai konflikt të cilin e zgjidhin gjykata e veçanta administrative. Sipas një pikëpamje tjetër, përkufizimin e konfliktit administrativ e lidh me veçorinë e procedurës në bazë të së cilës zgjidhen konfliktet administrative, konflikt administrativ është ai konflikt i cili zgjidhet sipas procedurës së veçantë që quhet procedurë administrative gjyqësore.

Konflikti administrativ në kuptim material- përcaktohet me ndihmën e karakteristikave esenciale, përmbajtjesore. Konflikti administrativ është ai konflikt në të cilin njëra palë, qoftë në cilësinë e paditësit, qoftë të paditurit, është administrata, apo konflikt administrativ është atëherë kur objekt të konfliktit paraqitet çështja nga e drejta administrative. Objekt i konfliktit administrativ është çështja e ligjshmërisë së aktit administrativ, përkatësisht çështja e arsyeshmërisë së heshtjes administrative. Konflikti administrativ përkufizohet si lloj kontrolli gjyqësor mbi ligjshmërinë e aktit administrativ të përfunduar, apo të nxjerrë nga organi administrativ i cili ushtron autorizime publike, gjersa personi apo pala të cilit i përket ai akt administrativ, e konsideron si të paligjshëm ngase i njëjti konsideron se me këtë akt administrativ i është shkelë ndonjë e drejtë ose interes juridik. Ky konflikt zhvillohet rreth ligjshmërisë së aktit administrativ, tek gjykata kompetente në procedurën e veçantë, e

ashtuquajtur procedurë administrative gjyqësore e cila është rregulluar me Ligjin për Konfliktet Administrative.

OBJEKTI I KONFLIKTIT ADMINISTRATIV-AKTI ADMINISTRATIV

Në bazë të ligjit për konfliktin administrativ, konflikti administrativ mund të iniciohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerr në procedurën administrative në shkallë të dytë. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative, nuk është lejuar ankesa. Gjithashtu konflikti administrativ mund të filloj edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës nën kushtet e parapara me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Konflikti administrativ mund të zhvillohet vetëm kundër aktit administrativ, prandaj objekt i konfliktit administrativ është çështja e ligjshmërisë së aktit administrativ i cili atakohet me padi. Andaj, objekt i konfliktit administrativ sipas ligjit për konfliktin administrativ është akti individual administrativ përfundimtar në procedurën administrative (kundër të cilit nuk mund të ushtrohet mjet i rregullt juridik-ankesa), që do të thotë se konflikti administrativ mund të fillohet kundër aktit administrativ të nxjerrë në shkallë të dytë. Mirëpo konflikti siç u cek edhe më lartë mund të filloj edhe kundër aktit administrativ të organit të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurë administrative nuk është e lejuar ankesa. Objekt i kontrollit apo shqyrtimit gjyqësor nuk mund të jenë ato pjesë të aktit administrativ në të cilat organi i administratës shtetërore mund të ushtroj çmuarjen e lirë por vetëm ato pjesë të lidhura të aktit diskrecional.

AKTI ADMINISTRATIV

Akti administrativ që të mund të jetë objekt i konfliktit administrativ, duhet ti përmbajë disa karakteristika të caktuara dhe ti plotësoj disa kushte të caktuara:

1. Akti administrativ duhet të jetë akt i nxjerrë nga personi i autorizuar, do me thënë të jetë nxjerr nga organi shtetëror ose nga një organ që ushtron autorizime publike në bazë të ligjit.
2. Akti administrativ duhet të vendoset për ndonjë të drejtë apo caktim të ndonjë detyrimi personit të caktuar fizik apo juridik.
3. Akti administrativ duhet të jetë nxjerrë për një çështje administrative, të jetë vendosë mbi ndonjë të drejtë, detyrim ose interes juridik të palës së caktuar.
4. Akti administrativ duhet të jetë konkret dhe individual-akt me të cilin vendoset në rastin e caktuar mbi të drejtat dhe detyrimet ose interesat juridik të subjektit të caktuar juridik dhe
5. Akti administrativ duhet të jetë përfundimtar në procedurën administrative, ndaj të cilit nuk mund të ushtrohet mjeti i rregullt juridik-ankesa.

Të gjitha këto kushte të cituara më lartë duhen të plotësohen kumulativisht me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ. Për shkak të mungesës së ndonjëres nga këto kushte, akti administrativ është i mangët.

SHKAQET PËR TË CILAT AKTI ADMINISTRATIV MUND TË KUNDËRSHTOHET

Akti administrativ mund të kundërshtohet për dy shkaqe dhe atë: Për shkaqet formale juridike dhe shkaqet materiale juridike:

Shkaqet formale juridike për të cilat mund të atakohet akti administrativ janë:

1. Nëse akti administrativ është nxjerr nga organi jo kompetent
2. Për shkak se në procedurën që i ka paraprirë nxjerrjes së aktit nuk është vepruar sipas dispozitave të procedurës.
3. Për shkak se gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.
4. Për shkak se nga faktet e vërtetuara është nxjerrë përfundimi i gabuar, jo i drejtë përkitazi me gjendjen faktike.

Shkaqet juridiko-materiale për të cilat mund të kundërshtohet akti administrativ janë:

1. Me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ nuk është aplikuar fare ose nuk është aplikuar drejt ligji, dispozita e bazuar në ligj.
2. Me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ, organi për realizimin e qëllimit tjetër e jo për qëllimin i cili buron nga ligji.

AKTET ADMINISTRATIVE NDAJ TË CILAVE NUK MUND TË ZHVILLOHET KONFLIKTI ADMINISTRATIV

Sipas Ligjit për Konfliktin Administrativ nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ kundër akteve të nxjerra në çështjet, në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ. Do me thënë nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ kundër atyre akteve administrative të cilave iu është siguruar mbrojtja gjyqësore. Konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikt administrativ. Gjithashtu konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet kundër akteve administrative që përbëjnë një detyrim të përgjithshëm të nxjerra nga organet e administratës, përveç kur ato cenojnë të drejtat e ligjshme të palëve.

HESHTJA E ADMINISTRATËS

Konflikti administrativ mund të iniciohet edhe me rastin e heshtjes së organit administrativ, ngase shpesh ndodh që organet administrative nuk vendosin lidhur me kërkesën apo ankesën e palës në afatin e paraparë ligjor, andaj për këtë mos veprim të organit administrativ ligji e ka përcaktuar si heshtje administrative. Ligji i procedurës administrative e ka paraparë se me rastin e mosveprimit të organit administrativ lidhur me kërkesën apo ankesën e palës në afat ligjor, konsideron se organi ligjor ka marrë aktvendim negativ lidhur me kërkesën apo ankesën e palës. Pasi që të jetë përfunduar afatet ligjore lidhur me kërkesën përkatësisht ankesën e palës, pala e pakënaqur mund të ushtroj padi në gjykatën kompetente gjegjësisht në Gjykatën Themelore-në Departamentin për çështje Administrative. Ky institut i heshtjes administrative është përcaktuar me ligj me qëllim të mbrojtjes së palëve nga mosveprimi i organeve administrative dhe si pasojë e mosveprimit të organeve administrative, pala të ketë mundësi të inicioj konflikt administrativ pranë gjykatës kompetente.

NXJERRJA E AKTIT ADMINISTRATIV PAS DORËZIMIT TË PADISË

Nëse organi administrativ gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore nxjerr aktin tjetër me të cilin revokohet ose shfuqizohet akti administrativ kundër të cilit është iniciuar konflikti administrativ, organi është i detyruar që ta njoftoj gjykatën lidhur me nxjerrjen e aktit administrativ. E në rastin konkret gjykata do ta ftoj paditësin që brenda 15 ditësh, të deklarohet se me aktin administrativ të nxjerr në afatin e mëvonshëm:

1. Është i kënaqur
2. Nuk heq dorë nga padia
3. Pjesërisht heq dorë nga padia
4. Padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër.

Nëse paditësi deklaron se me aktin e nxjerrë në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo nëse nuk jep deklaratë brenda afatit prej 15 ditësh, gjykata do të nxjerr vendimin mbi pezullimin e procedurës. Nëse paditësi deklaron se me aktin e ri nuk është i kënaqur, gjykata do ta vazhdon procedurën.

PALËT NË KONFLIKT ADMINISTRATIV

Ligji për Konflikt Administrativ ka përcaktuar saktë se kush mund të jetë palë në konflikt administrativ, ashtu që palë në konflikt administrativ janë:

1. Paditësi
2. I padituri
3. Personi i interesuar

PADITËSI NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV

Paditësi në konflikt administrativ është personi fizik, juridik, avokati i popullit, shoqatat dhe organizatat tjera që janë të legjitimuara për ngritjen e padisë me të cilën goditet ligjshmëria e aktit administrativ i nxjerrë nga organi administrativ. Paditës në konfliktin administrativ mund të jetë subjekti që ka legjitimitet për iniciimin e konfliktit administrativ. Pra konfliktin administrativ mund ta iniciojnë vetëm personat e autorizuar me ligj për iniciimin e konfliktit administrativ. 14 Paditës në konfliktin administrativ mund të jetë personi të cilit i është shkëlur ndonjë e drejtë ose interes juridik me aktin administrativ të organit shtetëror.

PALA E PADITUR NË KONFLIKT ADMINISTRATIV

Pala e paditur në konflikt administrativ është organi shtetëror, përkatësisht organizata që ushtron autorizime publike. Meqenëse konflikti administrativ iniciohet kundër aktit administrativ përfundimtar, përkatësisht heshtjes përfundimtare të administratës ana e paditur është organi i cili ka nxjerr aktin administrativ i cili akt është akt përfundimtar në procedurën administrative, gjegjësisht organi i cili brenda afatit nuk e ka nxjerr aktin administrativ (heshtja e administratës). Akt administrativ përfundimtar sipas Ligjit të Procedurës Administrative është ai akt që është nxjerrë në shkallë të dytë dhe se kundër këtij akti administrativ nuk lejohet mjet i rregullt juridik-ankesa. Konflikti administrativ mund të iniciohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë. Mirëpo kundër këtij akti administrativ nuk është i lejuar mjeti juridik-ankesa. Konflikti administrativ mund të iniciohet edhe me rastin e heshtjes administrative. Që do të thotë se pas përfundimit të afateve ligjore të heshtjes administrative, pala mund të inicioj konflikt administrativ për shkak të heshtjes së administratës.

PERSONI I INTERESUAR

Personi i interesuar është personi i tretë të cilit me rastin e anulimit të aktit administrativ do ti cenonte ndonjë të drejtë apo do ti shkaktonte ndonjë dëm të drejtpërdrejt personal. Andaj për këtë arsye ky person mund të paraqitet në gjykatë si palë e interesuar lidhur me fatin e aktit administrativ.

PADIA NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV

Në bazë të Ligjit për Konfliktin Administrativ, procedura iniciohet me padi duke atakuar ligjshmërinë e aktit administrativ. Kjo procedurë iniciohet sipas parimit të dispozicionit të palës e jo sipas parimit oficiele që do të thotë se padinë e paraqet paditësi për shkak se i njëjti konsideron se me aktin administrativ i është mohuar ndonjë e drejtë apo detyrim. Pa padi nuk ka konflikt administrativ. Në kuptimin formal padia është parashtrësë e hartuar në mënyrë të rregullt, e drejtuar me kohë gjykatës nga ana e personit të legjitimuar për iniciimin e konfliktit administrativ duke e atakuar aktin

administrativ. Konflikti administrativ mund të iniciohet dhe të zhvillohet vetëm kundër aktit administrativ të përfunduar, do të thotë se konflikti administrativ mund të fillohet, kundër akteve administrative të nxjerra në shkallë të dytë sepse këto akte administrative janë përfundimtare në procedurën administrative. Mirëpo konflikti administrativ mund të iniciohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër këtij akti administrativ në procedurë administrative ankesa nuk është e lejuar. Konflikti administrativ mund të iniciohet edhe me rastin e heshtjes administrative, që do të thotë se palës të cilit organi administrativ nuk i është përgjigjur lidhur me kërkesën apo ankesën e tij në afatin e paraparë me ligj ai mund të iniciojë konflikt administrativ duke atakuar për heshtje administrative të organit administrativ.

Me padi pala mund të kërkojë:

1. Anulimin ose shpalljen e pavlefshme të aktit administrativ.
2. Nxjerrjen e aktit administrativ, i cili akt nuk është nxjerrë në afatin e parashikuar.
3. Kthimi i sendeve të marra dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të atakuar.

AFATI PËR PARAQITJEN E PADISË

Sipas Ligjit për Konfliktin Administrativ, padia paraqitet brenda afatit prej 30 ditësh, nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtarë palës. Ky afat prej 30 ditësh, aplikohet edhe për organin e autorizuar për paraqitjen e padisë, nëse i është dorëzuar akti administrativ. Nëse akti administrativ nuk i është dorëzuar organit, mund të paraqesë padinë brenda 60 ditësh, nga data e dorëzimit të aktit administrativ palës, në favor të së cilës është nxjerr akti administrativ.

DORËZIMI I PADISË

Në bazë të nenit 28 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, padia i dorëzohet gjykatës kompetente drejtpërsëdrejti ose i dërgohet me postë rekomande. Padia mund të bëhet edhe në procesverbal në gjykatë. Dita e paraqitjes së padisë në postë rekomande, respektivisht dita e deklarimit të padisë në procesverbal, konsiderohet si ditë kur i është dorëzuar gjykatës.

Nëse padia nuk i është dorëzuar gjykatës por organi tjetër jo kompetent, ndërsa i arrin gjykatës pas skadimit të afatit për paraqitjen e padisë, do të konsiderohet se është paraqitur me kohë, nëse ushtrimi i padisë pranë këtij organi ka qenë si pasojë e mosdijes apo e gabimit të hapur të ushtruesit të padisë. Padiësi duhet t'ia bashkangjes padisë edhe aktin administrativ. Bashkë me padinë i bashkëngjitet edhe nga një kopje e padisë dhe anekset për organin e paditur dhe për çdo person të interesuar.

PËRMBAJTJA E PADISË

Sipas dispozitës së nenit 30 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, padia është parashtrësë formale e cila duhet të përmbajë:

1. Emërtimi i gjykatës të cilës i paraqitet padia.
2. Emri, mbiemri dhe vendbanimi i paditësit dhe të paditurit.
3. Akti administrativ kundër të cilit është iniciuar padia,
4. Arsyet pse ngrihet padia.
5. Vëllimi i anulimit të aktit administrativ.

Në padi nuk është e domosdoshme që të theksohen dispozitat juridike të cilat janë shkelur, por arsyetimi në padi duhet të jetë i kuartë e jo kontradiktor. Kërkesa e padisë është objekt mbi të cilin gjykata shqyrton dhe vendos. Me një padi mund të atakohet vetëm një akt administrativ dhe me padi kontestohet ligjshmëria e aktit administrativ. Kjo është esenca e konfliktit administrativ. Me rastin e ushtrimit të padisë kolektive ekziston atëherë kur shumë persona me një padi e atakojnë të njëjtin akt administrativ.

Format e padive

Shembulli 1.

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

Paditësi: Sh. Sh. nga Prishtina, rruga “Nënë Tereza” pn.

E paditura: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, në Prishtinë

P A D I

Për anulimin e vendimit nr. _____, të datës _____, të lëshuar nga organi i shkallës së dytë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve.

Përkitazi me:

- Për shkak se me vendimi përfundimtar nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore dhe
- Për shkak se në procedurë që i ka paraprirë aktit nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, apo nëse nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike.

A R S Y E T I M

Përmbledhje e fakteve:

Në Departamentin e Pensioneve të MPMS-së, paditësi kishte parashtruar kërkesë për njohjen e të drejtës për pension kontribut pagues të moshës, për kategorinë e tretë (III), me përgatitje shkollore të lartë.

Lidhur me kërkesën paditësi me datë _____ ka pranuar aktvendimi me të cilin është miratuar kërkesa për njohjen e të drejtës për pension kontribut pagues të moshës për kategorinë e dytë (II), me shkolim të mesëm, por jo në kategorinë e tretë (III), për të cilën kishte aplikuar dhe që posedon dëshmi.

Kundër vendimit nr. _____, paditësi me datë _____, ka parashtruar ankesën në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Këshillit të Ankesave të Departamentit të Pensioneve, si organ i shkallës së dytë, përmes të cilës e ka kërkuar që

pas pranimit të kësaj ankese, vendimin ankimor ta ndryshoj, ashtu që ankuesit Sh. Sh., nga Prishtina ti njihet e drejta në pension kontribut pagues të moshës për kategorinë e tretë (III) me shkollim të lartë.

Me datë _____, organi i shkallës së dytë Departamenti i Pensioneve, duke vepruar sipas ankesës nr. _____ të datës _____, ka nxjerrë vendimin nr. _____ datë _____ sipas të cilit është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit për njohjen e të drejtës në kategorizim për pension kontribut pagues të moshës.

Duke e konsideruar sit ë pa drejtë vendimin e organit të shkallës së dytë, dhe i cili është marr në kundërshtim me dispozitat ligjore për shkak se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore, dhe se nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike dhe nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, paditësit duke u mbështetur në dispozitën e nenit 13 par.1, lidhur me nenin 16 par.1 pika 1.1 dhe 1.3 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative i'u ka drejtuar kësaj gjykate për kundërshtimin e vendimit ankimor, për arsyet e më poshtme:

Mungesa e formës ligjore

Vendimi ankimor nuk i përmban elementet që kërkohet me nenet 83-86 të Ligjit për Procedurën Administrative, veçanërisht për shkak të mungesës së arsyetimit, përkatësisht arsyetimi përmban të dhëna të paqarta, kontradiktore dhe të pasakta.

Në arsyetimin e vendimit ankimor nuk janë dhënë arsye ligjore për faktet vendimtare të ngritura nga paditësi me anë të ankesës drejtuar organit të shkallës së dytë, ndërsa edhe ato arsye që janë dhënë për këto fakte, nuk kanë të bëjnë me pretendimet e paditësit të ngritur me ankesë, sepse kërkesa e paditësit ka qenë që ti njihet e drejta në pension kontribut pagues të moshës për kategorinë e tretë me shkollim të lartë, ndërsa në arsyetimin e vendimit ankimor thuhet se nuk janë përmbushur kushtet dhe kriteret e përgjithshme dhe nuk janë bashkangjitur të dhëna për 15 vite stazh kontributiv si dhe dëshmi përkatëse për nivelin e përgatitjes shkollore.

Arsyet e dhëna në vendimin ankimor janë të pa qarta, kontradiktore dhe të pa sakta, ngase përvoja e punës e paditësit nuk është kontestuar as njëherë madje as nga organi i shkallës së parë, paditësi është shfrytëzues i pensionit kontribut pagues të moshës për kategorinë e dytë dhe posedon dëshmi të bollshme për këtë fakt.

Sipas nenit 86.3 të Ligjit për Procedurën Administrative thuhet se “Arsyetimi me të dhëna të paqarta, kontradiktore ose të pasakta është i barsvlershëm me mungesën e arsyetimit”.

Konsiderojmë se secila palë ka të drejtë në vendime të arsyetuara mirë dhe e njëjta paraqet obligim edhe për organet administrative.

Konstatimi i gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike;

Pranë të paditurës, paditësi ka parashtruar kërkesë për njohjen e të drejtës për pension kontribut pagues të moshës për kategorinë e tretë me përgatitje të lartë shkollore komfor nenit 4 par. 1 pika 1.3 të Udhëzimit Administrativ 09/2015.

Në kuptim të dispozitës së nenit 5.3, lidhur me nenin 6 të UA 09/2015, paditësi, kërkesës i'a ka bashkangjitur të gjitha dokumentet e nevojshme ligjore duke përfshirë edhe diplomën për shkollimin e lartë të cilin shkollim e ka përfunduar në shkollën teknike në Prishtinë në drejtimin inzhinering shkolla e lartë dy vjeçare e rregullt përfunduar në vitin 1970.

PROVË: Diploma e shkollimit të lartë me nr. _____.

Për më tepër ka filluar të punoj që nga viti 1970, në profesion, e gjithë përvoja e punës së tij është evidentuar si punëtor me kualifikim të lartë deri në pensionimin e tij dhe mbi këtë bazë i ka plotësuar të gjitha kriteret që të kategorizohet për pension kontribut pagues të moshës me kualifikim të lartë apo të shkallës së III.

PROVË: Libreza e punës

Konsiderojmë se arsyetimi i vendimit ankimor lidhur me nivelin e përgatitjes shkollore të mesëm është i pa bazuar dhe është në kundërshtim me provat e ofruara nga se conform Udhëzimit Administrativ 09.2015 dhe ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti kërkesës ia ka bashkangjitur edhe dëshmitë përkatëse diplomën me nr. _____ të datës _____, e vërtetuar te noteri _____ me nr. _____ datë _____.

Zbatimi i gabuar i së drejtës material

E paditura në arsyetimin e vendimit ankimor gabimisht, ka aplikuar nenin 8 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga shteti me që me këtë nen përcaktohen vetëm kushtet që duhet ti plotësoj një person për t'iu njohur kjo e drejtë ndërsa në rastin e paditësit nuk ka qenë dhe nuk është kontestuese kohëzgjatja e përvojës së punës dhe për këtë ka ofruar mjaftë dëshmi, dhe mbi bazën e saj edhe ka qenë shfrytëzues i Pensionit Kontribut pagues të Moshës për kategorinë e dytë.

Kërkesa e tij është mbështetur në dispozitën e nenit 4 paragrafi 1 pika 1.3, lidhur me nenin 5 par.3 të Udhëzimit Administrativ 09/2015 ku thuhet: “*Shfrytëzuesi i Pensionit*

Kontribut pagues me përgatitje të lartë, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka shkollimin e larë”.

Mbi këtë bazë ligjore, paditësi e kishte bazuar kërkesën për njohjen e të drejtës për pension kontribut pagues të moshës për kategorinë e tretë III si në organin e shkallës së parë, ashtu edhe në organin e shkallës së dytë dhe në të dyja rastet bashkë me kërkesën dhe ankesën i ka bashkangjitur si prova edhe librezën e punë e cila dëshmon mbi përvojën e punës dhe diplomën e shkollës së larë me nr. _____, datë. _____,

Andaj, nga arsyet e lartcekura paraqes këtë padi dhe propozojë që kjo gjykatë pas zhvillimit të procedurës administrimit të provave dhe deklaramit të palëve të merr:

AKTGJYKIM

- **Aprovohet** kërkesëpadia e paditësit Sh. Sh. nga Prishtina.
- **Anulohet** vendimi i të paditurës MPMS nr. _____, datë _____.
- **Detyrohet** e paditura që paditësit t’ia paguaj diferencën e shumave të pa paguara për kategorinë e pensionit kontributpagues të moshës për kategorinë e tretë (III), nga data e parashtrimit të kërkesës deri në nxjerrjen e aktgjykimit të formës së prerë të gjitha me kamat ligjore prej 8 % në vit.
- Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Prishtinë, datë 25.11.2019

PADITËSI, Sh. Sh.

Shembulli 2.

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

Paditësi: Sh. Sh. nga Prishtina, rruga "Mbretëresha Teutë" pn.

E paditura: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale/Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës, Prishtinë.

P A D I Konflikt Administrativ

Me propozim:

Njohjen e së drejtës në pension për persona me aftësi të kufizuara dhe anulimin e Vendimit me nr. të dosjes _____, i datë _____, të pranuar me datë _____.

E paditura MPMS/DAPK, me Vendimin nr. _____ të datës _____, ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka vërtetuar vendimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë.

Provë: Vendimi nr. _____, Dt. _____.

Nga arsyetimi i vendimit të kontestuar rrjedhë se i njëjti është refuzuar nga Këshilli i ankesave pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe ka konstatuar se paditësi nuk ka paraqitur dëshmi të mjaftueshme, të cilat do të ishin të mjaftueshme lidhur me kriteret e parapara me dispozitat e nenit 3 të Ligjit për pensionet e personave me aftësi të kufizuara nr.2003/23, për të qenë shfrytëzues i pensionit të tillë.

Paditësi, konsideron se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i pa bazë për arsye se paditësi ka ofruar prova të mjaftueshëm, lidhur me gjendjen shëndetësore të tij, në bazë të të cilave vërtetohet paaftësia e tij. Këto prova i ka paraqitur edhe me rastin e paraqitjes së ankesës, ka paraqitur dëshmi mjekësore të mjaftueshme dhe bindëse të cilat korrespondojnë me kriteret e parapara me dispozitat e nenit 3 të Ligjit për Pensionet e Personave me Aftësitë të Kufizuara nr.2003/23, andaj edhe vendimi refuzues i organit të shkallës së parë dhe shkallës së dytë është i pa bazë dhe në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr.2003/23, andaj si i tillë duhet anuluar, ngase arsyet mbi të faktet vendimtare të vendimit për refuzimin e PPAK lidhur me paditësin nuk përkojnë me provat të cilat i ka ofruar paditësi.

Paditësi është person me aftësi të kufizuara, ku është diagnostifikuar me Dg. Epi partialis cum gener. Gjendja dhe diagnoza e tij është përshkruar hollësisht në raportet mjekësore të bashkangjitura padisë.

Paditësi në konstatimin mjekësorë specialistik është shpallur i pa aftë për punë dhe është udhëzuar për Komisionin invalidor, fakte këto të cilat Gjykata do ti vërtetoi edhe nga shkresat e lëndës, respektivisht raportet mjekësore të cilat janë pranë organit të shkallës dhe tani ofron raportet e reja mjekësore për gjendjen e tij shëndetësore, prandaj kërkon që të i njihet e drejta për pension invalidor, bazuar në nenin 3 të Ligjit nr2003/23 dhe të ftohet në Komisionin mjekësor, të rishqyrtohet vendimi i këtij organi ngase është i pa bazë juridike dhe është i kundërligjshëm.

Provë: Raportet mjekësore.

Paditësi ka qenë përfitues i pensionit për persona me aftësi të kufizuara edhe më parë që nga viti 2004 deri në vitin 2013 kur i është ndërprerë pa bazë ligjore.

Provë: Libreza e pensionit për personat me aftësi të kufizuar dhe vendimi me të cilin i është njohur kjo e drejtë.

Andaj duke u nisur nga arsyet e lartcekura dhe provat mjekësore të bashkuara në lëndë, i propozojmë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative që pas shqyrtimit të pretendimeve të padisë dhe shkresave të lëndës të merr:

A K T G J Y K I M

Aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit Sh. Sh.

Anulohet vendimi i të paditurës MPMS/DAPK nr. _____, datë _____, Paditësit i njihet e drejta në pension të personave me aftësi të kufizuara të përhershme.

Prishtinë, datë 20.11.2019

Paditësi, Sh. Sh.

Shembulli 3.

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE DIVIZIONI FISKAL

Paditësi: Sh. Sh. nga Prishtina, rruga "Mbretëresha Teutë" pn.

E paditura: Dogana e Kosovës, Prishtinë.

P A D I Konflikt Administrativ

Kundër Vendimit të Doganës së Kosovës nr. _____ datë _____, sipas të cilit vendim është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e ankuesit për rishqyrtimin e vendimit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale, Prishtinë nr. _____ datë _____, me të cilin subjekti në procedurë NPT "AAA" është shpallur përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes doganore sipas nenit 276 pika a) dhe k).

Në ZDB Prishtinë, me datë _____, sipas DUD-it _____ kemi paraqitur për zhdoganim mallra të ndryshme, sipas dokumenteve përcjellëse të mallit. Me rastin e paraqitjes së mallit doganor për zhdoganim deklaratës doganore i janë bashkangjitur të gjitha dokumentet përcjellëse të mallit të cilat kërkohen si dokumente që duhet ti bashka ngjiten deklaratës doganore për vendosje të mallit në qarkullim të lirë në përputhje me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 mbi Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave. Këto dokumente janë të harmonizuara në kuptim të vlerës së transaksionit të kryer për mallin e blerë.

Kur malli është deklaruar për zhdoganim është pranuar nga agjenti doganor, ashtu si është deklaruar nga ankuesi tani paditësi, por më pas malli i deklaruar sipas DUD-it kontestues është përzgjedhur nga task force për tu kontrolluar. Pas kontrollit të Task Force ka "rezultuar" se ka pasur parregullsi në deklarimin e mallit sepse gjithnjë sipas tyre subjekti nuk ka deklaruar një pjesë të mallit si dhe ka pasur mall emërtimet e së cilave janë deklaruar në mënyrë jo të drejtë. Oficerët doganor më pas kanë përpiluar procesverbalin mbi kundërvajtjen doganore nr. _____, datë _____, sipas të cilit subjekti në procedurë është shpallur përgjegjës për kryerjen e kundërvajtjes doganore dhe si rrjedhojë subjekti në procedurë është dënua për kundërvajtje doganore sipas nenit 276 par. a) "në rast se personi fizik apo personi juridik nuk paraqet mallin atëherë do të dënohet me gjobë në vlerën prej 500 deri në 10.000 euro" dhe 276 k). Sipas procesverbalit të parë nr. _____ datë _____, për mallin e paraqitur sipas DUD-it nr. _____ në disa nga emërtimet e këtij DUD-i janë hasur disa parregullsi, psh. në emërtimin 5 janë gjetur 200 copë llamba më shumë, 400 copë poqa...

I pa kënaqur me këto gjetje subjekti në procedurë ka paraqitur një kërkesë më datë _____, ku kërkohet të ribëhet edhe njëherë kontrolli. Përsëri nga Dogana e Kosovës është formuar një komision i përbërë prej 3 anëtarësh për dallim nga komisioni i parë i cili ka qenë i përbërë nga 6 anëtarë. Edhe pse pas kontrollit të dytë komisioni ka përpiluar procesverbalin me datë _____. Ky kontroll i dytë i ushtruar ka rezultuar me të tjera gjetje nga ato të cilat kanë rezultuar nga kontrolli i parë i Task Force.

Sipas të cilit në DUD në emërtimin 5 janë gjetur 100 copë llamba më shumë, 300 copa poqa...

Provë: Procesverbalet e datës _____.

Pasi nga këto dy kontrole kanë dalë rezultate të ndryshme, vendimi i shkallës së dytë është marrë duke u bazuar në procesverbalin mbi kundërvajtje doganore me numër _____ të datës _____, i cili është përpiluar në mënyrë krejt të gabuar duke u nisur nga emërtimi i mallit, sasia dhe çmimi. Kjo do të thotë se në rast të një përsëritje të kontrollit do të kishte rezultuar me gjetje të tjera.

Subjekti ka deklaruar mallin duke u nisur nga fatura përcjellëse e mallit dhe subjekti në procedurë nuk ka kryer asnjë veprim në kundërshtim me Kodin Doganor dhe të Akcizave. Vlera e mallrave të paraqitura në faturë është e njëjta vlerë si në DUD-in e pranuar nga Dogana e Kosovës.

Vendimi për dënimin është shumë i padrejtë dhe është marrë në mënyrë krejtësisht të gabuar. Shqiptimi i dënimit në vlerë _____ është marrë duke u bazuar në një gjendje krejtësisht të gabuar të pa saktë.

Andaj duke u nisur nga arsyet e lartcekura, propozojmë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çeshite Administrative, Divizioni Fiskal, që pas shqyrtimit të pretendimeve të padisë dhe shkresave të lëndës të merr:

A K T G J Y K I M

Aprovohet padia dhe kërkesëpadia e paditësit Sh. Sh.

Anulohet vendimi i të paditurës Dogana e Kosovës nr. _____, datë _____, lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te organi i paditur.

Prishtinë, datë 20.11.2019

Paditësi, Sh. Sh.

Shembulli 4.

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

Paditësi: Sh. Sh. nga Prishtina, rruga “Nënë Tereza” pn.

E paditura: Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës-Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar, ne Prishtinë

P A D I

Për shkak të heshtjes administrative

Paditësi është i gjykuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës së Apelit në Prishtinë P.nr. _____, të datës _____, për shkak të veprës penale vrasje dhe është dënuar me burgim prej 7 vite.

Paditësi, me datë _____, tek e paditura ka parashtruar kërkesën për transferimin e tij për në Republikën e Shqipërisë, ndërsa kërkesa tek e paditura është regjistruar me nr. _____, mirëpo e paditura nuk i ka dhënë përgjigje palës paditëse në afatin kohor prej 30 ditësh, në pajtim me nenin 30 të Ligjit për Procedurën Administrative.

Provë kërkesa e paditësit nr. _____, datë _____.

Pala paditëse edhe njëherë i është drejtuar të paditurës me dt. _____, me kërkesë që e paditura të nxjerr vendim, mirëpo e paditura edhe përkundër kërkesës së përsëritur nuk ka nxjerr vendim në afatin e paraparë ligjor.

Provë kërkesa e datës _____.

Kështu me veprimet e këtilla, shihet se e paditura me neglizhencën e vet me ose pa qëllim ka shkaktuar heshtje administrative, për çka edhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 130 par.130.2 të Ligjit nr.02/L-28, i cili nen përcakton se: “130.1. *Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin; b) akti është shpallur në bazë të dispozitave të këtij Ligji ose ligjeve të tjera në fuqi.* 130.2. *Në rastin e mosveprimit të administratës (mos nxjerrjes së aktit dhe heshtjes së plotë), ankimi administrativ bëhet brenda 60 ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës për fillimin e procedimit administrativ”.*

Andaj, nga arsytet e lartcekura paraqes këtë padi për shkak të heshtjes administrative dhe propozojë Gjykatës të caktoj shqyrtim kryesor, ndërsa pas administrimit të provave të merr:

AKTGJYKIM

- **Aprovohet** kërkesëpadija e paditësit Sh. Sh. nga Prishtina.
- **Urdhërohet** e paditura MD, që në afat prej 30 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, të merr Vendim sipas ankesës së paditësit nr. _____, të dt. _____, dhe vendimin t'ia dorëzoj paditësit sipas procedurës të përcaktuar me ligj.

Prishtinë, datë 25.11.2019

PADITËSI, Sh. Sh.

Shembulli 5.

**GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË -
DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE**

Paditësi: Sh. Sh. nga Prishtina, rruga “Nënë Tereza” pn.

E paditura: A.A, ne Prishtinë, rruga _____

P A D I

Për inicimin e konfliktit administrativ

Për anulimin e vendimit nr. _____, të datës _____, të lëshuar nga DK., dhe kthimin e parave në shumën prej _____.

Për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës,

Për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale sepse nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore nga neni 16 pika 1.1 i LKA-së;

Për shkak se në procedurë, që i ka paraprirë aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, sepse është konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë gjendja faktike nga (neni 16 pika 1.3 i LKA-së);

Për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale.

A R S Y E T I M

E paditura me vendimin nr. _____ të datës _____, ka refuzuar kërkesën për rishqyrtimin e vendimit të ZBD-së me nr. _____, të datës _____, me të cilin vendim është kontestuar vlera e mallit e zhdoganuar duke e rritur bazën doganore, bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit duke shfrytëzuar të drejtën ligjore nga neni 291 pika 2 të Kodit Doganor dhe të Akcizave 03/L-109, për shkak të kontestimit të çmimit të transaksionit të mallit të importuar sipas DUD-ave _____. E paditura ka vlerësuar se dokumentacioni përcjellës i mallit lëndor ka qenë i pa mjaftueshëm sepse sipas tyre mungonte kontrata e shitblerjes, pagesa dhe deklarata eksportuese.

Edhe pse e paditura ka pasur në dispozicion si kontratën e bashkëpunimit ndërmjet SH.Sh. dhe A.A. sh.p.k të datës _____, dhe dëshminë e bankës për transferin e mjeteve në emër të avancit në shumën prej _____ euro, të datës _____.

Konform nenit 66 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr. 03/L-109, respektivisht nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009, që ka të bëjë me implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, me rastin e paraqitjes së mallit doganor, paditësja deklaratës unike doganore i ka bashkangjitur të gjitha dokumentet përcjellëse që kërkohen dhe që duhet bashkangjitur deklaratës doganore dhe atë: faturat e mallit nr. _____ datë _____;

Transaksionet ndërkombëtar bankar i datës _____, në shumën prej _____ euro; Packing list; Kontrata për bashkëpunim e lidhur ndërmjet Sh.Sh. dhe AA. Shpk, e datës _____.

Dhe përkundër të gjitha dokumenteve të dorëzuara që dëshmojnë për çmimin e vërtet për mallin e paguar e paditura i anashkalon të gjitha këto prova të pakontestueshme dhe bënë rivlerësimin e mallit me metodën e tret dhe të gjashtë të vlerësimit pa dhënë asnjë shpjegim shtesë me shkrim.

Në proces mbi përcaktimin e vlerës së mallrave të datës _____, thuhet se është bërë pagesa në kesh. Në rastin konkret kemi të bëjmë me dy kompani që kanë bashkëpunim disa vjeçar dhe se të gjitha pagesat kryhen përmes bankës. Kësaj radhe janë paguar _____ euro, sipas transaksionit të bashkangjitur dhe barazimet ndodhin ndërmjet kompanive kohë pas kohe. Prandaj shuma prej _____ euro ishte bërë si formë avanci.

Tutje në proces, si argument për aplikimin e metodës së III të vlerësimit përmendet DUD-i _____ i datës _____, shtrohet pyetja se a ka qenë malli i njëjtë në këto dy dërgesa, pasi që siç dihet në mallrat e tekstilit dallimet sado të vogla e bëjnë diferencën në çmim. Po ashtu në çmime duhet marr parasysh edhe bashkëpunimin disa vjeçar që ka importuesi me eksportuesin dhe sasinë e madhe të mallrave të blera që bëjnë që të përfitojnë çmime më të lira.

Me rastin e deklarimit, paditësi i ka paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme dhe dokumentet përcjellëse që kërkohen dhe që duhet bashkangjitur deklaratës unike doganore konform nenit 66 të Kodit Doganor dhe të Akcizave respektivisht nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 që ka të bëjë me implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave. Andaj nga arsyet e cekura më lart konstatohet se e paditura me rastin e nxjerrjes së vendimit nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, prandaj një vendim i tillë duhet të anulohet.

Vendimi i atakuar është nxjerr në kundërshtim me nenin 33 dhe 34 të KDA-së, pasi që Zyra e Pranimit ka aplikuar metodën e 6 të vlerësimit edhe pse ka qenë dashur të aplikohet metoda e parë e vlerësimit konform nenit 33. Në rast se nuk do të ishin plotësuar kushtet për tu aplikuar metoda e parë e vlerësimit, neni 34 parasheh që

metodat e vlerësimit të aplikohen sipas radhës dhe nuk mund të kalohet nga e para në të gjashtë pa i aplikuar metodat e vlerësimit.

Neni 34 pika “*Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas nenit 33, ajo duhet të përcaktohet sipas renditjes kronologjike të nën-paragrafëve (a), (b), (c) dhe (d) të paragrafit 2, duke filluar nga nën-paragrafi i parë (metoda e dytë), që lejon përcaktimin e asaj vlere, me përjashtim të rasteve në të cilat radha e aplikimit të nën-paragrafëve (c) dhe (d) mund të kapërcehet me kërkesën e deklaruesit*”.

Prandaj, në rastet kur dëshmohet me prova se çmimi i paraqitur është real, pra është çmimi i vërtet i paguar, nuk lejohet të aplikohet metoda tjetër e vlerësimit por aplikohet metoda e parë ashtu siç e parasheh neni 33 i KDA-së.

Paditësi në procedurën e zhdoganimit të mallit i ka paraqitur të gjitha provat e nevojshme siç janë faturat, dëshmit bankare për ekzekutimin e pagesave, që janë prova bindëse se çmimi i deklaruar është vlera e transaksionit-çmimi i vërtet i paguar për mallrat që paditësi i ka importuar.

Prandaj, në rastet kur dëshmohet me prova se çmimi i paraqitur është real, pra është çmimi vërtet i paguar, nuk lejohet të aplikohet metoda tjetër e vlerësimit por aplikohet metoda e parë ashtu siç e parasheh neni 33 i KDA-së.

E paditura ka shkel dispozitat procedurale, sepse nuk mund të kontestohet vlera e mallit pa u dëshmuar jovaliditeti i dokumenteve që e kanë përcjellë mallin. Dogana e Kosovës për ta ngritur çmimin është dashur të bëjë verifikimin e dokumenteve përkatësisht ta bëjë verifikimin e çmimit me të cilin është importuar ky mall.

Gjithashtu, e paditura ka bërë edhe shkelje të rregullave të procedurës administrative, përkatësisht parimin e objektivitetit dhe të paanshmërisë neni 7 i Ligjit për Procedurën Administrative 02/L-28,p asi që zyrtarët doganor nuk kanë vepruar në mënyrë objektive me rastin e kontestimit të vlerës së këtij malli duke mos dhënë peshën e duhur fakteve që kemi prezantuar. Si pasojë e një konstatimi të tillë të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike kemi aplikimin e gabuar dhe shkeljen e dispozitave ligjore materiale duke aplikuar nenin 35.1 të KDA-së, pasi që është dashur të aplikohet dispozita ligjore nga neni 33.1 i KDA-së, për arsye se ne kemi plotësuar kushtet ligjore për pranimin e vlerës së transaksionit të mallit me rastin e prezantimit të dokumenteve të nevojshme.

Siç mund të konstatohet me lehtësi, e paditura vendimin e vet nuk e ka arsyetuar fare, pasi që arsyetimi i dhënë është i përgjithësuar dhe nuk është i formuluar qartë dhe nuk jep sqarime të bazës ligjore dhe faktike. Nga arsyetimi nuk është e qartë se si ka ardhur deri tek konstatimi se paditësi ka paraqitur vlera më të ulëta nga vlerat në të cilat

pretendon e paditura. E paditura nuk sqaron se pse nuk ju ka besuar provave të paraqitura me rastin e ankesës dhe të gjitha këto prova i konsideron të pamjaftueshme.

Konform nenit 84 të LPA-së, Akti administrativ duhet të përmbajë një përmbledhje të gjendjes faktike dhe një deklaram të bazës ligjore. Po ashtu, neni 85 i LPA-së parasheh që *“Përveç rasteve kur ligji vet parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domodosmërisht arsyet për të gjitha ato akte të cilat pjesërisht ose tërësisht: a) mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në ndonjë mënyrë tjetër të drejta dhe interesa ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime; b) përbëjnë vendim në lidhje me kërkesat për rishqyrtim apo ankimet; c) përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar; d) përbëjnë devijim nga praktika e ndjekur për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme; e) shkaktojnë revokimin, shfuqizimin, modifikimin ose pezullimin e një akti të mëparshëm”*.

Neni 86 pika 1 parasheh që: *“Arsyetimi duhet të formulohet qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit”*. Pastaj pika 3 e të njëjtit nen parasheh që *“Arsyetimi me të dhëna të paqarta, kontradiktore ose të pasakta, është i barsvlershëm me mungesën e arsyetimit”*.

Prandaj ky vendim i të paditurës është nxjerr në kundërshtim të plotë me formën e paraparë me Ligjin e Procedurës Administrative dhe si i tillë, konform nenit 92 pika c, e LPA-së.

Me rastin e deklaramit, paditësi i ka paraqitur të gjitha dokumentet e nevojshme dhe dokumentet përcjellëse që kërkohen dhe që duhet bashkangjitur deklaratës unike doganore konform nenit 66 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, respektivisht nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009, që ka të bëjë me implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Andaj, nga arsyet e cekura me lartë konstatohet se e paditura me rastin e nxjerrjes së vendimit nuk e ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, prandaj një vendim i tillë duhet të anulohet.

Gjithashtu e paditura ka bërë edhe shkeljen e rregullave të procedurës administrative, përkatësisht parimin e objektivitetit dhe të paanshmërisë neni 7 të Ligjit për Procedurën Administrative, pasi që zyrtarët e të paditurës nuk kanë vepruar në mënyrë objektive me rastin e kontestimit të vlerës së këtij malli duke mos dhënë peshën e duhur fakteve që kam prezantuar. Si pasojë e një konstatimi të tillë të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike të përshkruar si më lartë, si dhe shkeljeve të rregullave të procedurës administrative kemi aplikimin e gabuar dhe shkeljen e dispozitave ligjore materiale duke aplikuar nenin 35.1 të KDA-së, pas që është dashur të aplikohet dispozita ligjore nga neni 33.1 i KDA-së, për arsye se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e vlerës së transaksionit të mallit me rastin e prezantimit të dokumenteve të nevojshme.

Nga të cekurat më lartë, konstatohet se e paditura, vendimin e atakuar e ka nxjerr me aplikim të gabuar të dispozitave ligjore dhe se qëllim të vetëm ka inkasimin e saj më shumë mjeteve duke shkelur çdo ligj dhe rregullore dhe atë në kurriz të bizneseve të ndershme.

Prandaj, nga të cekurat më lartë, i propozojmë gjykatës që të hap shqyrtimin gjyqësor, të administroj provat dhe të bie:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET kërkesëpadia e paditësit Sh.Sh. nga Prishtina

II. Anullohet vendimi i të paditurës A.A numër _____, i datës _____

III. Obligohet e paditura A. A. që paditësit t'ia kthej shumën prej _____, me kamat vjetore 8 % nga data _____ e deri në kthimin e tyre.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Prishtinë, datë _____

PADITËSI, Sh. Sh.

KOMPETENCA E GJYKATËS

Konflikti administrativ si procedurë e veçantë gjyqësore mund të iniciohet pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, këtë kompetencë e ka përcaktuar ligji për gjykatat nr. 03/L-199, i miratuar nga Parlamenti i Kosovës. Neni 14 i këtij ligji ka përcaktuar se Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështje tjera të përcaktuara me ligj. Të gjitha çështjet në Departamentin për çështjen Administrative të Gjykatës Themelore gjykohen nga një gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe. Kundër aktgjykimeve të Gjykatës Themelore-Departamenti për çështje Administrative, mund të ushtrohet ankesë dhe se lidhur me ankesën kompetent për të vendosur është Gjykata e Apelit, ndërsa me mjete të jashtëzakonshme vendosë Gjykata Supreme e Kosovës si gjykatë e instancës më të lartë gjyqësore në Kosovë.

Aktvendimet lidhur me kompetencën

Me nenin 23 të Ligjit për Konfliktet Administrative është përcaktuar Kompetenca në çështjet e konfliktit administrativ, ashtu që me:

Paragrafin 1. Të këtij neni është rregulluar që për paditë kundër akteve administrative të të gjitha organeve vendos gjykata kompetente për çështjet administrative në shkallë të parë, nëse me dispozita të tjera ligjore nuk është përcaktuar ndryshe.

Ndërsa me paragrafin 2. Përcaktohet se kundër vendimit të nxjerrë në konfliktin administrativ, ankesa mund të paraqitet te gjykata kompetente për çështje administrative e shkallës së dytë.

Shembulli 1.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Z.E, në konfliktin administrativ të paditëses F. S. nga _____, të cilën e përfaqëson av. S. S. nga _____, kundër të paditurit Qendra e Mjekësisë Familjare në Suharekë, për shkak të anulimit të vendimit, jashtë seancës, më dt. _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I.** Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë, shpallet jokompetent në pikëpamje lëndore, për të gjykuar këtë çështje juridike, sipas padisë nën shenjë A. nr. _____/16.
- II.** Pasi që ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda ti dërgohet Departamentit të Përgjithshëm të kësaj Gjykate, Divizioni Civil.

A r s y e t i m

Paditësja F. S. nga _____, ka parashtruar padi më datë 22.03.2016, kundër të paditurës Qendra e Mjekësisë Familjare në Suharekë, për anulimin e vendimit.

Gjykata pas shqyrtimit paraparak të padisë, vlerësoi se Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë, nuk është kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar në këtë çështje juridike.

Për të vlerësuar jokompetencën, gjykata iu referua Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, nenit 4.1 të të njetit, i cili përcakton kategoritë e punonjësve publik të cilët nuk janë pjesë e shërbimit civil, ku në bazë të këtij ligji, “statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit arsimor, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe përformuesit e artit, zyrtarët policor të Policisë së Kosovës, zyrtarët doganor të Doganave të Kosovës, zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të emëruarit politik dhe të gjitha ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i presidentit, kryetarit të kuvendit, kryeministrit dhe kabinetet e ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës, rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me Marrëveshje Kolektive ose me Rregullore Sektoriale”.

Po ashtu gjykata iu referua edhe Ligjit për Konflikte Administrative nr. 03/L-202 nenit 15.1.1, i cili përcakton se “konflikti administrative nuk mund të zhvillohet: kundër akteve të nxjerra në çështjet, në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ”.

Sipas nenit 19 të LPK-së, përcaktohet se secila gjykatë gjatë gjithë procedurës së shkallës së parë, sipas detyrës zyrtare (ex officio) kujdeset për kompetencën e vet lëndore.

Në këtë kuptim duke u bazuar në nenet 19, 29, 387 pika (u), 392 pika (b) dhe 393 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/16, dt. _____

G j y q t a r i
Z.E.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtut, Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Shembulli 2.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.____/11

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Z.E i, në konfliktin administrativ të paditësit S. S. nga Shterpca, kundër të paditurit Kuvendi Komunal Shtërpcë për shkak të anulimit të vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtim kryesor, më dt. _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I.** GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Administrative, shpallet jokompetentë në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike.
- II.** Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e sajë të i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë, në kompetencë të mëtutjeshme reale dhe lëndore.

A r s y e t i m

Paditësi S. S., më dt. 09.08.2011, ka parashtruar padi (ankesë) kundër të paditurit Kuvendit Komunal Shtërpcë, për shkak të anulimit të vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Pas vlerësimit të shkresave të lëndës, jashtë seancës gjyqësore, kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare vështroi kompetencën e sajë lëndore, dhe konform neneve 17 dhe 19 të LPK-së, dhe nenit 11 të Ligjit mbi Gjykatat e rregullta konstatoi që kjo çështje juridike nuk bie në kompetencën lëndore të kësaj gjykate.

Andaj duke u bazuar edhe në dispozitën ligjore të Ligjit nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës gjegjësisht neni 4 par.4 ku përcaktohet se: Personeli i punësuar nga institucionet e administratës në nivel qendrorë dhe komunal, përgjegjës për kryerjen e funksioneve mbështetëse dhe të mirëmbajtjes nuk janë nëpunës civil, çka do të thotë se në rastin konkret kemi paditësin i cili sipas këtij Ligji në fuqi nuk

hynë në kategorinë e nënpunësve civil të Kosovës, andaj në rastin konkret nuk mund të fillohet konflikti administrativ.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë e në kuptim të neneve 17, 18, 19, 29, dhe 392 pika b) të LPK-së, Ligjit për Gjykatat nr.03/-199 neni 14, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/11 e dt. _____

**Gj y q t a r j a,
Z.E.**

Udhëzim Juridik:

Kundër këtij aktvendim pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 15 dite, pas marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

Shembulli 3.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/13

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren M.K, në konfliktin administrativ të paditësit M.B. nga Kamenica rr. “ _____ ”, kundër të paditurit Drejtoria Komunale e Arsimit në Kamenicë, për shkak të anulimit të kontratës, jashtë seancës gjyqësore, më dt. _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I.** GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Administrative, shpallet jokompetentë në pikëpamje lëndore dhe toritoriale për të vendosur në këtë çështje juridike, në lëndën me shenjë A.nr.1149/13.
- II.** Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lënda së bashku me shkresat e sajë t’ i dorëzohet Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Kamenicë-Departamentit të Përgjithshëm-Kontestimore, në kompetencë të mëtutjeshme reale dhe lëndore.

A r s y e t i m

Paditësi M.B nga Kamenica, më dt. 27.08.2013, pranë kësaj gjykate, ka ushtruar padi, kundër të paditurit Drejtoria Komunale e Arsimit në Kamenicë, me të cilën ka kërkuar anulimin e kontratës së punës.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë, kjo gjykatë sipas detyrës zyrtare vështroi kompetencën e sajë lëndore, dhe konform neneve 17 dhe 19 të LPK-së, dhe nenit 11 të Ligjit mbi Gjykatat e Rregullta, konstatoi që kjo çështje juridike nuk bie në kompetencën lëndore të Departamentit për Çështje Administrative.

Andaj për të vlerësuar jokompetencën, gjykata iu referua edhe Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, nenit 4.1 të të njetit, i cili përcakton kategoritë e punonjësve publik të cilët nuk janë pjesë e shërbimit civil, ku në bazë të këtij ligji, “statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit arsimor, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe përfomuesit e artit, zyrtarët policor të Policisë së Kosovës, zyrtarët doganor të

Doganave të Kosoves, zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe pjesëtarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të emëruarit politik dhe të gjitha ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i presidentit, kryetarit të kuvendit, kryeministrit dhe kabinetet e ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës, rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, me Marrëveshje Kolektive ose me Rregullore Sektoriale”.

Po ashtu gjykata iu referua edhe Ligjit për Konflikte Administrative nr. 03/L-202 nenit 15.1.1, i cili përcakton se “konflikti administrative nuk mund të zhvillohet: kundër akteve të nxjerra në çështjet, në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ”.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë e në kuptim të neneve 17, 18, 19, 29, dhe 392 pika b) të LPK-së, Ligjit për Gjykatat nr.03/-199 neni 14, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/13 e dt. _____

**Gj y q t a r j a,
M.K.**

Udhëzim Juridik:

Kundër këtij aktvendim pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në afat prej 15 dite, pas marrjes së të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

PADIA E PARREGULLT

Nëse padia nuk e përmban formën e paraparë me Ligjin për Konfliktin Administrativ sipas nenit 30 të po këtij ligji, atëherë gjykata duhet ta zbatoj dispozitën e nenit 33 të Ligjit për Konflikt Administrativ. Kur padia nuk është e plotë e pa kuptueshme ose ka të meta, gjyqtari duhet ta ftoj paditësin që brenda afatit prej 8 ditëve, ti mënjanojë të metat e padisë nga padia jo e plotë dhe e pakuptueshme nuk i ka të gjitha elementet qenësore.

Andaj me ftesë palës paditëse gjykata duhet t'ia cek udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimin për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës. Nëse paditësi, brenda afatit të përcaktuar me njoftim nuk i eliminon të metat e padisë, gjersa ato të meta janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e drejtë të procedurës. Gjykata kompetente do ta hedhë poshtë me vendim padinë nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm. Gjithashtu gjykata në kuptim të dispozitave të ligjit për konfliktet administrative e hedhe poshtë padinë me vendim nëse konstaton se:

1. Padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohshme.
2. Akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ.
3. Nga përmbajta e padisë shihet qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj.
4. Kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur.
5. Është fjala për çështjen sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ.
6. Ekziston vendimi i formës së prerë, i nxjerr në konfliktin administrativ për të njëjtën çështje.

Aktvendimet për plotësimin e padisë

Me nenin 33 të LKAsë, është përcaktuar se:

- Nëse padia nuk është e plotë, është e pakuptueshme ose ka të meta, gjykata do ta ftoj paditësin, që brenda afatit prej 8 ditëve ti mënjanoj të metat e padisë, në ftesë ose (siq ndodhë në praktikë në aktvendim) duhet të ceken udhëzimet për të mënjeluar të metat e padisë dhe paralajmërimi për pasojat që do të lindin nëse nuk vepron sipas këeksës së gjykatës.

Shembulli 1.

Plotësim i padisë në aspektin objektiv dhe subjektiv



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Z.K, në konfliktin administrativ të paditësit “_____” sh.p.k, rr. _____, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson _____, avokat nga Prishtina, rr. “_____” nr.5, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, për shkak të anulimit të vendimit, jashtë seancës, më dt. 30.01.2018, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I.** Paditësit “_____” sh.p.k, i kthehet në plotësim padia e dt.12.05.16, që në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, duhet të bëjë rregullimin e padisë në aspektin subjektiv, ashtu që të përcaktojë saktë të paditurin pasi që në procedurën e konfliktit administrativ vlerësohet ligjshmëria e vendimit përfundimtarë të organit të administratës, andaj palë në procedurë duhet të jetë pala e cila edhe e ka nxjerrë vendimin kontestues apo pala e cila ka refuzuar nxjerrjen e këtij vendimi, detyrohet që gjykatës ti precizojë saktë se kush është palë e paditur cili organ (institucion) i administratës së Republikës së Kosovës dhe të bëjë rregullimin e padisë në aspektin objektiv, që do të thotë të përcaktojë saktë vendimin të cilin e konteston me padi si dhe gjykatës t’ia dorëzoi padinë e përmirësuar dhe provat në të cilat thirret dhe e mbështet padinë në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palën e paditur, e që kanë të bëjnë me çështjen konkrete sipas padisë.

II. Paralajmërohet paditësi se në qoftë se brenda afatit të caktuar si në al. **I** të këtij aktvendimi nuk e bënë rregullimin e padisë së dorëzuar në gjykatë dhe nuk i dorëzon në gjykatë provat e duhura në kopje të mjaftueshme, atëherë gjykata do të merr aktvendim me të cilin do t'a hedhë poshtë padinë si të parregullt, në kuptim të dispozitës së nenit 33.2 të LKA-së.

A r s y e t i m

Paditësi, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, me datë 12.05.16, kundër të paditurës, për shkak të anulimit të vendimit.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, me rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, ka vlerësuar se padia e paditësit është jo e plotë, jo e rregullt pasi që paditësi me padi nuk e përcakton saktë palën e paditur e as vendimin përfundimtar në procedurë administrative, të cilin kërkon ta anulon, përderisa padia është e paqart dhe nga e njejta nuk mund të kuptohet çështja kontestuese, gjykata me një padi të tillë nuk mund të procedojë më tutje.

Me nenin 13.1 të LKA-së, është e përcaktuar se konflikti administrativ mund të filloj vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative të shkallës së dytë. Gjithashtu me nenin 13 par. 2 përcaktohet se konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë kundër të cilit në procedurë administrative ankimi nuk është i lejuar.

Ndërsa me nenin 14 të këtij ligji përcaktohet se konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj.

Pasi që gjykata nuk ka mundësi të procedoj lidhur me këtë çështje, me padinë e parregullt dhe pa kopje të mjaftueshme të provave, të cilat duhet t'i dërgohen bashkë me padi edhe të paditurës, për përgjegje në padi, gjykata në pajtim me dispozitën e nenit 30 lidhur me nenin 33 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/16, dt.30.01.2018,

G j y q t a r j a,
Z.K.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.

Shembulli 2.

Plotësim i padisë në aspektin objektiv



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/15

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Z.K, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësjës Q. P. nga Prishtina të cilën e përfaqëson av. _____ nga Prishtina, kundër të paditurës B. Q. ne Prishtinë, për shkak të heshtjes së administratës, jashtë seancës gjyqësore, më datë _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I.** Paditësjësja Q. P., nga Prishtina, i kthehet në plotësim padia e dt. 29.03.2010, ashtu që në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, duhet të bëjë rregullimin e padisë në aspektin objektiv, ashtu që gjykatës ti sigurojë provat në të cilat thirret në padi e të cilat do ta dëshmojnë se organi i paditur ka heshtur me rastin e kërkesës së bërë nga paditësjësja, ashtu që detyrohet që gjykatës ti precizojë saktë datën e kërkesës së bërë, afatin 30 ditor, të kaluar për përgjigje nga ana e të paditurës, si dhe kërkesën e përsëritur pas kalimit të afatit i cili është shtatë ditor, dhe pastaj të ushtrohet padia në gjykatë, pas plotësimit të padisë obligohet që gjykatës t'ia dorëzoj padinë e përmirësuar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palën e paditur.
- II.** Paralajmërohet paditësjësja se në qoftë se brenda afatit të caktuar si në pikën **-I-** të dispozitivit të këtij aktvendimi, nuk e bënë rregullimin e padisë së dorëzuar në gjykatë dhe nuk i dorëzon në gjykatë provat e duhura në kopje të mjaftueshme, atëherë gjykata do të merr aktvendim me të cilin do t'a hedhë poshtë padinë si të parregullt, në kuptim të dispozitës së nenit 33.2 të LKA-së.

A r s y e t i m

Paditësjësja Q.P., nga Prishtina, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, më datë 29.03.2010, për shkak të heshtjes së administratës respektivisht B. Q.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, me rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, ka vlerësuar se padia e paditëses është jo e plotë, jo e rregullt pasi që paditësja me padi nuk e provon faktin se organi i administratës ka heshtur dhe se janë plotësuar kushtet për hapjen e konfliktit administrativ, gjykata me një padi të tillë nuk mund të procedojë më tutje.

Me neni 14 Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet se: “konflikti administrative mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës së pales, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj”.

Ndërsa neni 29 i LKA-së, par. Përcakton se: nëse organi i shkallës së dytë nuk ka nxjerrë vendim Brenda trishjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita ligjore të veqanta rreth ankimit të pales kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e ka nxjerrë as në afatin prej shtatë (7) ditësh me kërkesën e përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrative sikur ti është refuzuar ankesa.

Bazuar në këto dispozita ligjore paditësja është dashur që padisë ti bashkangjesë kërkesën e bërë organit administrative si dhe kërkesën e përsëritur për nxjerrjen e vendimit sipas kërkesës së parë, e të njejtat nuk gjenden të bashkangjitura padisë.

Pasi që gjykata nuk ka mundësi të procedoj lidhur me këtë çështje, me padinë e parregullt dhe pa kopje të mjaftueshme të provave, të cilat duhet t’i dërgohen bashkë me padi edhe të paditurës, për përgjegje në padi, gjykata në pajtim me dispozitën e nenit 30 lidhur me nenin 33 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/15, dt.07.04.2016

G j y q t a r j a
Z.K.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.

Shembulli 3.

Plotësim padie në aspektin subjektiv



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren A.B, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit D. H. nga Vushtrria rr. “_____” nr. _____, kundër të paditurit Kompania e Ujësjetës Regjional-Mitrovicë Dega në Vushtrri, për shkak të borgjit, jashtë seancës gjyqësore, më datë _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I.** Paditësit D. H. nga Vushtrria, i kthehet në plotësim padia e dt. 05.03.2014, ashtu që në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, duhet të bëjë rregullimin e padisë në aspektin subjektiv, ashtu që të përcaktojë saktë të paditurin pasi që në procedurën e konfliktit administrativ vlerësohet ligjshmëria e vendimit përfundimtarë të organit të administratës, andaj palë në procedurë duhet të jetë pala e cila edhe e ka nxjerrë vendimin kontestues apo pala e cila ka refuzuar nxjerrjen e këtij vendimi, detyrohet që gjykatës ti precizojë saktë se kush është palë e paditur cili organ (institucion) i administratës së Republikës së Kosovës dhe se cilin vendim kërkon ta anulojë ose ta detyrojë të nxjerrë cilin vendim, ngase nga padia nuk mund të kuptohet se cilin akt përfundimtar të organit të administratës kërkon ta anuloj, dhe pas plotësimit të padisë obligohet që gjykatës tia dorëzoj padinë e përmirësuar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palën e paditur së bashku me vendimin të cilin kërkon ta anuloj.
- II.** Paralajmërohet paditësi se në qoftë se brenda afatit të caktuar si në al. **I** të këtij aktvendimi nuk e bënë rregullimin e padisë së dorëzuar në gjykatë dhe nuk i dorëzon në gjykatë provat e duhura në kopje të mjaftueshme, atëherë gjykata do të merr aktvendim me të cilin do t’ a hedhë poshtë padinë si të parregullt, në kuptim të dispozitës së nenit 33.2 të LKA-së.

A r s y e t i m

Paditësi D. H. nga Vushtrria, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, me datë 05. 03. 2016, kundër të paditurit Kompania e Ujësjetës Regjional-Mitrovicë Dega në Vushtrri, për shkak të borgjit.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, me rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, ka vlerësuar se padia e paditësit është jo e plotë, jo e rregullt pasi që paditësi me padi nuk e përcakton saktë palën e paditur e as vendimin përfundimtar në procedurë administrative, të cilin kërkon ta anulon ose cili organ i administratës ka heshtur dhe cila ka qenë kërkesa e palës ndaj atij organi, përderisa padia është e paqart dhe nga e njejta nuk mund të kuptohet çështja kontestuese, gjykata me një padi të tillë nuk mund të procedojë më tutje.

Me nenin 13.1 të LKA-së, është e përcaktuar se konflikti administrativ mund të filloj vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative të shkallës së dytë. Gjithashtu me nenin 13 par. 2 përcaktohet se konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë kundër të cilit në procedurë administrative ankimi nuk është i lejuar.

Ndërsa me nenin 14 të këtij lighji përcaktohet se konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara em këtë ligj.

Pasi që gjykata nuk ka mundësi të procedoj lidhur me këtë çështje, me padinë e parregullt dhe pa kopje të mjaftueshme të provave, të cilat duhet t'i dërgohen bashkë me padi edhe të paditurës, për përgjegje në padi, gjykata në pajtim me dispozitën e nenit 30 lidhur me nenin 33 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/16, dt. _____,

G j y q t a r j a
A.B.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.

Shembulli 4.

Plotësim padie për rregullshmëri



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/15

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Z.K, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit L. F., në Prishtinë rr. _____, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, për shkak të heshtjes së administratës, jashtë seancës gjyqësore, më datë _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I.** Paditësit L. F., në Prishtinë, i kthehet në plotësim padia e dt. 28.09.2010, ashtu që në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi, duhet të bëjë rregullimin e padisë në aspektin objektiv, ashtu që gjykatës ti sigurojë provat në të cilat thirret në padi e të cialt do ta dëshmojnë se organi i paditur ka heshtur me rastin e kërkesës së bër nga paditësja, ashtu që detyrohet që gjykatës ti precizojë saktë se datën e kërkesës së bërë, afatin e kaluar për përgjegje nga ana e të paditurës si dhe kërkesën e përsëritur pas kalimit të afatit i cili është shtatë ditor dhe pastaj të ushtrohet padia në gjykatë, dhe pas plotësimit të padisë obligohet që gjykatës tia dorëzoj padinë e përmirësuar në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe për palën e paditur.
- II.** Paralajmërohet paditësi se në qoftë se brenda afatit të caktuar si në al. I të këtij aktvendimi nuk e bënë rregullimin e padisë së dorëzuar në gjykatë dhe nuk i dorëzon në gjykatë provat e duhura në kopje të mjaftueshme, atëherë gjykata do të merr aktvendim me të cilin do t'a hedhë poshtë padinë si të parregullt, në kuptim të dispozitës së nenit 33.2 të LKA-së.

A r s y e t i m

Paditësi L. F., në Prishtinë, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, me datë 28.09.2010, për shkak të heshtjes së administratës.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë, me rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, ka vlerësuar se padia e paditësit është jo e plotë, jo e rregullt pasi që paditësi me padi nuk e provon faktin se organi i administratës ka heshtur dhe se janë plotësuar kushtet për hapjen e konfliktit administrativ, gjykata me një padi të tillë nuk mund të procedojë më tutje.

Me neni 14 Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet se: “konflikti administrative mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës së pales, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj”.

Bazuar në këtë dispozit ligjore paditësi është dashur që padisë ti bashkangjesë kërkesën e bërë organit administrative si dhe kërkesën e përsëritur për nxjerrjen e vendimit sipas kërkesës së pales, e të njejtat nuk j aka bashkangjitur padisë.

Pasi që gjykata nuk ka mundësi të procedoj lidhur me këtë çështje, me padinë e parregullt dhe pa kopje të mjaftueshme të provave, të cilat duhet t’i dërgohen bashkë me padi edhe të paditurës, për përgjegje në padi, gjykata në pajtim me dispozitën e nenit 30 lidhur me nenin 33 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____ /15, dt. _____,

G j y q t a r j a
Z.K.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesa.

Me nenin 33 të LKAsë, është përcaktuar se:

- Në par. 2 përcaktohet se: nëse paditësi, brenda afatit të cekur ligjorë, nuk i mënjanon të metat e padisë, kurse ato janë të atilla që e pamundësojnë zhvillimin e procedurës, gjykata do ta hedhë poshtë padinë me vendim, nëse nuk konstaton se akti administrativ e kontestuar është i pavlefshëm.

Aktvendimet për hudhjen e padisë

Shembulli 1.

Hudhje e padisë së parregullt



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/15

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren: Z.K, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësja L. F. me seli në Prishtinë rr. _____, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, për shkak të heshtjes administrative, jashtë seancës gjyqësore më dt. _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padia e paditësja L. F. me seli në Prishtinë, e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, për shkak të heshtjes administrative, **si e parregullt**.

A r s y e t i m i

Paditësja L. F. me seli në Prishtinë, më datë 28.09.2010, pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër, për shkak të heshtjes administrative.

Gjykata, pas shqyrtimit paraprak të padisë, shqyrtojë lejueshmërinë dhe rregullshmërinë e padisë së paditëses, dhe pas shqyrtimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës konstatoi se: Padia është e parregullt.

Andaj gjykata më datë 15.02.2016, ka marrë aktvendim me të cilin ka kërkuar që paditësja në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktvendimi të bëjë rregullimin e padisë ashtu siç është kërkuar në kuptim të nenit 33.1 të LKA-së, në të kundërtën padia do të hedhet poshtë si e parregullt. Nga fletë kthesa për dorëzim personal vërtetohet se paditësja aktvendimin për rregullimin e padisë e ka pranuar më datë 24.02.2016, dhe e njëjta as tani e as në afatin e përcaktuar nga gjykata nuk e ka bërë rregullimin e padisë.

Me nenin 33.2 të LKA-së, parashikohet se në qoftë se paditësja nuk e bënë rregullimin e padisë në afatin e paraparë ligjorë, atëherë gjykata e hedhë poshtë padinë e paditësit si të parregullt.

Andaj mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 33 par. 1 dhe 2 të LKA-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____ /15, **dt.** _____

G j y q t a r j a,
Delushe Halimi

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.

Shembulli 2.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/2014

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarja Z.K, në konfliktin administrativ të paditësit, U. M. nga Prishtina, kundër të paditurës, Kompania Rajonale e Mbeturinave, në Prishtinë, për shkak të rimbursimit në emër të borgjit, jashtë seance, me dt. _____, merr këtë,

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë, padia e paditësit, U. M. nga Prishtina, nën shenjë A.nr. _____/2014, e datës 20.07.2012, si e pa plotësuar.

A r s y e t i m

Paditësi, U. M. nga Prishtina, ka ushtruar padi në këtë gjykatë më dt.20.07.2012, kundër të paditurës, Kompania Rajonale e Mbeturinave, për shkak të rimbursimit në emër të borxhit.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të padisë dhe duke i'u referuar aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me numër AA.nr. _____/2014, të datës 29.12.2014, ka gjetur se padia e paditësit është jo e plotë, nga se nga padia, gjegjësisht referatin e saj, nuk dihet se cilin akt të të paditurës e konteston me padi.

Për këtë arsye, me aktvendimin e datës 05.12.2016, paditësi është detyruar nga gjykata, që në afat prej 8 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit aktvendim, ta njoftojnë gjykatën se, cilin akt të të paditurës e kontestojnë me padi. Aktvendim ky i pranuar nga paditësit me dt.07.12.2016.

Paditësi, me parashtresën e dt.14.12.2016, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesapadisë, duke i propozuar gjykatës, që të detyrohet e paditura që paditeses t'ia rimbursoj në tërësi borgjin në emër të kompenzimit në emër të takses vjetore të licencimit në afat prej 15 dite në gjirollogarinë _____ Banka Qendrore e Kosovës, t'i kompenzohet dëmi i shkaktuar duke i paguar edhe kamata për çdo shumë të pa paguar sipas ligjit në fuqi, si dhe t'i kompenzohen shpenzimet e procedurës.

Për të vlerësuar lejshmërinë e paraqitjes së padisë së paditësit, gjykata i'u referuar, Ligjit për Konfliktet Administrative, Nr.03/L-202, neni 13, i të njëjtit përcakton se, "Konflikti administrativ mund të fillojë vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë". Ndërsa paragrafi i dytë i të njëjtit nen përcakton se, "Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar". Kurse neni 14, përcakton se, "Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me këtë ligj".

Po ashtu gjykata i'u referua edhe nenit 9, të të njëjtit ligj, i cili përcakton se, "Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative".

Duke i'u referuar dispozitave të lartëcituara të Ligjit për Konfliktet Administrative, Gjykata nuk ka mundësi të procedoj lidhur me këtë çështje, pa plotësimin e padisë së paditësit, për faktin se, paditësi, nuk e kanë njoftuar gjykatën se, cilin akt të të paditurës e kontestonë me padi, por me parashtresën e dt.14.12.2016, ka kërkuar, që të detyrohet e paditura që paditeses t'ia rimburoj në tërësi borgjin në emër të kompenzimit në emër të takses vjetore të licencimit në afat prej 15 dite në gjyrollogarinë _____ Banka Qendrore e Kosovës, t'i kompenzohet dëmi i shkaktuar duke i paguar edhe kamata për çdo shumë të pa paguar sipas ligjit në fuqi, si dhe t'i kompenzohen shpenzimet e procedurës dhe në këtë kuptim ndaj objektit të kërkesëpadisë së paditësit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ.

Mbi këto arsye, gjykata duke u bazuar në nenin 33.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, padinë e paditësit e hedhë poshtë, si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/2014, dt. _____

G j y q t a r j a
Z.K.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

HEQJA DORË NGA PADIA

Paditësi në procedurën e konfliktit administrativ mund të heq dorë nga padia gjithnjë gjersa gjykata të nxjerr vendimin gjyqësor sipas padisë së ushtruar. Po që se paditësi heq dorë nga padia, gjykata me vendim do ta pezulloj procedurën administrative gjyqësore.

Me nenin 31 1. Paditësi mund të heqë dorë nga padia derisa të mos merret vendimi. Në këtë rast gjykata e pezullon procedurën me vendim.

Shembulli 1.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A. nr. _____/15

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren: A.R, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Z. G. nga Prishtina rr. _____, kundër të paditurit Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar në Ministrinë e Financave, për anulimin e vendimit, jashtë seancës gjyqësore më datë _____, merr:

A K T V E N D I M

Pezullohet procedura në çështjen e konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit Z. G. nga Prishtina, e ushtruar kundër të paditurit Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar në Ministrinë e Financave, për anulimin e vendimit.

A r s y e t i m i

Paditësi, ka ushtruar padi në këtë gjykatë, më dt. 11.12.2015, kundër të paditurit Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar në Ministrinë e Financave, për anulimin e vendimit me nr.84/2015 të datës 30.11.2015.

Mirëpo, paditësi më dt. 11.12.2015, me anë të parashtresës e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë në këtë çështje juridike të konfliktit administrativ.

Andaj gjykata në mbështetje të nenit 31 par. 1 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/15, dt. _____

Gj y q t a r j a,
A.R.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë e përmes kësaj Gjykate.

Si çështje paraprake gjatë shqyrtimit të padisë është edhe pagesa e taksës gjyqësore, për padi, e kjo çështje përmes nenit 63 të LKA-së, është e rregulluar me nenin 253 par. 4 dhe 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/2 të datës 09.03.2012 dhe nr.37/2012 i datës 23.03.2012.

Këtë obligim ligjor, paditësi duhet ta kryejë me rastin e dorëzimit të padisë në gjykatë, mirëpo nëse gjatë shqyrtimit paraprak të padisë vërtetohet se një gjë të tillë nuk e ka bërë atëherë gjykata konform dispozitës së cekur më lartë, në afat ligjorë, ja dërgon vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore për padi, të cilën paditësin është i obliguar ta paguaj në të kundërtën konform nenit 253 par. 5 të LPK-së, i njëjti njoftohet se padia do të konsiderohet e tërhequr.

Shembulli.

Vërejtja për pagesën e taksës gjyqësore



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative

A.nr. _____ / _____

Më dt. _____ 2019,

P r i s h t i n ë

VËREJTJE PËR PAGESËN E TAKSËS GJYQËSORE

Ftohet paditësi/ja _____ nga _____ që sipas lëndës A.nr. _____ / _____ e iniciuar me padinë e datës _____, që në afat prej 15 ditësh, nga marrja e kësaj vërejtje t'ia paguaj taksen gjyqësore për padi në shumën prej ____ **Euro**, ndërsa kopjen e fletëpagesës t'ia dorëzoj gjykatës.

Nëse pagesa e taksës gjyqësore, nuk bëhet në afatin e lartë cekur, atëherë gjykata duke u bazuar në nenin 253.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës të, Nr.01/2017, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, do të merr aktvendim me të cilin do ta konsideron se, është tërhequr padia e paditësit.

Gjyqtare
V.M

Konfrom nenit 253 par.5 të LPK-së, i cili përcakton se: në qoft se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë pas vërejtjes gjyqësore, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

**Aktvendimi për tërheqje të padisë për shkak të
mos pagesës së taksës**

Shembulli 1.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/2016

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren: A.G, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit I. E. nga Egjipti, të cilin e përfaqëson A. B. nga Prishtina, rr. _____, kundër të paditurit Ministria e Punëve të Brendshme Prishtinë, për anulimin e vendimit, jashtë seancës më dt. _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

Konsiderohet se padia e paditësit I. E. nga Egjipti, e regjistruar nën shenjën A.nr. _____/2016 e datës 08.01.2016, **ËSHTË E TËRHEQUR**, për mos pagesën e taksës gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësi, ka ushtruar padi në këtë gjykatë më datë 08.01. 2016, kundër të paditurit Ministria e Punëve të Brendshme Prishtinë, për anulimin e vendimit, me nr. _____/2016 të datës 13.04.2016.

Gjykata, paditësit i ka dërguar vërejtjen gjyqësore me të cilën e ka obliguar që gjykatës ti paguaj taksën gjyqësore në vlerë prej 40, në afatin prej 15 ditëve, në të kundërtën padia do të konsiderohet e tërhequr.

Nga fletë kthesa për dorëzim personal vërtetohet se paditësi vërejtjen për pagesën e taksës gjyqësore e ka pranuar më datë 21.11.2017, mirëpo paditësi as sot e kësaj dite nuk e ka paguar taksën gjyqësore.

Duke pasur parasysh që paditësi në afatin prej 15 ditëve sipas vërejtjes së gjykatës, nuk e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore edhe pse në vërejtjen e gjykatës për pagesën e taksës gjyqësore, është theksuar se në qoftë se paditësi në afatin e caktuar nga gjykata

nuk e paguan as taksën gjyqësore, konform nenit 6.6 të Udhëzimit Administrativ nr. 2008/02 e lidhur me nenin 253 të LPK-së, padia do të konsiderohet se është tërhequr.

Pasi që paditësi nuk ka paguar taksën gjyqësore dhe në rastin konkret nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore, gjykata duke marrë parasysh arsyet e dhëna me lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke u bazuar në nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 253.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe me nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/2, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, i ndryshuar dhe i unifikuar me vendimin e KGJK-së nr.20/2012, të dt.09.03.2012 dhe nr.37/2012, i datës 23.03.2012, si dhe Mendimit Juridik të dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës me nr.64/2016, të datës 18.02.2016.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr. _____/2016 me dt. _____

Gj y q t a r j a,
A.G.

Këshillat Juridike:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.

Me Nenin 387 të LPK-së, i zbatueshëm drejtë për drejtë me neni 63 të LKA-së, me par 1 të këtij neni është përcaktuar se: Me qëllim që çështja të përgatitet sa më mirë për t'u zgjidhur shpejt e drejt, gjykata që nga momenti i arritjes së padisë e deri në momentin e caktimit të seancës për shqyrtim kryesor të çështjes me aktvendim vendosë për:

n) lirimin e palës nga pagimi i shpenzimeve procedurale;

Lirimi nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore është përcaktuar me Nenin 468 të LPK-së, par. 1, ku përcaktohet se:

Gjykata e liron nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore palën e cila, sipas gjendjes së vet të përgjithshme pasurore është në pamundësi t'i përballojë ato shpenzime pa dëmtuar ushqimin e domosdoshëm të vet dhe të familjes së ngushtë të saj.

Ndërsa me nenin 468 par. 5 -Vendimin mbi lirimin nga shpenzimet gjyqësore gjykata e jep brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Shembulli 1.

Aktvendimi për lirim nga taksa



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/13

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren A.G, në konfliktin administrativ të paditëses B. Sh. nga Ferizaj, rr. _____, kundër të paditurës MPMS-DAPK, për shkak të anulimit të aktvendimit, duke vendosur sipas kërkesës së pales paditëse për lirimin nga pagesa e taksës gjyqësore për padi, më dt. _____, mori këtë:

A K T V E N D I M

Pala paditëse B. Sh. nga Ferizaj, LIROHET nga pagimi i taksës gjyqësore për padi, në lëndën A.nr. _____.

A r s y e t i m

Paditësja B. Sh. nga Ferizaj, I ka parashtruar kësaj gjykate kërkesë për lirimin nga pagesa e taksës gjyqësore për padi më datë _____, pasi që e njejta me

Aktvendimin A.nr.____/10, të datës 15.01.2012, të Komisionit për Ndihmë Juridike, ZNJ-Ferizaj, I është lejuar ndihma juridike falas pasi që e njejtja është anëtare e Shoqatës së të shurdhërve të Kosovës.

Gjykata ka vlerësuar pohimet e pales paditëse të cekura në propozim të lartëcekur, dhe ka vërtetuar se paditësja është shfrytëzuese e ndihmës juridike falas në bazë të vendimit A.nr.8/10 të datës 15.01.2012, të Komisionit për Ndihmë Juridike, ZNJ-Ferizaj.

Andaj gjykata duke i marrë parasysh të lartëcekurat, faktin se kemi të bëjmë me paditësen e cila është shfrytëzuese e ndihmës juridike falas, nuk realizon të ardhura personale dhe duke e marrë parasysh se e njejt është antare e Shoqatës së të Shurdhërve të Kosovës, është në pamundësi të përballoj shpenzimet e taksës pa e dëmtuar ushqimin e vet të domosdoshëm, andaj në pajtim me nenet 387 pika (n) lidhur me nenin 468.1 dhe nenin 468.5 të LPK-së si dhe lidhur me nenin 7.2 të Udhëzimit Administrativë për Unifikimin e Taksave Gjyqësore nr.2008/2.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr.____/13, dt._____,

G j y q t a r j a
A.G.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Me nenin 253.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nr.01/2017, të datës 22.03.2017, për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, është paraparë se në rast se nuk plotësohen kushtet ligjore, për lirim nga taksa gjykata me aktvendim e refuzon një kërkesë të tillë.

Shembulli 2.

Aktvendim për refuzim të kërkesës për lirim nga taksa



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. ____/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren, A.G, në konfliktin administrativ të paditëses, F. M., nga Prishtina, Rr._____, kundër të paditurit, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU), baza e kontestit – anulim vendimi të datës 01.06.2017, duke vendosur sipas kërkesës së palës paditëse për lirim nga taksa gjyqësore, jashtë seance me dt._____, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET kërkesa e datës 25.05.2017, me të cilën paditësi F.M, ka kërkuar nga gjykata lirim nga pagimi i taksës gjyqësore në lëndën, A.nr._____/2017.

A r s y e t i m

Paditësi, më datë, 26.05.2017, i ka parashtruar gjykatës kërkesën për lirim nga pagimi i taksës gjyqësore, me arsyetim se është në varfëri i të skajshme dhe se nuk është në gjendje të paguajë taksën gjyqësore, mirëpo që e njëjta nuk ka bashkangjitur dëshmi e me të cilën do të argumentohet se i njëjti do të mund të lirohej nga pagesa e taksës gjyqësore.

Gjykata duke vlerësuar kërkesën e paditëses, ka konstatuar se paditësja nuk ka dëshmuar me asnjë provë se i plotëson ndonjërin nga kriteret e përcaktuara me nenin 8 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/88, i dt.22.03.2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësor për lirim nga pagesa e taksës.

Pasi që paditësi, nuk e ka paguar, taksën gjyqësore dhe në rastin konkret nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga pagimi i të njëjtës, gjykata duke marrë parasysh arsyet e dhëna me lartë, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 253.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 5 dhe 6 të Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Nr.01/2017, të datës 22.03.2017, për Unifikimin e Taksave

Gjyqësore, si dhe Mendimit Juridik të dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës me nr.64/2016, të datës 18.02.2016

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/2017 me dt. _____

**G j y q t a r e,
XX**

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimi të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

PROCEDURA PARAPRAKE NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV

Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në kuptim të nenit 33 par.2 apo nenit 34 të Ligjit për Konfliktet Administrative, atëherë gjykata do t'ia dërgojë nga një kopje të padisë dhe dokumenteve të bashkangjitura në përgjigje, palës së paditur dhe personave të interesuar. Në procedurën e konfliktit administrativ sipas padisë janë të përcaktuara dy faza themelore të procedurës edhe atë:

1. Procedura paraprake sipas padisë
2. Procedura e rregullt sipas padisë.

Procedurën paraprake e karakterizon fakti se në të gjykata nuk shqyrton kërkesëpadinë në mënyrë meritore, por i ndërmerr disa veprime procedurale duke i përmbushur kushtet për fillimin dhe zhvillimin e procedurës në konfliktin administrativ. Në procedurën paraprake gjykata i ndërmerr këto veprime dhe atë:

1. Bënë vlerësimin e përmbajtjes së padisë, nëse padia është e plotë dhe e rregullt. Në këtë drejtim gjykata ka autorizim me padinë të veprjës sikurse me parashtrësat tjera të paraqitura nga palët. Nëse kemi të bëjmë me padi të pakuptueshme dhe jo të plotë. Është kompetencë e gjyqtarit që të kërkoj nga paditësi ta rregulloj padinë duke e udhëzuar si ta përmirësojë padinë dhe njëherit t'ia tërheq vërejtjen për pasojat e mosveprimit.
2. Gjukata bëjnë vlerësimin e padisë në kuptimin e vlerësimit të afatshmërisë, lejueshmërisë dhe paraqitjes së padisë nga personi i autorizuar. Gjyqtari në këtë fazë të procedurës mund të nxjerr aktvendim për hedhjen e padisë si të parakohshme apo si të pas afatshme. Me aktvendim hedhet padia si e pa lejueshme nëse gjyqtari konstaton se me padi kontestohet akti i cili nuk e ka karakterin e aktit administrativ. Padia hedhet kur kontestohet akti jo përfundimtar. Padia hedhet si e pa lejueshme kur konstatohet se kemi të bëjmë me "Res judicata".

Pasi që ti ndërmerr të gjitha këto veprime gjykata padinë me të gjitha shkresat ia dorëzon në përgjigje në padi të paditurit i cili është i obliguar që në afatin prej 30 ditësh, nga dorëzimi i padisë të përgjigjet lidhur me padinë. Në afatin e caktuar pala e paditur ka për detyrë ti dërgojë gjykatës të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me lëndën. Nëse pala e paditur edhe pas kërkesës së dytë nuk i dërgon shkresat e lëndës, apo nëse deklaron se nuk mund ti dërgoj, gjykata do të vendosë për çështjen edhe pa shkresat e lëndës.

Me nenin 37 par.1, është e përcaktuar se: Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë, sipas të paragrafit 2. të nenit 33, apo në bazë të nenit 34 të këtij ligji ose nuk e anulon aktin administrativ sipas nenit 35 të këtij ligji, gjykata do t'ia dërgojë nga një kopje të padisë dhe të dokumenteve të bashkëngjitura në përgjigje palës së paditur dhe personave të interesuar.

Në par.2 përcaktohet se: Përgjigjja jepet në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të padisë në përgjigje palës.

Në par. 3, se në afatin e caktuar pala ka për detyrë t'i dërgojë gjykatës të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me lëndën.

Nëse pala e paditur edhe pas kërkesës së dytë nuk i dërgon shkresat e lëndës, apo nëse deklaron se nuk mund t'i dërgojë, gjykata do të vendosë për çështjen edhe pa shkresat e lëndës.

Shembulli

Aktvendimi për përgjigje në padi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/2018

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtare, M.R në konfliktin administrativ të paditësja, R. H. nga fshati _____, Komuna e Rahovecit, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me bazë anulimin e aktvendimit kontestues, gjatë përgatitjes së seancës për shqyrtim përgatitor - kryesor, më dt. _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. DETYROHET** e paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, që në afat prej 30 ditësh, nga dorëzimi i padisë me të gjitha shkresat të cilat i janë bashkangjitur këtij aktvendimi, t'i paraqesin gjykatës përgjigje në padi në formë të shkruar në dy ekzemplarë, nën kërcënimin e pasojave procedurale, si dhe t'ia dërgoj gjykatës të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me këtë lëndë kontestuese.
- II.** E paditura është e detyruar që në përgjigje në padi, t'i paraqes prapësimet procedurale dhe të deklarohej se e pranon apo e konteston padinë e paditësit. Në qoftë se e paditura e konteston padinë e paditësit, përgjigja në padi duhet t'i përmbaj faktet mbi të cilat e paditura i bazon thëniet e saj dhe provat me të cilat provohen faktet e paraqitura. Përgjigja në padi duhet t'i përmbaj të gjitha elementet e parapara me dispozitën e nenit 37 të LKA-së, lidhur me nenin 99 të LPK-së.
- III.** Në qoftë se përgjigja në padi është e pakuptueshme apo jo e plotë, me qëllim të eliminimit të këtyre të metave, gjykata do të veprojë në pajtim me dispozitën e nenit 37.3 të LKA-së, lidhur me nenin 102 të LPK-së.
- IV.** Personi i cili paraqitet si përfaqësues ligjor është i detyruar që me rastin e ndërmarrjes së veprimit të parë procedural të provon cilësinë e përfaqësuesit ligjor, ndërsa i autorizuari me ndërmarrjen e veprimit të parë procedural është i detyruar që gjykatës t'ia paraqes autorizimin e rregullt.

A r s y e t i m

Gjyqtarja e çështjes në pajtim me dispozitat e nenit 394, 395, al. 1 dhe 2, 396, 397, 99, 102, 77 al.2,93 al. 1 dhe 387 al. 1 pika (a) e LPK-së, lidhur me nenet 5 dhe 37 të LKA-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr.____/2018 me dt._____

**G j y q t a r e,
M.R.**

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

Vërejtje:

Ky është aktvendimi i parë për përgjigje në padi.

SEANCA E SHQYRTIMIT KRYESOR NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV

Karakteristikë themelore e seancës së shqyrtimit kryesor në konfliktin administrativ me rastin e vendosjes sipas padisë është se gjykata në këtë fazë të procedurës vendosë lidhur me kërkesëpadinë duke e zgjidh çështjen kontestuese në konfliktin administrativ (ligjshmërinë e aktit administrativ). Pasi që gjykata nuk e ka hedhë poshtë padinë për shkaqe formale ajo cakton seancën e shqyrtimit kryesor fton palët në mënyrë të rregullt për pjesëmarrjen e tyre në seancë. Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve jo relevante. Në procedurën e konflikteve administrative gjykata mund të vendos në seancë të mbyllur në rast se mund të zbulohen faktet që kanë të bëjnë me jetën private të palëve, mbi sekretin shtetëror, profesional, tregtar dhe me adoptimin. Nëse ka nevojë ftohen edhe ekspertët lidhur me ndonjë fakt për të cilën gjykata nuk ka dijeni. Në seancë mund të marr pjesë në rast nevojë edhe përkthyesi kur palët nuk kuptojnë gjuhën zyrtare e cila zhvillohet në seancën e shqyrtimit kryesor. Gjykata mund të vendos në çështjen pa shqyrtim verbal, nëse ka fakte të mjaftueshme dhe kur palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar. Gjykata mban seancën e shqyrtimit kryesor publike mirëpo në rast se vendos që të përjashtohet publiku atëherë gjykata është e obliguar që të marr vendim procedural të cilën do t'ia komunikonte palëve. Seancën e shqyrtimit kryesor e udhëheq gjyqtari që e udhëheq çështjen. Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor mbahet procesverbali, në të cilin përfshihen vetëm faktet dhe rrethanat esenciale. Procesverbali përfundon me nënshkrimin e gjyqtarit që ka udhëheqë seancën e shqyrtimit kryesor dhe me nënshkrimin e procesmbajtësit. Mungesa e palës në shqyrtimin verbal nuk e pezullon punën e gjykatës. Për shkak të mungesës së palëve nuk mund të konstatohet se ato nuk kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre por do të lexohen parashtrësat e tyre. Nëse në shqyrtim nuk vjen as paditësi e as pala e paditur gjersa shqyrtimi nuk shtyhet, gjykata do të shqyrtojë kërkesën për konflikt administrativ edhe pa praninë e palëve.

Gjykata vendosë në seancën e shqyrtimit kryesor në çështjen e konfliktit administrativ në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative. Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurës administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do ta anulon me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë në rishqyrtim organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerr akt të ri administrativ.

Sipas dispozitave të Ligjit për Konflikte Administrative, ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga

padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë. Gjersa për nulitetin e aktit administrativ gjykata përkujdeset sipas detyrës zyrtare. Për shkak të rëndësisë së pasojave të këtyre akteve administrative Ligji për Konfliktet Administrative e detyron gjykatën që sipas detyrës zyrtare të vlerëson nulitetin e aktit administrativ, pavarësisht se këtë fakt e ka theksuar apo jo paditësi.

Shpallja publike e vendimit të gjykatës, parimisht pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor e cila seancë ka qenë publike, gjykata e shpall aktgjykimin respektivisht vendimin. Në raste të ndërlikuara gjykata mund të heq dorë nga shpallja verbale e aktgjykimin respektivisht vendimit, por jo më vonë se brenda 8 ditësh, të nxjerrë aktgjykimin respektivisht vendimin. Nëse pas përfundimit të shqyrtimit verbal të seancës së shqyrtimit kryesor, gjykata nuk e nxjerrë aktgjykimin, respektivisht vendimin për arsye se duhet më parë të vërtetojë faktin e atillë për shqyrtimin e të cilit nuk nevojitet një shqyrtim i ri verbal, gjykata do të nxjerr aktgjykimin, respektivisht vendimin brenda 8 ditësh, nga data kur do ta ketë vërtetuar këtë fakt.

Me nenin 134 par.1, përcaktohet se: Procesverbali përpilohet për veprimet e kryera në seancë gjyqësore.ndërsa me par.2, përcaktohet se: Procesverbali përpilohet edhe mbi deklaratat dhe njoftimet e rëndësishme që i bëjnë palët ose pjesëmarrësit e tjerë jashtë seancës. Për deklaratat dhe njoftimet më pak të rëndësishme nuk përpilohet procesverbal, por vetëm do të vihet shënim zyrtar në mbështjellësin e lëndës. Me par.3, Procesverbalin e shkruan procesmbajtësi.

Me nenin 135.1, përcaktohet se: Procesverbali duhet t'i përmbajë: emrin e gjykatës, vendin ku kryhet veprimi, ditën dhe orën kur kryhet veprimi, objektin e kontestit dhe emrat e palëve të pranishme ose të personave të tjerë, si dhe të përfaqësuesve ligjorë ose me prokurë të tyre. Ndërsa me par.2 të po këtij neni, Procesverbali duhet të përmbajë të dhëna esenciale për përmbajtjen e veprimit të kryer. Në procesverbalin e seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes duhet të përfshihet sidomos: nëse seanca është mbajtur me dyer të hapura apo të mbyllura, përmbajtja e deklaratave të palëve, propozimet e tyre, provat që i kanë ofruar, provat që janë shfrytëzuar, duke u treguar përmbajtja e thënieve të dëshmitarëve dhe ekspertëve, vendimet e gjykatës të marra në seancë, por edhe vendimi burimor i dhënë pas përfundimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike.

Shembulli 1.

Procesverbali i seancës së shqyrtimit përgatitorë

A.nr. _____/14

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative**

PROCESVERBAL MBI SHQYRTIMIN PËRGATITOR

Përpiluar me dt. _____,

G j y q t a r j a
F.K

Paditësi: N. P. nga Gjilani

E paditura: Komuna _____

Procesmbajtësja
R.S

Lënda: anulim vendimi.

Filluar në ora 09:30

Gjyqtari e hapë shqyrtimin, e publikon lëndën e shqyrtimit dhe konstaton se në shqyrtimin përgatitor janë të pranishëm.

Për paditësin: Personalisht,
Për të paditurën: _____ me autorizim.

Gjykata konstaton se në seancën e sotme prezantojnë të dy palët ndërgjyqëse: paditësi N. P. personalisht si dhe e autorizuar e të paditurës _____, me autorizim, andaj janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës së sotme përgatitor e.

Pas kësaj gjykata merr këtë:

A K T V E N D I M

Që shqyrtimi i sotëm përgatitor të mbahet.

Paditësi, në seancën e sotme kryesore deklaron se, mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës që e njejta të aprovohet në tërësi si e bazur. Më tutje shton se vendimet janë të paligjshme, nga fakti se janë te pa bazuara ne asnjë dispozite ligjore konkrete te çështjes ne shqyrtim.

E autorizuar e të paditurës, në seancën e sotme deklaroi se, mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi të dt. _____, si dhe pretendimeve të theksuara në padi, duke kërkuar nga gjykata që në pajtueshmëri me LKA, të refuzoj padinë e paditësit si të pa bazuar.

Pas kësaj gjykata merr këtë:

A K T V E N D I M

- Detyrohet e paditura që në seancën e shqyrtimit kryesorë, gjykatës t'ia dorëzon provat e përmendura në arsyetimet e vendimeve kontetuese, në dy kopje një për gjykatën dhe një për palën paditëse.
- Seanca e sotme përfundoj në ora _____, ndërsa seanca e radhes caktohet për dt. _____, në ora _____, kjo iu komunikua gojarisht palëve në procedurë dhe do t'iu shërbejë në vend të thirrjeve të rregullta gjyqësore.

Palët prezente pasi e lexuan procesverbalin, të njëjtin e nënshkruan pa vërejtje.

Paditësi

E paditura

V e r t e t o j n e:

Procesmbajtësi

G j y q t a r i

Shembulli 2.

Procesverbali i seancës së shqyrtimit kryesorë

A. nr. ____/14

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative

PROCESVERBAL MBI SHQYRTIMIN KRYESOR

Përpiluar me dt. _____,

G j y q t a r j a
M.R

Paditësi: N. A.

E paditura Komuna e _____

Procesmbajtësja

Lënda: anulim vendimi.

Filluar në ora _____

Gjyqtari e hapë shqyrtimin kryesor, e publikon lëndën e shqyrtimit dhe konstaton se në shqyrtimin kryesor janë të pranishëm.

Për paditësin: Personalisht,

Për të paditurën: _____ me autorizim.

Gjykata konstaton se në seancën e sotme kryesore prezantojnë të dy palet ndërgjyqëse: paditësi N. A. personalisht si dhe e autorizuara e të paditurës _____, me autorizim, andaj janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës së sotme kryesore.

Pas kësaj gjykata merr këtë:

A K T V E N D I M

Që shqyrtimi i sotëm kryesor të mbahet.

Paditësi, në seancën e sotme kryesore deklaron se, mbesim në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke i propozuar gjykatës që e njejta të aprovohet në tërësi si e bazur.

Më tutje shton se vendimet janë të paligjshme, nga fakti se janë bazuar në kallzimin penal të kryeinspektorit për fshehje të informative, gjëja se gjatë vitit.....

E autorizuar e të paditurës, në seancën e sotme kryesore deklaroi se, mbetem në tërësi pranë përgjegjës në padi të dt. _____, si dhe pretendimeve të theksuara në padi, duke kërkuar nga gjykata që në pajtueshmëri me LKA-së, të refuzoj padinë e paditësit si të pa bazuar. Poashtu, kërkoj nga gjyqtari i çështjes, që për verifikimin më të detajuar të rastit në fjalë, të konsultoj Inspektorin e Përgjithshëm, lidhur _____. Përpos atyre që i kemi potencuar në përgjigje në padi, prova tjera në këtë seance, nuk mund të prezantohet.

Pas kësaj gjykata merr këtë:

A K T V E N D I M **Mbi administrimin e provave**

Lexohet aktvendimi i PTH në Prishtinë, i dt. _____,

Lexohen vendimet e të paditurës, nr. ref. _____, i dt. _____;

Lexohet paralajmrimi me shkrim i lëshuar nga MD-së, për paditësin, i dt. _____;

Lexohet njoftimi i prokurorit të shtetit, i dt. _____;

Lexohet referenca e MD-së të dt. _____, si dhe

Lexohet kërkesa e Inspektoriatit të MD-së, drejtuar _____-së të dt. _____.

Pa pyetje, pa prova.

Meqë nuk ka prova tjera, as propozime për plotësimin e tyre, gjykata konstaton se procedura e provave mori fund.

FJALA PERFUNDIMTARE

Paditësi në fjalën përfundimtare deklaroi se, mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, si dhe theksimeve në seancën e sotme, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë ta aprovon në tërësi si të bazuar.

E autorizuar e të paditurës, në fjalën përfundimtare deklaroi se, mbetem në tërësi pranë përgjegjës në padi, si dhe theksimeve në seancën e sotme, duke i propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon në tërësi si të pa bazuar, duke e lënë në fuqi vendimin e të paditurës si të ligjshëm.

Gjykata konstaton se seanca e sotme kryesore përfundoj në ora _____ dhe gjykimi mbyllet.

Palët prezente pasi e lexuan procesverbalin, të njëjtin e nënshkruan pa vërejtje.

Paditësi

E paditura

V ë r t e t o j n ë:

Procesmbajtësi

G j y q t a r j a

AKTGJYKIMI NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV

Sipas dispozitave të Ligjit për Konfliktin Administrativ gjykata vendos për konfliktin administrativ me aktgjykim. Me aktgjykim në konfliktin administrativ padia mundet:

1. Padia të refuzohet si e pabazuar
2. Padia të miratohet.

Në qoftë se padia aprovohet gjykata e anulon aktin administrativ të kontestuar. Pas nxjerrjes së aktgjykimit mbi anulimin e aktit administrativ, lënda i kthehet organit kompetent akti i të cilit është anuluar. Ky organ duhet që të nxjerr akt të ri administrativ në përputhje me pikëpamjen juridike të gjykatës të dhënë me aktgjykim.

Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet mundet nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendos për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar.

Sipas dispozitës së nenit 48 të Ligjit për Konfliktet Administrative, aktgjykimi duhet të përmbaj formën me shkrim dhe se ky aktgjykim duhet të përmbaj këto elemente:

- Hyrja e aktgjykimit
- Dispozitivi i aktgjykimit
- Arsyetimi i aktgjykimit
- Si dhe këshillat juridike.

Elementet të cilat kanë të bëjnë me hyrjen e aktgjykimit janë: emërtimin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit që e gjykon çështjen e të procesbajtësit, emërtimin e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre, objektin e konfliktit administrativ si dhe ditën kur aktgjykimi respektivisht vendimi është shpallur.

Dispozitivi i aktgjykimit duhet të jetë i ndarë nga arsyetimi. Në dispozitiv të aktgjykimit shënohet nëse miratohet padia (anulohet akti administrativ) apo refuzohet padia.

Arsyetimi i aktgjykimit përmban arsyet të cilat pse është miratuar padia apo pse padia refuzohet. Arsyetimi duhet të jetë i plotë duhet të përmbaj arsye nga të cilat gjykata shihet se pse ka vendosur në mënyrën e cekur në dispozitiv. Arsyetimi duhet me qenë bindës dhe duhet ta arsyeton konkluzën juridike të dispozitivit të aktgjykimit.

Këshilla juridike: vendoset në fund të aktgjykimit. Sa i përket mjetit të rregullt juridik-ankesës i epet vetëm për çështjet të përcaktuara shprehimisht me ligj. Gjersa sa

i përket mjeteve të jashtëzakonshme juridike nuk epet këshilla juridike. Aktgjykimi nënshkruhet nga gjyqtari dhe të njëjtit i dërgohen palëve në procedurë.

Dorëzimi i aktgjykimit: aktgjykimet e gjykatës në konfliktin administrativ, palëve u ekspedohet nga një kopje përkatësisht të autorizuarit të palëve. Aktgjykimet u ekspedohen të gjitha palëve pavarësisht numrin e tyre, personave të interesuar, mirëpo kur palët kanë përfaqësues të tyre të autorizuar nga një kopje e aktgjykimit iu ekspedohet përfaqësuesve të tyre. Ekspedimi i aktgjykimit është veprim i rëndësishëm ngase nga dita e dorëzimit fillon të rrjedh afati i mjetit juridik apo të vërtetohet plotfuqishmëria e aktgjykimit. Aktgjykimi ekspedohet nëpërmjet postës, por mund të ekspedohet edhe nëpërmjet punëtorit të autorizuar të gjykatës. Gjithashtu ekspertimi mund të bëhet nëpërmjet postës elektronike. Në rast të këtyllë konsiderohet se është kryer dorëzimi i shkresës në momentin kur është dorëzuar nëpërmjet postës elektronike. Aktgjykimi kundër të cilit lejohet ankimi i veçantë, mjete i goditjes së aktgjykimit, i dorëzohet personalisht palës, përkatësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë. Kur personi të cilit i është dërguar aktgjykimi pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marr në dorëzim aktgjykimin, dorëzuesi do t'ia lë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi. Në fletë dërgesë duhet të shënohet dita ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa. Ky dorëzim konsiderohet se i është dorëzuar në mënyrë të rregullt dhe të ligjshëm palës e cila ka refuzuar marrjen pa arsye ligjore.

Aktgjykimi aprovues: nënkupton atëherë kur gjykata në bazë të provave të nxjerra gjatë seancës së shqyrtimit kryesor ka vlerësuar se padia është e bazuar dhe se akti administrativ i atakuar me padi është nxjerr në kundërshtim me ligjin. Për këtë arsye në arsyetim të aktgjykimit, organit të paditur i sugjerohet se në rishqyrtim është i obliguar që me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri administrativ duhet të zbatoj vërejtjet dhe sugjerimet e gjykatës.

Format e aktgjykimeve në shkallë të parë

Shembulli 1.

Aktgjykimi aprovues



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/2014

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Y.M, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit B. K. nga Prishtina rr. _____, kundër të paditurës Ministria e Arsimit Shencës dhe Teknologjisë-Këshilli Shtetërorë për Njohje të Diplomave dhe Komisioni për Parashtrësia dhe Ankesa, të cilën me autorizim e përfaqëson _____-zyrtarë i lartë ligjorë, me bazë juridike anulimi i vendimit, në shqyrtimin kryesorë publik të mbajtur në prani të palës paditëse e në mungesë të palës së paditur, më dt. _____, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet kërkesëpadia e paditësit B. K. nga Prishtina. **Anulohet** vendimi i të paditurës Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, me nr. _____, i datës _____ dhe çështja i kthehet organit të paditur në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Konform nenit 41 të LKA-së, shqyrtimin kryesorë e mbajti në mungesë të palës së paditur të thirrur me rregull për seancën gjyqësore.

Paditësi, pësonalisht në seancën e shqyrtimit kësor ka deklaruar se: mbetet në tërësi pranë padisë së ushtruar me dt. _____, konsideroj se e paditura ka pas për detyrë që ti respektojë udhëzimet administrative që kanë qenë në fuqi në ditën kur unë kam aplikuar për njohjen e diplomës dhe se unë i kam plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parashikuara me udhëzimet e MASHT për të u njohur diploma e ime e fituar në Universitetin Ndërkombëtar të _____ i cili është i njohur dhe i akreditura nga Bordi për akreditim të Republikës së Maqedonisë që është pjesë e ENQA (Asociacioni Evropian për Siguri të Kualitetit të Lartë) e po ashtu është edhe pjesë e Erasmus Mundus – Standard University QARTER 2010-2013. Ministria e Arsimit në

përgjigjen e parë pas kërkesës time për nohje të diplomës ka deklaruar se nuk mund të bëj njohjen e diplomave që fitohen në Universitetet jashtë Kosovës, që nuk janë pjesë e ENQA-së, gjë që kjo nuk është e bazuar për shkak se sipas shkresës së Këshillit për akreditim dhe evaluim për Arsim të Lartë të Rrepublikës së Maqedonisë nr.15-41/2 të dt. 01.11.2011, si dhe nga shkresa e Universitetit Nsdërkombëtar të Strugës nr.03-100/2 të dt. 13.03.2014, sipas të cilave dokumente rezulton se Universiteti Ndërkombëtarë i Strugës është i akredituar nga Bordi për akreditim dhe vlersim të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë i cili është antar i asociacionit evropian për sigurim të kualitetit në arsimin e lartë – ENQA dhe antarsimi është bërë me dt. 05.10.2011 në mbledhjen e mbajtur në Bukuresht. Unë kam paraqitur ankesë kundër përgjigjes së shkallës së parë dhe me dt. 22.03.2011 nga MASHT-zyra e sekretarit të përgjigjshëm është marrë një vendim me të cilin është mbështetur përgjigja e shkallës së parë nr.1438 e dt. 02.07.2014, me të cilin mbështetet përgjigja nr. _____ e dt. _____, për shkak të këtij vendimi të shkallës së dytë unë jam detyruar që të paraqes padi pranë kësaj gjykate dhe në të njëjtën kohë jam detyruar që të përfundoj edhe studimet master në një kolegji tjetër për shkak të mos njohjes së diplomës së parë të përfundimit të stuidimeve master në Universitetin e Strugës. Bazuar në të cekurat kërkoj nga gjykata anulimin e vendimit të dt. _____, si vendim i kundërligjshëm i pa bazuar në dispozitat e LPKA-së konkretisht të nenit 84, 85 dhe 86 të cilat përcaktojnë përmbajtjen e një vendimi në procedure administrative si dispozitivin, arsyetimin dhe këshillën juridike e të cilat elemente thekësohen vendimi kontestuar nuk i përmban ku konformë dispozitave të cekura më lartë ky vendim nuk mund të qëndroj si i tillë, andaj i propozoj gjykatës që mbi bazën e këtyre deklarimeve vendimin ta anulohet dhe çështjen ta kthejë në rishqyrtim tek e paditura.

I autorizuari i të paditurës, me anë të përgjegjës në padi ka deklaruar se e konteston në tërësi padinë e paditësit si të pabazuar, i ka propozuar gjykatës që në mungesë të provave padia e paditësit të hudhet si e pabazuar.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesorë të dt. _____, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi nr. _____ i dt. _____, përgjegja e dt. _____, ankesa e dt. _____, kërkesa për informim e dt. _____, parashtrësia e dt. _____, shpjegimi i dt. _____.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktit të goditur me padi, në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Me përgjegjën e datës _____, e paditura e ka njoftuar paditësin se në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 08/2010 për Parimet dhe Procedurat e njohjes së diplomave të shkollave të larta profesionale dhe gradave univerzitare të fituara jashtë

Republikës së Kosovës, neni 1 pika 1.3, nuk i plotëson kushtet për njohjen e diplomës së masterit.

Paditësi i paknaqur me përgjegjen e cituar më lartë, ka ushtruar ankesën e datës _____, ku e paditura lidhur me ankesën e paditësit ka nxjerrë vendimin nr. _____, të datës _____, me të cilën e len në fuqi përgjegjën e datës _____.

I pakënaqur me këtë vendim, paditësi ushtron padi në këtë Gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njejtit.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të paditurës të dt. _____, gjykata iu referua Ligjit për Procedurën Administrative, nenit 136 të të njejtit, ku përcaktohet se “organi administrativ që shqyrton ankimin vendosë: a) lënjen në fuqi të aktit dhe rrezimin e ankimit, b) shfuqizimin – revokimin e aktit dhe pranimin e ankimit, c) ndryshimin e aktit administrativ duke pranuar pjesërisht ankimin, d) detyrimin e organit administrativ kompetent për të nxjerrë aktin administrativ, kur është refuzuar pa të drejtë nxjerrja e tij”.

Në këtë kuptim gjykata vlerëson se duke u bazuar në dispozitën e lartëcituar, organi i paditur, ka qenë i detyruar që me vendim të vendosë lidhur me ankesën e paditësit, e jo me vendim ta lenë përgjegjen në fuqi pa e shqyrtuar fare ankesën e paditësit, siç ka vepruar, nga fakti se organet administrative në kuptim të Ligjit për Procedurën Administrative neni 84,85 dhe 86, me vendim vendosin lidhur me ankesën ose kërkesën e palës, duke i respektuar pjesët kryesore të një vendimi hyrjen dispozitivin dhe arsyetimin.

Pasi që e paditura, me vendimin nr. _____ të datës _____, nuk ka vendosur fare për ankesën e paditësit dhe vendimi nuk i përban elementet kryesore në bazë të dispozitave të cituara më lartë, e që në rastin konkret ka qenë e detyruar që të vendosë për ankesën e paditësit të datës _____, e jo të merr vendim lidhur me përgjegjën e lëshuar të datës _____, por të shqyrtoj ankesën e paditësi në kufijtë mbrenda ankesës dhe dispozitave ligjore.

Për këto arsye, të metat e cakura më lartë, janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim, gjykata e obligon organin e paditur në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej 30 ditësh, që në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t’i menjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë, të bazuar në ligj.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/2014, dt. _____,

Procesmbajtësja
N. B.

G j y q t a r j a
Y.M.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Aktgjykim refuzues: Aktgjykimi refuzues i referohet situatës kur gjykata gjatë seancës së shqyrtimit kryesor me prova relevante ka konstatuar se organi administrativ me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ nuk ka bërë shkelje të ligjit si procedural si dhe ligjit material. Nga kjo rezulton se me aktgjykim refuzues vërtetohet ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar nga ana e palës paditëse.

Aktgjykimi nga baza e heshtjes së administratës ka të bëjë me situatën kur paditësi paraqet padi për shkak të heshtjes administrative lidhur me kërkesën apo ankesën e palës, meqë organi administrativ në afatin e përcaktuar me ligj siç është në shkallë të parë 60 ditë, nëse heshtë atëherë pala ka për obligim që në afat prej 7 ditësh, t'ia tërheq vërejtjen organit administrativ që të vendos lidhur me kërkesën e palës, edhe nëse në këtë afat nuk vendos organi administrativ atëherë plotësohet kushti ligjor që të konstatohet heshtja administrative. Gjithashtu heshtje administrative kemi kur organi i shkallës së dytë nuk ka vendos me ankesën e palës paditëse në afat prej 30 ditësh dhe se pala e ankimuar pas 30 dite, ia tërheq vërejtjen organit të shkallës së dytë që të vendos lidhur me ankesën e palës së ankimuar në afat prej 7 ditësh, e nëse edhe në këtë afat nuk ka vendosë organi atëherë pala përmbush kushtin ligjor që të iniciojë konflikt administrativ në bazë të heshtjes administrative. Në rast se gjykata gjen se padia është e bazuar atëherë në dispozitiv të aktgjykimit do të konstaton se padia është e bazuar dhe do ti epet urdhri organit administrativ të paditur, që në afatin e paraparë ligjor të nxjerr vendim lidhur me kërkesën apo ankesën e paditësit.

Shembulli 2.

Aktgjykimi refuzues



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/12

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Y.M dhe me procesmbajtësen N.N në konfliktin administrativ të paditësit Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, të cilën e përfaqëson _____, sipas autorizimit, kundër të paditurit Ministria e Punës dhe Miqenies Sociale (MPMS) – Trupi Ekzekutiv i Inspektoriatit të Punës në Prishtinë, të cilën e përfaqëson e autorizuar _____, nga Divizioni për Përfaqësime i Ministris së Drejtësisë, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor publik, të mbajtur në prezencën e të autorizuarit të paditësit e në mungesë të paditurit, më dt _____, merr këtë:

AKTGJYKIM

Refuzohet kërkesëpadia e paditësit Agjencia Kosovare e Privatizimit në Prishtinë, e ushtruar kundër të paditurit Ministria e Punës dhe Miqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektoriatit të Punës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktvendimit me nr. _____, i dt. _____, **si e pa bazuar**.

A r s y e t i m

Gjykata konform nenit 41 të LKA-së, shqyrtimin gjyqësorë në këtë çështje, e mbajti në prezencë të palës paditëse dhe në mungesë të palës së paditur të ftuar me rregull.

I autorizuari i paditësit në seancën e sotme të shqyrtimit kryesorë deklaroi se: mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë të parashtruar pranë kësaj Gjykate. Duke u bazuar në ligjin e AKP-së nr.04/L-034 nenit 6, AKP-ja ka të drejtë të bëjë emrimin konfigurimin, zëvendësimin e drejtorëve si dhe konstituimin, konfigurimin ose elformatimin e bordit menagjues, këshillit të punëtorëve dhe cilido organ tjetër menagjues në një ndërmarrje shoqërore (NSH). Në momoentin e hyrjes së një ndërmarrje nën administrimin e drejtëpërdrejtë të AKP-së, që në këtë rast ka qenë kompania _____, pushojnë së funksionuari të gjitha organet udhëheqëse të ndërmarrjes, menaxhmentit të ndërmarrjes dhe personave tjerë të ngarkuar me punë në një ndërmarrje. Poashtu neni 6 i Ligjit të AKP-së pika 3 në mënyrë decidive e përcakton se Ligji Themelorë i Punës nr.03/L 112, nuk do të zbatohet me ndonjë veprim të ndërmarrë nga Agjencia nën autoritetin e nenit 6. Në kuadër të këtyre veprimeve edhe çështja e ndryshimit të vendit të punës për punëtorin _____, nuk bie ndesh me dispozitat ligjore të ligjit të punës pasi që i njëjti nuk aplikohet në kuadër të veprimit që ndërmerr AKP-ja lidhur me punëtorët e Ndërmarrjes shoqërore. Bordi i APK-së në vitin _____, ka emruar bordin e përkohshëm menaxhues të _____, ku në momentin e konstituimit të bordit të ri kanë pushuar të gjitha kompetencat dhe organet tjera të NSH-së. Me zgjedhjen e bordit të përkohshëm në NSH _____ dhe përgjigjet me shkrim nga ana e jonë, ne i kemi njoftuar me shkrim _____, që është zgjedh bordi i përkohshëm menaxhues i ndërmarrjes dhe se ai nuk është përfshirë në këtë bord, mirëpo është në listën e punëtorëve pasiv, me fatin e njëjtë të punëtorëve të tjerë të ndërmarrjes. Në Shkrut të vitit _____, Këshilli i punëtorëve të NSH _____, përmes një vendimi me shkrim e ka njoftuar punëtorin se është shkarkuar nga pozita e udhëheqësit të shërbimit financiar dhe i njëjti është transferuar në pozitën të cilën e ka kryer në vitin _____, si ndihmës i kontabilistit. Me rastin e ndërrimit të pozitës së punës janë aplikuar dispozitat e ligjit të punës konkretisht neni 85 dhe 86 me arsyetim se në rastin konkret kemi të bëjmë me shkelje të detyrave pasi që punëtori _____, sipas vendimit të Këshillit të punëtorëve nuk ka bashkpunuar me organet drejtuese të ndërmarrjes, neglizhencës si dhe moskordinimi me drejtorin e NSH-së. Në mars të vitit _____, inspektoriatit i punës në Klinë, ka nxjerr aktvendim me të cilin

rekomandohet që të punësuarin _____, duhet bërë pagesa për punën e kryer më herët si dhe një varg vrejtesh të precizuara. Në prill të vitit _____, TEIP ka nxjerrë aktvendim me të cilin NSH _____, i shqiptohet gjoha në vlerë prej 5.000 € për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit të Punës. Poashtu, edhe në maj të vitit _____, TEIP ka nxjerr vendim me të cilin refuzohet si e pa bazuar ankesa e AKP-së dhe e ka vërtetuar aktvendimin e Inspektoriatit të punës. Në tërë materien e kësaj lënde shihet se me rastin e ndrrimit të pozitës së punës së punëtorit _____, nuk kemi me shkeljen e dispozitave të Ligjit të Punës, pasi që i njejt për punën që ka kryer i ka realizuar të gjitha pagat që i kanë takuar me kontratën e punës dhe në të njejtën kohë punëtori në fjalë për cdo muaj realizon një page mujore si të gjithë punëtorët e NSH _____. Në rastin konkret arsyetimi vendimit të Këshillit të punëtorëve të NSH _____ Insiston në faktin se punëtori _____, gjatë gjithë kohës ka sabotuar me menaxhmentin e ndërmarrjes dhe nuk kanë bashkpunuar me organet drejtuese të NSH-së, prandaj duke pasur parasysh diospozitat ligjore në fuqi dhe gjendjen faktike të përshkruar më partë kërkojmë që të anulohen vendimet e TEIP-së në Prishtinë dhe gjykata të nxjerr aktvendim me të cilin do ta aprovoj kërkespaspdine e paditësit, vendimi i këshillit të punëtorëve të NSH të vërtetohet si i bazuar, të anulohen vendimet e nxjerra nga Inspektoriatet e punës dhe çështja të kthehet në rivendosje. Gjithashtu, deklaroj se TEIP nuk ka pasur kompetencë që të vendosë në lidhje në çështjen kontestuese konform nenit 6 të ligjit nr.04/L-934 të AKP-së.

E autorizuar e të paditurit permes parashtresës së datës _____, ka theksuar se: e konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, mbetet në tërësi pranë vendimit kontestues si të drejtë dhe të bazuar në ligj, i ka propozuar gjykatës që padia e paditësit të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata në seancën e mbajtur më dt. _____, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi _____, i dt. _____, aktvendimi nr. _____ i dt. _____, aktvendimi nr. _____ i dt. _____, ankesa nr. _____, e dt. _____, përgjigja në kërkesën e dt. _____, përgjigja në kërkesën e dt. _____, kërkesa nr. _____, e dt. _____, vendimi nr. _____, i dt. _____, parashtresa e dt. _____, raporti zyrtar nr. _____ i dt. _____.

Gjykata pasi vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Me aktvendimin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale- Trupi Ekzekutiv i Inspektoriatit të Punës në Prishtinë, nr. _____ të dt. _____, është refuzuar ankesa e paditësit e datës _____, dhe është vërtetuar aktvendimi i

Inspektorëve të Punës i TEIP të Kosovës në Obiliq me nr. _____ i datës _____.

Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit mbi refuzimin e ankesës së paditësit, iu referua Ligjit Themelor të Punës në Kosovë nr. 03/L-212, respektivisht dispozitave të nenit 17, 17.1, 17.2, 17.3 ku përcaktohet e gjithë procedura për “sistemimin e të punësuarit në vendin e punës”.

Sa i përket vlerësimit të kompetencës së të paditurit lidhur me marrjen e vendimit kontestues dhe shqiptimin e dënimit me gjobë, Gjykata u bazua në nenin 94 të Ligjit të Punës, me të cilin përcaktohet se “ mbikqyrja e zbatimit të dispozitave të këtij ligji të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës, sigurinë dhe mbrojtjen në punë, e bënë Inspektoriati i Punës në bazë të Ligjit për Inspektoriatin e Punës dhe Ligjin nr. 2003/19 për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës.

Gjykata iu referua edhe dispozitave të nenit 15 të Ligjit 2003/19, Për Siguri në Punë dhe Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës mbi masat ndëshkimore ku përcaktohet se cilat janë gjobat për ndëshkimin e shkeljeve të këtij ligji dhe nenin 17 të po këtij ligji mbi kompetencat e Inspektoriatit për mbikqyrjen e zbatimit të këtij ligji.

Bazuar në dispozitat e lartëcituarra, paditësi ka qenë i detyruar të respektoj dhe të zbatoj dispozitat e lartëcekura me rastin e trajtimit të punëtorëve të punësuar tek punëdhënësi, e në rastin konkret të punëtorit _____.

Mosrespektimi i ktyre dispozitave ligjore vërtetohet edhe nga raporti zyrtar nr. _____, i shiqimit të vendit të ngjarjes i datës _____, nga ana e Trupit Ekzekutiv të Inspektoriatit të Punës në Obiliq, në të cilin është konstatuar se me rastin e inspektimit kompania nuk e ka prezantuar shifren e veprimtarisë, me arsyetimin se e kërkuan por nuk e gjetën dhe se do ta prezantijnë në ndërkohë. Ky kontroll është bërë në bazë të kërkesës së punëtorit _____, ku në bazë të fakteve dhe provave të ofruara nga i njëjti del se ka punuar në këtë kompani deri me dt. _____, kurse nga këshilli i punëtorve të kësaj kompanie me propozim të drejtorit të kompanisë i është përgaditur vendimi për shkarkimin e tij nga pozita e udhëheqësit të shërbimit ekonomiko-financiar, në pozitën në të cilën ka qenë në vitin _____, për të cilën gjë e merr vendimin me nr. _____ të dt. _____, gjoja për shkak të neglizhencës, mos bashkëpunimit, dhe moskordinimit të punëve me drejtorin e kompanisë.

Ky degradim i _____, vjen në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, edhe përkundër se i njëjti e posedon kontratën e punës, vërtetimin e datës _____, me të cilin vëretohet se _____, punon në këtë kompani që

nga viti _____, në punët dhe detyrat e punës udhëheqës i shërbimit ekonomik financiar me pagë _____ euro, të lëshuar dhe nënshkruar nga drejtori _____ . Gjithashtu, punëtori i ka ofruar edhe dokumente e prova të tjera të cilat përshkruhen si në raport.....nga ky raport gjykata vërenë se paditësit i është dhënë afati ligjor për përmbushjen e obligimeve të dhëna nga inspektori i punës në pajtim me ligjin në fuqi.

Gjykata vërenë se, nga mos përmbushja e obligimeve të paditësit të dhëna me anë të procesverbalit të datës _____, pasojnë edhe vendimet e të paditurit, të cilat edhe kontestohen me padi.

Nga kjo gjykata vërenë se paditësi nuk i ka respektuar dispozitat ligjore të përmendura më lartë për mbrojtjen dhe trajtimin e punëtorve në punë dhe se ka ardhur deri te shkelja e dispozitave të ligjit të punës.

Gjykata vlerësoi edhe thëniet e paditësit në padi dhe në shqyrtim kryesorë, edhe lidhur me kompetencën e të paditurit për marrjen e vendimeve kontestuese, mirëpo të njëjtat i refuzoi si të pabazuara nga shkaku se nuk kanë mbështetje ligjore, ngase edhe pse kompania është nën administrimin e AKP-së, ka qenë e obliguar të respektojë dispozitat ligjore të ligjit të punës në fuqi me rastin e degradimit të punëtorit _____, dhe se për mbikëqyrjen e mos zbatimit të ligjit dhe këtyre shkeljeve është kompetent Inspektoriati i Punës.

Nga kjo gjykata vlerëson se aktvendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të drejtës materiale, kur ka refuzuar ankesën e paditësit. Mbi këto arsyeza kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit.

Duke u bazuar në të dhënat e lart cekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____, **dt.** _____,

Procesmbajtësja
N.N.

G j y q t a r j a:
Y.M.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Me dispozitën e nenit 46 të LKA-së përveç aktgjykimeve të cituara më lartë, me par. 4 është përcaktuar se: "kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të

anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative. Aktgjykimi e zëvendëson aktin e anuluar”.

Shembulli 2.

Aktgjykimi - vendosja në mënyrë meritore



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/2017

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Y.M dhe me procesmbajtësen N.N, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses N. M. të cilin e përfaqëson av. _____, sipas autorizimit, kundër të paditurës Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-DAPK, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, për anulimin e vendimit, në shqyrtimin kryesorë publik të mbajtur në prani të autorizuarit të paditëses, e në mungesë të palës së paditur, më dt. _____, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I.** Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N. M. nga Prishtina, Anulohet aktvendimi i të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë/Departamenti i Administratës Pensionale me nr. _____ i datës _____.
- II.** Detyrohet e paditura, MPMS/DAP që paditëses t'ia njohë të drejtën në pensionin për persona me aftësi të kufizuar për periudhën 5 (pesë) vjeçare nga data 01.02.2014 - 01.02.2019, në shumë prej 75 euro për muaj, pas kësaj periudhe paditësja është e obliguar ti nënshtrohet procedurës së rivlerësimit.
- III.** Obligohet e paditura, që në mënyrë retroaktive t'ia kompensoj pensionin e ndërprerë pa të drejtë nga data 01.01.2012, në vlerë prej 60 euro për çdo muaj deri në mars 2014, ndërsa nga data 01.04.2014 për çdo muaj në vlerë prej 75 euro deri në ekzekutimin e këtij aktgjykimi, pagesën definitive duke llogaritur edhe kamatën ligjore sikurse për mjetet e afatizuara për një vit pa destinim të caktuar në bankat e Kosovës, në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.
- IV.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.
- V.** Ky aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar.

Arsyetimi

Gjykata shqyrtimin gjyqësorë në këtë çështje e mbajti duke u bazuar në Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit A.A nr. _____, të datës _____, duke i marrë parasysh vërejtjet dhe sugjerimet në këtë aktgjykim. Gjykata vendosi që në shqyrtim kryesor mos të bëjë ballafaqimin e ekspertëve mjekësorë të caktuar nga Gjykata dhe të mjekëve të komisionit mjekësorë të paditurës pasi që bazuar në nenit 369 të LPK-së par. 2 përcaktohet se: “ Në qoftë se të dhënat e ekspertëve në konstatimin e ekspertve dallohen esencialisht, apo nëse konstatimi i tyre është i pa qartë, jo i plotë, apo kontradiktor me vetëvehten apo me rrethanat e shqyrtuara, e këto të meta nuk mund të evitohen me dëgjimin e përsëritur të ekspertve, do të përsëritet ekspertimi me ekspertë të njejtë apo me ekspertë të tjerë.” Bazuar në këtë dispozitë ligjore, gjykata nuk ka mundur të zbatoj sugjerimet në vendimin e gjykatës së Apelit, nga shkak se në këtë çështje gjykata ka të caktuar vetëm një ekspertizë mjekësore, e cila është shumë e qartë për gjykatën, nuk është kundërshtuar nga e paditura në asnjë fazë të procedurës në gjykatë as drejtëpërsëdrejti e as me parashtrësë, andaj gjykata nuk ka pasur nevojë as për plotësim të ekspertizës e as për dëgjim të ekspertve lidhur me sqarimet në ekspertizën e datës _____, ngase e njehta është e qartë dhe gjykata i ka falur besimin.

Ndërsa sa i përket raportit mjekësorë të komisionit mjekësorë të paditurës, gjykata të njejtin e ka vlerësuar si provë mirëpo i njejtin komision është në kundërshtim me vetveten sepse njëherë paditësen e shpallë të pa aftë për punë ku me vendimin dhe vlerësimin e vet të datës _____, i njehtin të drejtë në kohëzgjatje prej tri viteve pastaj më datë 21. 06. 2007 i vazhdon këtë të drejtë edhe për pesë vite të tjera, ndërsa i njejtin komision më vonë më datë 06. 04. 2012, i ka refuzuar vazhdimin e kësaj të drejte me arsyetimin se paditësja është e aftë për punë. Duke marrë parasysh këtë fakt si dhe faktin se e paditura nuk e ka zbatuar vendimin e gjykatës të datës 28.10.2013, me të cilin është anuluar vendimi dhe çështja i është kthyer në rishqyrtim, gjykata në shqyrtimin gjyqësorë të datës 07.02.2017, vet e ka vendosur çështjen konform nenit 43 par. 3 dhe 67 të LKA-së, duke e marrë edhe mendimin dhe konstatimin e ekspertëve mjekësorë të pavarur të QKUK-së.

Gjykata vlerëson se raporti mjekësor i komisionit mjekësor të paditurës, nuk është ekspertizë mjekësorë nga ekspertë të pavarur të QKUK-së, të caktuar nga Gjykata, por është një raport mjekësor i mjekëve specialist të lëmive përkatëse të caktuar me vendim të paditurës, e cila në gjykatë e ka vetëm vlerën e një prove të ofruar për vlerësim, dhe i njejtin raport nuk mund të trajohet me nenin 369 të LPK-së, pasi që neni në fjalë ka të bëjë me obligimin e gjykatës në raport me ekspertizat e caktuara nga ana e gjykatës në procedurë gjyqësore.

Andaj, Shqyrtimi kryesorë në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 41 të LKA-së, në prezencë të autorizuarit të paditëses, e në mungesë të paditurës e ftuar në mënyrë të rregullt.

I autorizuari i paditëses, në seancën e shqyrtimit të sotëm kryesor deklaroi se, mbetet pranë pretendimeve të mëhershme të theksuara në padi dhe kundërshtoi aktgjykimin e Gjykatës së Apelit që çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje dhe që të bëjë ballafaqimin e mjekëve të MPMS me ekspertët e QKUK-së. Gjykatës i propozoi që të mbetet në fuqi vendimi i Gjykatës Themelore A.nr. _____, i dt. _____, më tej i autorizuari i paditëses, në fjalën përfundimtare deklaroi se, Vendimi i Gjykatës së Apelit A.A.nr. _____, është jo i drejtë, prandaj kërkoj që vendimi i Gjykatës Themelore të mbetet në fuqi ashtu që të paditurës iu ka njohur e drejta për pension për persona me aftësi të kufizuar.

E paditura përmes parashtresës së datës _____, ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, duke i propozuar gjykatës që e njejta të refuzohet si e pabazuar ndërsa aktvendimi i kontestuar të mbetet në fuqi si vendim i drejtë i bazuar në ligj. Ndërsa e njejta nuk prezenton në seancën gjyqësore edhe pse e ftuar me rregull.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesorë të datës _____, ka bërë administrimin e provave dhe atë: aktvendimi mbi administrimin e provave i marrë në procesverbalin e dt. _____.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur në përputhje përputhje me nenin 44.3 dhe nenit 67 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e **bazuar**.

Pasi që gjykata me aktgjykimin A.nr. _____, të datë _____, njëherë ka vendosur në këtë çështje, me ç' rast organi i paditur nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të dhëna në këtë aktgjykim, për këtë arsye kjo gjykatë duke u bazuar në neni 43.3 dhe 67 të Ligjit për Konfliktet Administrative vendosi që vetë meritorisht ta vendosë këtë çështje administrative.

Gjykata për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje, përkatësisht për ta përcaktuar drejtë shkallën e paaftësisë fizike të paditëses, sipas detyrës zyrtare ka nxjerrë provë me ekspertizë, e cila është përgatitur nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës në Prishtinë, përkatësisht nga komisioni mjekësor i QKUK-së, në përbërje të tre specialistëve, të cilët në vlerësimin e tyre me shkrim të datës _____, bazuar në gjendjen shëndetësore, pas ekzaminimit direkt të pacientes N. M., dhe konstatimeve të bëra st post contusionem cerebri(gjendje pas ndrydhjes së trurit) st. Post shunt V-P lat.dex. pp.Hydrocephalus posttraumatica (gjendje pas vendosjes së pompës ventrikulo-peritoneale për shkak të hidrocefalis pas traumatike, hirsutismus

(rritje jonormale e çimeve të tipit mashkullor nëpër trup te femrat-çrregullim hormonal) hemiparesis lat.dex. (dobësi e anës së djathtë të trupit dhe gjymtyrve), fractura femoris lat.dex. (osteosynthesis) - (theyrje e këmbës së djathtë) retardatio psicomotorica (ngecje në zhvillim psikomotorik) sy.ataxicum-ataxia cerebellaris (sindroma e çrregullimit të ekuilibrit) e që në bazë të kësaj gjendje të konstatuar kanë ardhur në përfundim se te paditësja, ekzistojnë dëmtime të cilat cilësohen si të rënda trupore dhe me pasoja të përhershme, ku në bazë të formulës llogaritëse sipas ekspertizës del se paditësja N. M. ka paaftësi fizike të përhershme të aktivitetit të përgjithshëm jetësor.

Nga vlerësimi i mendimit të komisionit mjekësorë të QKUK-së të datës _____, gjykata vërteton se këtu paditësja, ka lëndime trupore me dëmtime të përhershme të cilat kanë ndikuar në zvogëlim aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe se e njëjta ka paaftësinë e plotë dhe të përhershme jetësore, kusht ky ligjor, për njohjen e të drejtës në pensionin e Personave me Aftësi të Kufizuar, i përcaktuar nga neni 3 i Ligjit nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë.

Prandaj, gjykata vërteton se në bazë të mendimit të dhënë nga Komisioni Mjekësor i QKUK-së të datës _____ dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesorë, paditësja i plotëson kushtet për njohjen e pensionit për personat me aftësi të kufizuar, përkatësisht kriteret nga neni 3 të Ligjit nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë dhe mbi këto arsye edhe aktvendimi kontestues i të paditurës është i pa drejtë dhe i pa ligjshëm.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës dhe gjen se të njëjtat janë të pa bazuara, sepse me provat e administruara, në kuptim të dispozitës së Ligjit nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuar në Kosovë, është vërtetuar se paditësja i plotëson kushtet ligjore për njohjen e të drejtës së kërkuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të LKA-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Andaj bazuar në të lart cekurat, kjo gjykatë në kuptim të nenit 43.3, 46.2, 5 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____, **dt.** _____

Procesmbajtësja
N.N.

G j y q t a r j a
Y.M.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita te marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Shembulli 3.

Aktgjykim në bazë të heshtjes administrative



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/2010

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Y.M e me procesmbajtësen N.N, në konfliktin administrative sipas padis së paditësit D. K. i përfaqësuar nga përfaqësuesi ligjor- babai _____ nga Prishtina, rr. _____, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të heshtjes administrative, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit ligjorë të paditësit e në mungesë të paditurit, më dt. _____, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditëses D. K. nga Prishtina, dhe Urdhërohet e paditura Komuna e Prishtinës-Drejtoria Komunale për Arsim, që në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, të merr vendim sipas ankesës së paditësit të protokoluar nga e paditura, më nr. _____, te dt. _____, dhe të njejtin, t'ia dorëzoj paditësit, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.

A r s y e t i m

Gjykata shqyrtimin gjyqësorë në këtë çështje e mbajti konform nenit 41 të LKA-së, në prani të përfaqësuesit ligjorë të paditësit _____, e në mungesë të paditurit të thirrur me rregull.

Përfaqësuesi ligjor i paditësit prezent në seance deklaroi se: Mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkespadiës duke shtuar se bazuar në provat e dorzuara dhe pretendimet si në padi e të cilat gjenden në shkresat e lëndës i propozon gjykatës që të sjell një vendim të drejtë. Paditësi deklaroi se pas pranimit të vendimit të dt. 29.01.2010 nga ana e komisionit disiplinor të DKA-së të njejtin vendim e ka atakuar me ankesën e dt. 08.02.2010, mirëpo e paditura nuk ka marrë asnjë vendim lidhur me ankesën e ushtruar edhe pas kërkesës së dytë. I propozon gjykatës që të detyrohet e paditura që të nxjerr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj gjithnjë sipas kërkesës – ankesës së ushtruar më dt. 08.02.2010, kundër vendimit të Komisionit disiplinor të dt. 29.01.2010.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt. _____, ka bërë administrimin e provave dhe atë: ankesa e dt. _____, ankesa e dt. _____, njoftimi i dt. _____, procesverbali i dt. _____, ankesa e dt. _____, njoftimi i dt. _____, deklarata e dt. _____, ankesa e dt. _____, kërkesa e dt. _____, vendimi i dt. _____, njoftimi për vendimin e komisionit disiplinor të DKA-së i dt. _____, ankesa e dt. _____, njoftimi i dt. _____, thirrja e dt. _____, vendimi i dt. _____, kërkesa e dt. _____, përgjegjia e dt. _____, komenti i dt. _____, procesverbali i dt. _____.

Gjykata vlerësoi pretendimet e paditëses për heshtje administrative dhe nga shkresat e lëndës vlerësoj se padia është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se paditësi më dt. 08.02.2010, i ishte drejtuar me ankesë të paditurës, kundër vendimit të datës 29.01.2010, mirëpo e njëjta nuk ka vepruar vepruar në afatin e caktuar ligjor. Po ashtu, më dt. 30.03.2010, i ka parashtruar kërkesë të veçantë për vendosjen sipas ankesës së dt. 08.02.2010, por e paditura nuk ka marrë asnjë vendim lidhur me ankesën e paditësit, e as që e ka njoftuar paditësin lidhur me çështjen e tij.

Sipas nenit 76 dhe 77 të Ligjit për Procedurën Administrative (Ligji 02/L-28) organi administrativ, në këtë rast e paditura, ka pasur obligim që të marr vendim lidhur me ankesën e paditëses, ndërsa e paditura në kundërshtim me ligjin, ka heshtur dhe nuk ka marrë vendim e as nuk i është përgjigjur në asnjë formë paditëses.

Me nenin 29 par. 1 të Ligjit për Konflikt Administrativ, është paraparë se nëse organi i shkallës së dytë, në afatin prej 30 ditësh, nuk merr aktvendim sipas ankesës-kërkesës, e këtë nuk e bënë as në afatin tjetër prej 7 ditësh, pas paraqitjes së kërkesës së përsëritur, pala mund të filloj kontestin gjyqësor, sikur ankesa-kërkesa të ishte refuzuar.

Meqenëse e paditura nuk ka marrë vendim, as pas kërkesës së përsëritur të paditësit të dt. 30.03.2010, gjykata vlerëson se paditësi me të drejtë ka inicuar kontestin gjyqësor kundër të paditurës, për shkak të heshtjes së administratës, meqenëse marrja e vendimit sipas ankesës së paraqitur dhe dorëzimi i saj, palës në procedurë, është obligim i organit të paditur.

Me nenin 131.2 të Ligjit për Procedurë Administrative, është paraparë se në qoftë se me kalimin e afatit të parashikuar për ankim, nuk është nxjerrë asnjë vendim mbi ankimin nga organi administrativ kompetent, palëve të interesuara, iu lindë e drejta për t'iu drejtuar gjykatës, në përputhje me ligjin.

Mbi këtë gjendje të fakteve, kjo gjykatë konstaton se në këtë çështje administrative-juridike, ligji është zbatuar në dëm të paditësit, kështu që në riprocedurë, organi i paditur, do të ketë parasyshë theksimet nga ankesa e paditëses, do të vërtetoj faktet relevante dhe pastaj, do të marr një vendim të drejtë të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura, janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Prandaj, bazuar në të lartcekurat, në kuptim të nenit 5, 6, 29 dhe 38, si dhe nenit 46.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata ka aprovuar padinë e paditëses dhe ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____, **dt.** _____

Procesmbajtësja
N.N.

G j y q t a r j a
Y.M.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Shembulli 4.

Aktgjykim pas aprovimit të kërkesës për rishikim



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. 1244/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtar, në konfliktin administrativ të paditësit, _____ Prishtina, rr. _____ nr. _____, të cilën e përfaqëson me autorizim _____, avokate nga Prishtina, kundër të paditurës, Ministria e Administratës Publike në Prishtinë dhe palës së interesuar, Asociacioni i Arkitektëve të Kosovës nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson, _____, nga Prishtina, për shkak të anulimit vendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në prani të autorizuarës së palës paditëse, e në mungesë të palës së paditur dhe palës së interesuar me dt. _____, merr këtë,

A K T G J Y K I M

- I.** Shfuqizohet aktgjykimi i kësaj gjykate nën shenjën A.nr. _____, i dt. _____, lejohet rishikimi sipas kërkesës së palës së interesuar, _____ nga Prishtina, të cilin me autorizim e përfaqëson, _____, nga Prishtina.
- II.** Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit, _____, të cilën e përfaqëson me autorizim, _____, avokate nga Prishtina. Anullohet vendimi i Ministrisë së Administratës Publike nr. _____ i dt. _____ dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura.
- III.** Refuzohet si të pabazuara, propozimet e të autorizuarës së paditësit, që kërkesa për rishikim e palës së interesuar të konsiderohet e terhequr, apo të hedhet poshtë si e pasafatshme.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në prani të autorizuarës së palës paditëse e në mungesë të palës së paditur dhe palës së interesuar të thirrur në mënyrë të rregullt.

E autorizuar e palës paditëse, _____, në seancë e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se me qenëse pala e interesuar, ka iniciuar kërkesën për rishikim përball faktit se është ftuar në mënyrë të rregullt dhe seanca për shkak të mospjesëmarrjes së tij shtyhet që dy herë, konsiderojmë se janë plotësuar kushtet për tërheqje të kërkesës për rishikim. Nëse gjykata nuk e vlerëson propozimin për konsiderim të tërheqjes së kërkesës për rishikim në bazë të provave të cilat janë parashtruar me përgjigje e të cilat provojnë datën kur pala e interesuar ka qene e informuar me aktgjykimin e plotëfuqishëm të kësaj gjykate, kërkesa e paraqitur për rishikim me shumë se një vit pas njoftimit, në kuptim të nenit 57.1 në lidhje me nenin 60.2 të LKA-së nuk është e lejuar. Ka theksuar se mbetet në tërësi pranë gjitha parashtrimeve të cilat janë prezantuar në përgjigjen për rishikim, duke venë theksin në çështjet e legjitimitetit të përfaqësuesve të palës së interesuar, dhe legjitimitetit të paditësit, të cilat janë shtjelluar në pikën II dhe III të përgjigjes. Për më tepër edhe pas aktgjykimit të plotëfuqishëm të gjykatës, kundër të cilit është iniciuar kërkesa për rishikim ka pasur ndryshime pranë zyrës së _____ dhe atë me vendimin e datës _____, dt. _____ dhe dt. _____, të cilat vendime në procedurë të rregullt administrative asnjëherë nuk janë goditur dhe janë në fuqi dhe reflektojnë ndaj një anëtarësie të gjerë të Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës, në pajtim me dispozitat e statutit të saj, të cilat janë të referuara në pikën 4.2 të përgjigjes në kërkesë. Gjë që e bënë të njëjtën jo lëndore për trajtim, të një vendimi, i cili me nuk është në fuqi dhe është zëvendësuar me vendimet e referuara më sipër të pranuar si të rregullta nga autoriteti kontraktues. Statuti i Shoqatës së _____, përcakton se _____ është një organizatë vullnetare, e cila bashkon të gjithë _____, që janë të interesuara të jenë pjesë e kësaj shoqate. Kur peshohet një vendim dhe atë post festum prej 9 nënshkrimeve të cilin në procedurën e rishikimit edhe autoriteti përkatës e ka shpallur absolutisht nule, me vendimet prej mbi 100 anëtarëve të shoqatës, besoj që as zyra OJQ-ve dhe as gjykata nuk mundë të veprojnë ndryshe, pos të respektojnë vullnetin e anëtarësisë, shumicë të _____. Në kuvendet e kontestuara nga pala e interesuar si në provat e bashkangjitura në përgjigje, do të potencojë se të njëjtat janë thirrur nga themeluesit e shoqatës. Provohet me prova në shkresat e lëndës se përfaqësuesit e palës së interesuar janë ftuar, por nuk ka marrur pjesë. Pashtu provohet me imailat të cilët janë drejtuar edhe palës së interesuar, dhe në këto kuvende ka vendosur gjithmonë një anëtarësi e gjerë, prej mbi 100 _____. Në dallim prej një vendimi me të cilin, pala e interesuar pretendon ti japë vetës legjitimitetin e palës në këtë procedurë, e për të cilin edhe e paditura është deklaruar se është dhënë në lajthim. Prandaj i ka propozuar gjykatës, që pas administrimit të gjitha provave, nëse kërkesën nuk e konsideron si të tërhequr apo si të palejuar, atëherë ta refuzoj si të pabazë të njëjtën.

E paditura, Ministria e Administratës Publike, me përgjigjen në rishikim të datës 05.10.2018 ka deklaruar se i kundërshton si të pabazuara kërkesën për rishikim me arsyetimin, se _____, administrohen dhe zgjidhin organet e tyre drejtuese ekzekutive duke u bazuar në statutin e tyre. Drejtuesi i shoqatave të _____ nuk emërohen dhe shkarkohen nga Departamenti për OJQ-Ministria e Administratës

Publike, por emërohen dhe shkarkohen nga Kuvendi i Organizatës Joqeveritare. Duke u bazuar në dispozitat e statutit të organizatës gjegjëse, si dokument me i lartë juridik, në mënyrë plotësisht të pavarur në kuptim të nenit 13 paragrafi 1 të Ligjit nr.04/L-57 për Lirinë e Asocimit në Ministrinë e Administratës Publike-Departamenti për OJQ-në, respekton plotësisht autonominë e organizatave joqeveritare. Ato zhvillojnë aktivitetin e tyre, duke përfshi zgjedhjen e organeve drejtuese dhe ekzekutive, në bazë të statutit dhe Ligjit për OJQ-të. Drejtuesit e shoqatave të OJQ-ve nuk emërohen dhe as nuk shkarkohen nga Ministria e Administratës Publike-Departamenti për OJQ, por nga kuvendet e organizatave joqeveritare, ndërsa për fondacione këtë te drejt e kane bordet (kryesitë). I ka propozuar gjykatës që kërkesa për rishikim të refuzohet si e pa bazuar.

Pala e interesuar me parashtresën e datës 06.09.2018 ka deklaruar, se _____, nuk kemi ushtruar padi ndaj vendimit të MAP-it me nr. ____dt.____ dhe as që është bërë nga ne, e as nga personi ynë i autorizuar, ku si person i autorizuar është dhe ka qenë _____ kryetar dhe person i autorizuar. Dhe sipas vendimit të datës _____ me nr.____ shih paragrafin II po të njëjtit vendim, ku si person i autorizuar mbetet _____, i cili vendim është në fuqi dhe e cila provë ka qenë e prezantuar para jush, por nuk e kemi marrë parasysh, citojmë piken II. Ka theksuar se ne _____ e përfaqësuar nga _____, nga Prishtina, i propozojmë gjykatës që të aprovohet kërkesa për rishikim dhe aktgjykimi i datës _____, në lëndën A.nr._____ të shpallet i pavlefshëm.

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt._____, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi i të paditurës nr.4324 i datës 02.09.2013 dhe nr.5116, të datës 25.10.2013, përgjigja e MAP-it e datës 18.07.2013, vendimi i MAP-it i datës 14.05.2013, njoftimi i paditëses drejtuar MAP-it, i datës 12.07.2013, komunikimi elektronik në mes të Ilir Murseli dhe Afrim Bakallit i datës 12.07.2013, komunikimi elektronik në mes të Drita Grezhda, Bashkim Beqaj, Gazmend Bunjaku, Muhamet Sadriu, Blerim Çeku, Shemsi Kelmendi, Ramë Hamzaj, Feriz Musliu, Shend Kabashi dhe të paditurës të datës 12.07.2013, shikimi në Statutin e Asociacionit të Arkitektëve të Kosovës, të dhjetorit të vitit 1999, informimi i paditësit drejtuar MMPH-së i datës 02.05.2013, sqarimi dhe propozimi i Violeta Nushi, për paditësit i datës 23.06.2013, vendimi i paditëses për caktimin e personit të autorizuar të paditëses të datës 15.05.2013, ftesa për Kuvendin e Jashtëzakonshëm të paditëses e datës 13.01.2013, peticioni i drejtuar MMPH-së nga Ari Loxha i datës 03.07.2013, procesverbali i Kuvendit të Jashtëzakonshëm i paditëses së bashku me shtojcën e procesverbalit të datës 04.07.2013, parashtresa e paditëses e datës 26.06.2013, drejtuar ministrit të MMPH-së, përgjigja në padi e paditëses e datës 28.10.2013, referenca e Agjencisë Kundër Korrupsion drejtuar kësaj Gjykate e datës 16.12.2013, letër konfirmimi i lëshuar nga MAP-it si dhe shkresa e paditëses e datës 07.07.2015, kërkesa për rishikim e palës se interesuar, se bashku me provat e bashkangjitura të njëjtës të datës 06.09.2018, përgjigja e MAP-it drejtuar gjykatës e datës 05.10.2018, se bashku me provat e bashkangjitura të njëjtës, përgjigja e paditësit, drejtuar gjykatës e datës

23.10.2018, komunikimi elektronik mes Milan Toniq dhe Ilir Murselit e datës 10.02.2017, referenca e MAP-it e datës 20.01.2016, komunikimi elektronik në mes, Petrit Lecit dhe Adnan Konushfci etj., i datës 27.01.2017, vendimi i MAP-it i datës 14.05.2014, i datës 05.05.2016 dhe i datës 25.04.2017.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Me vendimin e të paditurës, të goditur me padi, me nr.____ të dt.____, është anuluar shkresa Ref. _____ të dt._____ e Departamentit të Regjistrimit dhe Ndërlidhjes së OJQ-ve lidhur me _____. Ndërsa pikën 2 të dispozitivit është obliguar kryetari i organizatës joqeveritare _____, që brenda 30 ditësh të ftoj kryesinë për zgjedhjen e kryetarit të ri në pajtim me statutin e _____.

Paditësi i pakënaqur me të njëjtin vendim, ushtron padi në këtë Gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e tij.

Nga vendimi i kontestuar del se ai përmban të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund shqyrtohet ligjshmëria e tij. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 84 par. 2 të këtij ligji është paraparë se “akti administrativ, që në këtë rast nënkupton vendimin e goditur me padi, duhet të përmbajë përveç tjerash edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike, bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ ose në faktet e siguruar nga administrata, një deklaram të bazës ligjore në të cilat bazohet akti etj. Akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar”. Në nenin 85 të po të njëjtit ligj, parashikohet se “përveç rasteve ku ligji vet e parashikon dhënien e arsyeve, duhet të jepen domosdoshmërisht arsyet për të gjitha ato akte, të cilat pjesërisht ose tërësisht mohojnë, shuajnë, kufizojnë apo prekin në një mënyrë apo tjetër të drejtat dhe interesat ligjore ose vendosin detyrime apo ndëshkime, përbëjnë një vendim të kundërt me pretendimet e palëve të interesuara, ose janë në kundërshtim me një informacion apo propozim zyrtar etj. Arsyetimet duhet të formulohen çart dhe të përfshijnë shpjegimet e bazës ligjore dhe faktike të aktit”.

Vendimi i kundërshtuar është juridikisht i pa qartë dhe kundërtshënës me vetveten dhe me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e tij nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimit të kundërshtuar. Në arsyetimin e vendimit është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se “Me vendimin Ref.DRNOJQ-MAP-09/186/2013 të dt.14.05.2013 të Departamentit të Regjistrimit dhe Ndërlidhjes së OJQ-ve është aprovuar kërkesa për ndryshimin e të dhënave të AKK-së, për emërim të z. Valdet Osmani si përfaqësues i Autorizuar i Organizatës. Me shkresë nr.3646 të datës 12.07.2013 z. Ilir Murseli paraqet njoftim rreth problematikës së

funkcionimit dhe qeverisjes së AAK-së, me kërkesë për veprime të autorizuara sipas ligjit në Departamentin e Regjistrimit dhe Ndërlidhjes së OJQ-ve. Me përgjigje në kërkesë Ref.09/18.07/2013 të datës 18.07.2013, nga Departamenti i Regjistrimit dhe Ndërlidhjes së OJQ-ve e pezullon përkohësisht vendimin Ref. DRNOJQ-MAP-09/186/2013 të datës 14.05.2013 dhe lëndën e kthen në rishqyrtim në Kuvendin e AAK-së për vlerësim dhe rivendose për përfaqësues të autorizuar të AAK-së”.

Me vendimin e lëshuar nga e paditura me nr.____ të dt.____, gjykata verën se e paditura me pikën një të këtij vendimi e ka anuluar shkresën Ref.____ të dt.____ të Departamentit të Regjistrimit dhe Ndërlidhjes së OJQ-ve lidhur me _____. Ndërsa pikën 2 të dispozitivit është obliguar kryetari i organizatës joqeveritare _____, që brenda 30 ditësh të ftoj kryesinë për zgjedhjen e kryetarit të ri në pajtim me statutin e _____, nga kjo gjykata verën se këtu e paditura i ka tejkualuar autorizimet ligjore dhe atë duke u bazuar në nenin 22 të Ligjit 04/L-57, Për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare, ku përcaktohet se “Institucionet e Republikës së Kosovës përkrahin, por nuk ndërhyjnë në veprimtaritë e OJQ-ve, dhe bëjnë publike të gjitha format e bashkëpunimit dhe përkrahjes. Dhënia e çfarëdo fondi publik për OJQ nga institucionet e Republikës së Kosovës bëhet në bazë të kriterëve të paracaktuara dhe publike.”

Në këtë kuptim gjykata vlerëson se e paditura në asnjë pikë të arsyetimit të vendimit kontestues nuk e ka përmendur faktin se mbi çfarë baze ka vendosur kur e ka detyruar kryetarin e organizatës joqeveritare të _____ që brenda 30 ditësh të ftoj kryesinë për zgjedhjen e kryetarit të ri në pajtim me statutin e _____.

Nga kjo gjykata vlerëson, se si rezultat i vërtetimit jo të drejtë dhe jo të plotë të gjendjes faktike, e paditura gabimisht e ka zbatuar, Ligjin për Procedurën Administrative dhe ligjin material, kur ka vendosur si në dispozitiv të vendimit kontestues.

Gjykata si rregull, konfliktin administrativ e vendos në bazë të gjendjes faktike, të vërtetuar nga ana e organeve administrative, ndërsa nga vendimi i goditur në padi, nuk mund të kuptohet se si është vërtetuar gjendja faktike.

Të metat e cekura më lartë janë të atilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kundërshtuar dhe në këtë drejtim gjykata e obligon organin e paditur që në afat prej tridhjetë 30 ditësh, në riprocedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të merr vendim të drejtë të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e palës së interesuar të dhëna në kërkesën për rishikim të dt. _____, por të njëjtat i vlerëson si të pa bazuar për faktin se pala e interesuar me asnjë prove të vetme nuk i ka provuar të njëjtat pretendime.

Po ashtu gjykata refuzon propozimet e të autorizuarës së paditësit me të cilat ka kërkuar që “që ta konsideron të tërhequr kërkesën palës së interesuar pasi që pala e interesuar nuk ka marrë pjesë në seancë dhe nëse gjykata nuk e vlerëson propozimin për konsiderim të tërheqjes së kërkesës për rishikim, në bazë të provave të cilat janë parashtruar me përgjigje në rishikim, e të cilat provojnë datën kur pala e interesuar ka qenë e informuar me aktgjykimin e plotfuqishëm të kësaj gjykate, kërkesa e paraqitur për rishikim me shumë se një vit pas njoftimit në kuptim të nenit 57.1 në lidhje me nenin 60.2 të LKA-së nuk është lejuar”. Të njëjta kërkesë gjykata i refuzon si të pa bazuar, për faktin se ë njëjta kërkesë është në kundërshtim me nenin 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili përcakton se “41.1 Mungesa e palës në shqyrtimin verbal nuk e pezullon punën e gjykatës. 2. Për shkak të mungesës së palëve nuk mund të konstatohet se ato kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre, por do të lexohen parashtratat e tyre”. Në këtë kuptim kjo kërkesë është e pa bazuar. Ndërsa lidhur me propozimin që kërkesa për rishikim të hidhet poshtë si e pasafatshme e të njëjtën kërkesë gjykata e refuzon si të pa bazuar, për faktin se edhe pse me referencë e MAP-it të dt. _____, me të cilën paditësi pretendon se është njoftuar pala e interesuar, gjykata vëren e njëjta referencë nga MAP-i, i është drejtuar të autorizuarit të palës së interesuar _____, etj, me të cilën është njoftuar me aktgjykim e kësaj gjykate të dt. _____, por paditësi, e as e paditura nuk i kanë ofruar ndonjë provë gjykatës, se palës së interesuar i është dorëzuar e njëjta referencë, dhe në këtë kuptim i njëjti propozim sipas vlerësimit të gjykatës është i pa bazuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna me lartë, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 dhe nenin 61 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
A.nr.1244/13, dt.27.02.2019

Procesmbajtës
SS

G j y q t a r i
NN

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtut, në Gjykatë e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Shpenzimet e procedurës:

Në konfliktin administrativ secila palë i bartë shpenzimet e veta, meqë në konfliktin administrativ konsiderohet se shpenzimet janë të vogla në krahasim me procedurat tjera. Shpenzimet e procedurës në konfliktin administrativ janë të përcaktuara si: Taksa për padi, taksa për vendim të gjykatës, për ankesë, për mjetet tjera juridike, kompensimi i shpenzimeve të dëshmitarit, ekspertit si dhe kompensimi i shpenzimeve nëse eventualisht ka marrë pjesë avokati.

Kjo çështje është e rregulluar me dispozitën e nenit 64 të LKA-së, ku përcaktohet se: në konfliktin administrativ secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

MJETET JURIDIKE NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV

Në bazë të ligjit për konfliktet administrative janë përcaktuar mjetet e rregullta juridike – ankesa dhe mjetet e jashtëzakonshme, kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe kërkesa për rishikim.

ANKESA NË PROCEDURËN E KONFLIKTIT ADMINISTRATIV

Në procedurën e konflikteve administrative, kundër vendimit të gjykatës mund të ushtrohet mjeti i rregullt juridik siç është ankesa, vetëm atëherë kur shprehimisht e ka përcaktuar Ligjit për Konfliktet Administrative. Kur ankesa lejohet ajo mund të paraqitet në afat prej 15 ditësh, që nga dita e pranimit të vendimit të gjykatës. Të drejtën e paraqitjes së ankesës kundër aktgjykimit në konflikt administrativ kanë: Pala e paditur, pala paditëse si dhe personi i interesuar.

I padituri organi i cili ka nxjerrë vendimin administrativ mund të ushtrojë ankesë kur vendimi i tij është anuluar në konfliktin administrativ. Ankesë mund të paraqes edhe pala paditëse, i cili është i pakënaqur me vendimin gjyqësor të gjykatës për refuzimin e padisë, në rastet kur gjykata refuzon padinë. Ankesë mund të paraqet edhe personi i interesuar, po që se është i pakënaqur me vendimin gjyqësor të nxjerrë në konfliktin administrativ.

FORMA DHE PËRMBAJTJA E ANKESËS

Ankesa duhet të përmbajë elementet themelore të saj. Në ankesë duhet të theksohet vendimi gjyqësor që goditet me ankesë dhe shkaqet e goditjes të vendimit gjyqësor. Gjykata pasi që pranon ankesën duhet ta shqyrtoj anën formale të saj, nëse konstaton se ankesa është e palejueshme, e paraqitur pas afatit ose e paraqitur nga personi i pa autorizuar, me vendim e hedh poshtë ankesën. Nga kjo rezulton se gjykata fillimisht duhet të shqyrtojë këto elemente të ankesës. Nëse konstaton se nuk ka mangësi lidhur me këto elemente atëherë gjykata duhet që ta shqyrtoj ankesë, dhe atë duke u bazuar në dispozitat e nenit 63 të Ligjit për Konfliktin Administrativ ku thuhet se nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative, përshtatshëm duhet të zbatohet Ligji i Procedurës Kontestimore. Në rastin konkret duhet të zbatohen dispozitat e nenit 194 gjer në nenin 210 të LPK-së. Gjykata e shkallës së dytë me rastin e shqyrtimit të ankesës mund ta hedh poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme, ta prish aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë, ta prish aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, ta refuzoj ankesën si të pathemeltë dhe të vërtetoj aktgjykimin e goditur, ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.

Në qoftë se gjykata e aprovon ankesën si të bazuar dhe e prish vendimin e gjykatës së shkallës së parë, në këtë rast lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e

shkallës së parë, vërejtjet dhe sugjerimet e gjykatës së shkallës së dytë janë obligative për gjykatën e shkallës së parë kur të vendos në rigjykim dhe rivendosje, që do të thotë se gjykata e shkallës së parë duhet të zhvillojë të gjitha veprimet procedurale dhe ta shqyrtojë çështjen sipas asaj si e ka përcaktuar gjykata e instancës së shkallës së dytë duke vendosur lidhur me ankesën.

Shembulli 1.

Ankesa

Me nenin 49 të LKA-së është përcaktuar se: Kundër vendimit të Gjykatës së shkallës së parë ankesa i parashtrohet gjykatës kompetente, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të vendimit të gjykatës.

A.nr. _____

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
Departamenti për Çështje Administrative**

PËR

GJYKATËN E APELIT TË KOSOVËS

Paditësi: Sh. Sh. nga Prishtina, rruga “Nënë Tereza” pn.

E paditura: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Pensioneve, ne Prishtinë

ANKESË

Kundër aktgjykimit A.nr. _____, **të datës** _____, **të** Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, në afatin e caktuar ligjor paraqesë ankesë.

Për shkak të:

- Shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore;
- Konstatimit të gabuar apo jot ë plotë të gjendjes faktike dhe
- Zbatimit të gabuar të së drejtës material.

Me propozim që:

Ankesa e paditësit, të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi ankimor të ndryshohet ose që aktgjykimi ankimuar të priset dhe çështja t'i kthehet në rigjykim gjykatës së shkallës së parë.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin A.nr. _____, të datës _____, ka refuzuar në tërësi

kërkesëpadinë e paditësit me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të MPMS-së me numër _____, të datës _____.

Aktgjykimi A.nr. _____, është i pa bazuar dhe i pa drejtë, sepse bazohet në shkelje të dispozitave thelbësore të procedurës kontestimore nga neni 182.1 dhe 182.2 pikat n) të LPK-së, në konstatim të gabuar dhe jot ë plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së dhe është bërë zbatim i gabuar i të drejtës material nga neni 184 i LPK-së, të cilat aktgjykimin ankimor e bëjnë të pa shqyrtueshëm, të pa drejtë dhe të pa bazuar për arsyet vijuese:

Shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1

Aktgjykimi ankimuar është nxjerr duke bërë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, përkatësisht gjatë procedurës nuk janë zbatuar në mënyrë të drejtë dispozitat e LPK-së, kurse mos zbatimi i këtyre dispozitave rezulton me shkelje thelbësore të nenit 182 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ankimuar e ka nxjerr duke bërë shkelje thelbësore të dispozitave kontestimore, përkatësisht shkelje të nenit 182.2 pika n) të LPK-së, kur në arsyetimin e aktgjykimin nuk ka përfshirë ndonjë sqarim lidhur me pretendimet e paraqitura në padi e as lidhur me provat e paraqitura edhe pse të tillat i kishte administruar si prova në seancën e datës _____.

Në rastin konkret ky aktgjykim është përpiluar mbi këto shkelje pasi që është nxjerrë pa dhënë asnjë arsyetim lidhur me pretendimet e paditësit e as ndonjë sqarim rreth fakteve vendimtare për të cilat ka pasur obligim që të jep një arsyetim.

Një obligim të tillë për gjykatën e shkallës së parë është përcaktuar në neni 182 pika n) të LPK-së.

Elementet e përcaktuara në nenin 182.2 të LPK-së pika n) të cilat në aktgjykimin ankimor nga ana e gjykatës janë shkelur janë se aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit nuk ka dhënë ndonjë arsyetim sa i përket pretendimeve të palës paditëse të parashtruar me padi, kjo pasi që padia ishte inicuar vetëm për të vërtetuar se paditësi ka të kryer shkollën e lartë dhe do të duhej të merrte pension të kategorisë së III e jot ë kategorisë së II, sic është duke u paguar tani.

Gjykata e shkallës së parë refuzimin e padisë e ka bazuar në një fakt inekzistent, përkatësisht duke ia refuzuar kërkesëpadinë mbi bazën se paditësi nuk e ka përmbushur kriterin e 15 (pesëmbëdhjetë) vite stazh kontributiv.

Po ashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë ndonjë arsyetim as lidhur me provat e administruara në seancën e datës _____, përkatësisht provave të propozuara nga paditësi të cilat konsiderojmë që janë të mjaftueshme për vërtetimin e faktit se paditësi ka të kryer shkollën e lartë dhe mbi këtë bazë të njëjtit i takon pension i kategorisë së III sipas nenit 4 paragrafi 1 pika 1.3 të UA 09/2015.

Paditësi për të dëshmuar këtë fakt, gjykatës si dëshmi i ka ofruar Diplomën e shkollimit dhe librezën e punë, të cilët prova e dëshmojnë faktin se i njëjti ka përgatitje shkollore të lartë dhe ka punuar si mësimdhënës në bazë të përgatitjes së tij shkollore, mirëpo gjykata e shkallës së parë edhe për kundër administrimit të këtyre provave nuk ka dhënë ndonjë arsye në pjesën e arsyetimit të aktgjykimit ankimor se për çfarë arsye këto dy prova nuk ua ka falur besimin duke bërë kështu shkelje ligjore.

Konstatimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike nga neni 183 paragrafi 1 i LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës kontestimore të përshkruara si më lartë, përkatësisht mos faljes së besimit të provave të administruara nga ana e gjykatës (për këto prova nuk ka dhënë as ndonjë arsyetim se pse nuk i'a ka falur besimin), ka bërë konstatim të gabuar dhe jotë plotë të gjendjes faktike.

Për sa i përket gjendjes faktike, në rastin konkret gjykata do të duhej të vërtetonte vetëm faktin se a ka përgatitje të lartë shkollore paditësi apo jo, ngase ky ishte fakti i vetëm që do të duhej të vërtetohej nga gjykata, meqë paditësi pretendon se do të duhej të merrte pension të kategorisë së III-tretë, ndërsa e paditura i'a ka refuzuar kërkesën në shkallë të parë me pretendimin se të njëjtit i takon pension të kategorisë së II-të, specifikuar si në Udhëzimin Administrativ me numër 09/2015.

Pra, gjykata e shkallës së parë ka injoruar në tërësi kërkesën e paditësit duke vërtetuar kështu gjendje faktike krejt tjetër nga ajo e cila është reale, pasi që paditësi e ka dëshmuar pretendimin e tij me anë të Diplomës së shkollimit dhe Librezën e punës, kurse gjykata gabimisht ka vërtetuar një gjendje tjetër duke ia refuzuar kërkesëpadinë e paditësit mbi bazën se paditësi nuk e ka përmbushur kriterin e 15 vite stazh kontributiv.

Me aktgjykimin ankimor është bërë shkelje e nenit 183 të LPK-së duke vërtetuar gabimisht gjendjen faktike për sa i përket shkollimit të paditësit dhe ku gabim ka bërë që vendimi gjyqësor të jetë refuzues për palën paditëse, pasi që ka vepruar në kundërshtim me vet përmbajtjen e dokumenteve të cilat i ka administruar si prova.

Aplikimi i gabuar i të drejtës material.

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar ka anashkaluar në tërësi dispozitat e drejtës material dhe parimet e drejtësisë që lidhen me çështje për të cilën

është inicuar padia dhe i njëjti edhe pse përmban referenca ligjore, këtë referenca janë në kundërshtim me vet gjendjen faktike e cila është vërtetuar nga gjykata gjatë procedurës.

Gjykata e shkallës së parë ka anashkaluar në tërësi nenin 4 par. 1 pika 1.3, lidhur me nenin 5 par.3 të Udhëzimit Administrativ 09/2015 në të cilin nen në mënyrë decisive përcaktohet se; *“Shfrytëzues i pensionit kontribut pagues me përgatitje shkollore të lartë, konsiderohet pensionisti, përkatësisht i siguruari i cili ka kryer shkollimin e lartë”*.

Edhe përkundër faktit se si provë e ka administruar Diplomën me numër _____ të datës _____, e vërtetuar të noteri me datë _____, kurse refuzimin e kërkesëpadisë e ka bazuar në nenin 6 paragrafi 2 nënparagrafi 2.3 të Udhëzimit Administrativ 09/2015, në të cilin përcaktohet se: *“Të ketë stazh pensional kontribut dhënës së paku 15 vjet para datës 01.01.1999, sipas ligjit të SPI-së të Kosovës, nr.26/83”*.

Në rastin konkretë kjo dispozitë nuk është dashur të aplikohet, për arsye se paditësi nuk ka parashtruar një kërkesë të tillë për këtë gjykatë dhe nuk ka kërkuar vërtetimin e këtij fakti ngase i njëjti as njëherë më parë nuk iu është kontestuar stazhi i punës prej 15 vite, për më tepër i njëjti është përfitues i pensionit kontributiv nga data _____.

Fakti se paditësi është përfitues i pensionit kontribut pagues dëshmohet me anë të vërtetimit të lëshuar nga QR APK-Prishtinë me datë _____.

Dokumenti i mësipërm kësaj ankese i bashkëngjitet si provë e re për faktin se në gjykatës e shkallës së parë nuk ka qenë kontestues ky fakt,, dhe as që kishte kërkuar paditësi vërtetimin eventual të tij por duke qenë se gjykata e ka refuzuar padinë e paditësit vetëm mbi këtë bazë jemi detyruar t’ia bashkëngjisim si provë.

Andaj nga të gjitha arsyet e paraqitura më lartë, i propozojmë Gjykatës së Apelit, që ankesën e paditësit ta aprovoj sit ë bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta prish dhe çështja ti kthehet të njëjtës në rigjykim dhe rivendosje.

Prishtinë, datë _____

PADITËSI, Sh. Sh.

Neni 63 i LKA-së, drejtë për drejtë na udhëzon që të zbatohen dispozitat e nenit 176 të LPK-së, sa i përket procedurës së shqyrtimit të ankesës dhe marrjes së vendimit nga ana e shkallës së dytë.

Me nenin 195 të LPK-së, janë përcaktuar se cilat vendime mund të merr gjykata e shkallës së dytë lidhur me ankesën:

Gjykata e ankimit mundet, gjykata e shkallës së dytë, në rastin konkret Gjykata e apelit, në seancën e kolegjit apo në bazë të seancës së shqyrtimit të çështjes të bërë drejtë për drejtë para sajë:

- ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme*
- ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta heshë posht padinë*
- ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthejë çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë,*
- ta refuzojë ankesën si të pa themelt dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur,*
- ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë.*

Format e aktgjykimeve

Shembulli 1 - aprovues

Shembulli 1.

Vendimet lidhur me ankesën



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr. ____/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Z.K kryetar, N. G. dhe N. N., anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, F. A., nga Prishtina, të cilën me autorizim e përfaqëson _____, avokat në Prishtinë, kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti i Administratës Pensionale (MPMS-DAP), në Prishtinë, me bazë juridike anulimi i Vendimit të organit të paditur, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses të ushtruar, kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr._____/2018, të datës _____, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë _____, merr;

A K T V E N D I M

Aprovohet ankesa e paditëses, F. A., nga Prishtina, e datës _____, ndërsa **Prishtë** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr._____/2018, i datës _____, dhe çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar A.nr._____/18, të dt._____, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses F. A., nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi i të paditurës, i datës _____.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor, ankesë ka ushtruar e autorizuar e paditëses, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit, për shkak të; shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr._____/2018 të datës _____, ta prishë dhe çështjen t'ia kthej Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim ose ta ndryshoj dhe kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë si të bazuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit në seancën e mbajtur, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet dhe arsyet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në kuptim të nenit 49, të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe neni 194, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA), gjen se:

Ankesa është e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur MPMS-DAPK, nr. _____, i dt. _____, e ka refuzuar ankesën e paditëses me nr. _____, të dt. _____, për njohjen e të drejtës në pension të personave me aftësi të kufizuar si e pa bazuar dhe ka vërtetuar vendimin e Komisionit Mjekësor të shkallës së parë plotësisht i bazuar në ligjin nr.2003/23.

Paditësja, e pa kënaqur me vendimin e lartë cekur, ushtron padi për konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, kundër të paditurës MPMS-DAPK-së, me të cilën e konteston ligjshmërinë e vendimit të saj dhe kërkon që vendimet e organit të njëjtë të anulohen si jo ligjor, ndërsa paditëses ti njihet e drejta në pension të personave me aftësi të kufizuar.

Gjykata e shkallës së parë në këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesorë më dt. _____, dhe pas administrimit dhe vlerësimit të provave, merr aktgjykimin e ankimur, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se: gjykata i vlerësoj të pa bazuara pretendimet e paditëses, sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe nga ana e organit të paditur dhe nga ana e organit të shkallës së parë. Paditësja, me asnjë provë nuk dëshmon pretendimet e saj, ndërsa faktet e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Pretendimet e paditëses se është e sëmurë rëndë dhe ka nevojë për ndihmë duke ofruar raporte nga konsulta mjekësore për gjendjen e saj shëndetësore. Kjo gjykatë pas administrimit të provave të përmendura më sipër- raporteve mjekësore të paditësit, e në veçanti ekspertizës së siguruar nga SHSKUK për paditësin të dt. _____, në përbërje prej tre (3) profesionistëve të fushave përkatëse të caktuar për këtë çështje, është hartuar ekspertiza nga: Dr. _____, Dr. _____ – Pneumoftiziloge dhe Dr. _____ –Psikiatër të cilët në seancën e shqyrtimit kryesor kanë theksuar mendimin e dhënë si ekspertizën e hartuar, në të cilën pasi e kanë ekzaminuar pacienten në këtë rast paditësja F. A. kanë nxjerr këtë konkluzion/përfundim se e njëjta vuan nga: Dg. TB Lymphadenoptbia tbc dhe Broncbitis, dn, Fibrisis sec pulm bill COPDgr III-IV, ndërsa sa i përket ekzaminimit mendor e njëjta është e vetëdijshme e orientuar tridimensionalisht, pamja e jashtme është në gjendje të rregullt, flet me ton të ulët, që do të thotë rrjedh normale, prag i ulur frustrativ, psikolabiliteti, emocione të qëndrueshme në të menduar dominojnë preokupime të vazhdueshme rreth gjendjes shëndetësore organike. Nga kjo gjykata vlerëson se vendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Kolegji i Gjykatës së Apelit duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes duke ekzaminuar aktgjykimin e ankimuar, shkresat e lëndës dhe duke marrë parasysh që kjo çështje është kthyer në rigjykim edhe më parë, edhe sipas pretendimeve ankimore të paditëses gjen se aktgjykimi i ankimuar përsëri është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) dhe neni 183 i LPK-së, se është juridikisht i pa qartë kundërthënës me vet vetën dhe arsyetimin e tij, po ashtu jo i plotë lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike, aktgjykimi i ankimuar, është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, sipas nenit të theksuar më lartë, nga shkaku se arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar është i pa qartë, i parregullt sa i përket përmbajtjes së tij, të pretendimeve të palëve si dhe aktvendimi mbi administrimin e provave nga procesverbali, i konstatimeve në ekspertizën mjekësore të datës _____, dhe i njëjti nuk jep arsye të qarta dhe të kuptueshme për palët e as për gjykatën, se për cilat arsye është refuzuar kërkesëpadija e paditëses si e pabazuar, e cila gjendje është në kundërshtim të plotë me nenin 182 par. 2 pika n) i LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e pranimit të ekspertizës mjekësore të ekspertëve mjekësorë të QKUK-së, të datës _____, ka pranuar raportin mjekësorë me konstatimin se pacientja F. A. vuan nga këto sëmundje (të cekura taksativisht në raport) dhe një mendim të shkurtër mbi gjendjen psikike të paditëses, mirëpo në të njëjtin raport nuk jepet një konstatim mjekësor lidhur me paaftësinë fizike ose jo të paditëses, e cila është thelbësore për gjykatën dhe arsye për të cilën edhe është caktuar marrja e kësaj prove nga ana e gjykatës. Ekspertët mjekësorë të cilët kanë dhënë mendimin sipas ekspertizës të lëmvive përkatëse me atë të cilën edhe korrespondojnë shqetësimet e paditëses për gjendjen shëndetësore vetëm e përshkruajnë diagnozën e paditëses dhe shqetësimet lidhur nga këto sëmundje, pa dhënë një mendim profesional lidhur me aftësinë apo pa aftësinë e paditëses, gjë që e bënë të qartë se ekspertiza mjekësore në të cilën gjykata e ka bazuar aktgjykimin e ankimuar është jo e plotë (e mangët), aktgjykimin e ankimuar e bënë të pa qartë akoma edhe fakti që edhe në seancën gjyqësore të caktuar në rigjykim të çështjes, prapë se prapë nuk eliminohet mangësitë në ekspertizën e mjekëve specialist të cilët janë ftuar në seancë pikërisht për këtë çështje, e që gjykata e shkallës së parë përsëri në gjykimin e kësaj çështje nuk i ka marrë parasysh vërejtjet dhe shkeljet e konstatuara nga Gjykata e Apelit e që për marrjen e një vendimi të drejtë ka qenë kusht ligjorë eliminimi i tyre, ku edhe ka ardhur deri te konstatimi i drejtë apo jo i gjendjes shëndetësore të paditëses, dhe pavarësisht nga këto të meta të sajë, gjykata e shkallës së parë, e bazon aktgjykimin e sajë në po këtë ekspertizë, dhe e refuzon kërkesëpadinë e paditëses, me arsyetimin e dhënë si në aktgjykimin e ankimuar.

Kolegji, vlerësoi gjithashtu se, aktgjykimi i ankimuar është juridikisht i paqartë lidhur me përmbledhjen e fakteve vendimtare sipas gjendjes faktike të çështjes sepse janë shqyrtuar në tërësi pretendimet e palëve në procedurë dhe faktet lidhur me mënyrën e vendosjes si dhe pretendimeve të paditëses, meqë nga shkresat e lëndës dhe nga të cekura si më lartë vërehet se aktgjykimi i ankimuar është i bazuar në provat të cilat nuk

mund të merren si të vlefshme, në mënyrë që gjykata bazuar në këto prova, të mund të vendos lidhur me kërkesëpadinë e paditëses, për njohjen e të drejtës në pensionin e personave me aftësi të kufizuar. Nga kjo gjendje e vërtetuar rezulton se vlerësimet e ekspertëve mjekësorë të paditurës MPMS-DAP, janë në kundërshtim me ekspertizën e kryer nga QKUK, dhe vetë ekspertiza e QKUK-së e datës _____, është e mangët ngase është dashur të vlerësohet gjendja shëndetësore e paditëses dhe të jepet mendimi profesional lidhur me pa aftësinë fizike të paditëses, nga edhe rezultojnë sëmundjet e paditëses dhe paaftësia e cilësuar sipas dokumentacionit mjekësor, ngase në këtë çështje vlerësimet mjekësore të këtyre dy organeve janë në tërësi të kundërta dhe jo të plota. Në këtë çështje gjykata e shkallës së parë, me mënyrën e vendosjes ka vepruar në kundërshtim me nenin 182 par. 1 lidhur me nenin 366 par. 1 dhe 2 të LPK-së, sepse ekspertiza mjekësore e datës _____, e QKUK-së, është jo e plotë e mangët, lidhur me konstatimin e gjendjes shëndetësore të paditëses, andaj është dashur që në këtë çështje të veprohet si në vështrim të nenit 366 par. 1 dhe 2 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë edhe përkundër vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna nga ana e Gjykatës së Apelit me Aktvendimin AA.nr. _____/2018 të datës _____, me të cilin aktvendim gjykata e shkallës së parë është udhëzuar që të bëjë sqarimin dhe plotësimin e ekspertizës mjekësore të caktuar nga ana e eksperteve mjekësorë të QKUK-së. Gjykata e shkallës së parë edhe për kundër vërejtjes së Gjykatës së Apelit, e cila në mënyrë decisive i ka treguar se cilat parregullsi ti eliminoj. E njëjta i ka ftuar në seancën e shqyrtimit ekspertët: Dr. _____ - Psikiatër, Dr. _____ dhe Dr. _____ Pulomolog, në mënyrë të sqarimit dhe plotësimit të ekspertizës, por të njëjtit kanë dështuar ta bëjnë një gjë të tillë pasi që në seancë vetëm kanë përsëritur përshkrimet e bëra në ekspertizë, duke mos e sqaruar qartë dhe saktë gjendjen e paditëses. Dr. _____, në deklarin e saj në seancë ka theksuar se: “në bazë të gjendjes së paditëses dhe dokumenteve mjekësore që na ka ofruar neve pacientja në fjalë F. A., shumë vite më parë është mjekuar nga tuberkulozi i mushkërive dhe tuberkulozi i gjëndrave limfatike dhe kemi konstatuar se në bazë të rëntgenit të mushkërive dhe dokumentacionit mjekësor mendojmë se bëhet fjalë për Fibrziss pul; bill, COPD gr. III - V. Ne kemi preferuar që dokumentacioni ka qenë i datës _____, që të bëhet CT e toraksit për evalumi të mëtejme, sipometria eventualisht në bazë të përshkrimit të CT të toraksit të bëhet edhe Brohoskopia”. Ndërsa Dr. _____, ka deklaruar se qëndron pranë thënieve të kolegut pasi që së bashku e kemi ekzaminuar pacienten. Dr. _____ Psikiatër, deklaroi se: “në aspektin psikiatrik nuk është adaptuar psikopatologji, përveç se është manifestuar gjatë intervistimit një psikolabilitet emocional prag i ulët i tolerancës çka fletë për gjendje psikoreaktive. Sa i përket këtyre sqarimeve Kolegji i Apelit, vlerëson se Gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur ta sqarojë saktë dhe drejtë gjendjen faktike pasi që e njëjta nuk ka kërkuar nga ekspertët sqarime shtesë që kanë të bëjnë me ndriçimin e gjendjes faktike sa i përket ekzaminimit të paditëses, e njëjta vetëm ka dëgjuar një deklarin të shkurtër të tyre duke mos kërkuar sqarime të mëtejshme. Gjykata e shkallës së parë është dashur të kërkojë sqarime shtesë nga Dr. _____, se çka nënkuptojmë me përcaktimin e kësaj diagnoze “Fibrziss pul;

bill, COPD gr. III - V.”, për cilat arsye është kërkuar që të bëhet CT e toraksit për evalumi të mëtejme, sipometria eventualisht në bazë të përshkrimit të CT të toraksit të bëhet edhe Brohoskopia”, çfarë gjendje faktike do të fitohet në rast të veprimit sipas pretendimit të lartcekur, dhe a do të mund të ndryshonte konstatimi për një diagnozë më të saktë ndaj paditëses. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë ka dështuar ti kërkoj sqarime shtesë edhe Dr. _____, Psikiatër, pasi që e njëjta deklarimin e saj e ka përmbyllë me një fjali të vetme duke mos sqaruar në mënyrë më të detajuar raporti psikiatrik për paditësen, e njëjta është dashur që në mënyrë më të detajuar dhe më të thjeshtëzuar të sqaroj se psikolabilitet emocional, prag i ulët i tolerancës dhe gjendja psikoreaktive, çfarë ndikimi kanë te paditësja a e përcjellin të njëjtën në vazhdimësi apo kohë pas kohe, cili është efekti i kësaj diagnoze. Kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se, është obligim ligjorë i gjyqtarit të çështjes që në mënyrë të saktë dhe të drejtë të vërtetoj gjendjen faktike, të kërkoj sqarime shtesë nga palët dhe ekspertit, nëse është e nevojshme të nxirret ekspertizë e re, por assesit nuk guxon të nxjerr vendim duke mos e vërtetuar drejtë gjendjen faktike, sepse në rast të mos vërtetimit të gjendjes faktike, kemi edhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Pra gjykata e shkallës së parë, në ri-procedurë, me rastin e rivendosjes dhe rigjykitimit në rastin konkret, së pari duhet që konform dispozitës ligjore të cekur më lartë, të bëjë plotësimin e ekspertizës mjekësore të caktuar nga ana e gjykatës, të ekspertëve mjekësorë të QKUK-së, të datës _____, e cila do të punohet nga ekspertët e lëmive përkatëse të cilët pas ekzaminimit të drejtë për drejtë të paditëses dhe përfundimit edhe të inqizimeve apo analizave tjera të cilat sipas ekspertizës aktuale kanë munguar, në mënyrë të drejtë dhe të plotë do të vlerësonin dhe do të konstatojnë me shkrim paaftësinë e paditëses, të japin mendimin profesional lidhur me gjendjen shëndetësore të paditëses, dhe pas kësaj në seancë gjyqësore në praninë e palëve, pas eliminimit edhe të shkeljeve procedurale të theksuara më lartë, të merr aktgjykim të arsyetuar drejtë dhe qartë, ligjor ashtu si parashihet në dispozitat e LKA-së, dhe LPK-së, si ligj i zbatueshëm.

Meqë me aktgjykimin e ankimuar, nuk është vërtetuar përsëri drejtë gjendja faktike, i njëjti është i përfshirë edhe me shkelje thelbësore të dispozitave procedurale, kolegji vendosi që aktgjykimin e ankimuar të prishet, si i pa drejtë dhe jo ligjor, dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në shkallën e parë.

Nga të lartë cekurat e në kuptim të nenit 43.2 dhe 49 të LKA-së, dhe nenit 195 par. 1 pika c) i zbatueshëm përmes nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr. _____/2019, me datë _____

**Kryetar i kolegjit,
Z.K.**



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr. _____/2018

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: F.F kryetar, N.N. dhe A. A., anëtar, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, NPISHT _____, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim tatimor, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr. _____/2015, të datës _____, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë _____, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, NPISHT _____, e dt. _____, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, A.nr. _____/2015, i datës _____, **Vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së shkallës së parë, është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësit, NPISHT _____, me seli në Prishtinë. Ndërsa është anuluar pjesërisht vendimi nr. ____/2015, i datës _____, i Departamentit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, në Prishtinë. Obligohet paditësi NPISHT _____”, ti paguaj detyrimet tatimore mbi TVSH për periudhat tatimore 05/2009, 12/2009, 03/2010, 07/2011, 08/2011, 09/2011, 11/2011, 01/2012 dhe 02/2013, në vlerë të përgjithshme prej 116,198.60 Euro (njëqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë euro, e gjashtëdhjetë centë).

Kundër këtij aktgjykimi ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e paditësit si e bazuar dhe Ndryshohet aktgjykimi me shenjë A.nr. ____/15, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, në atë mënyrë të dispozitivit i të njëjtës lexon: Aprovohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit, Anullohet vendimi nr. ____/2015 i datës

_____, i të paditurës ATK si i kundërligjshëm dhe konstatohet se paditësi nuk ka obligime shtesë tatimore.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 të LKA-së, nenit 81.H,të Ligjit,nr.04/L-102, për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për ATK-në dhe procedurat, nr.03/L-222, dhe nenit 194, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (LPK), (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA), gjen se;

Ankesa është e **pa bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me Vendimin nr._____/2015, të dt._____, në pikën I të dispozitivit ka vendosur I. Aprovohet pjesërisht ankesa nr._____/2015, e datës _____, e subjektit tatimor NPISHT _____”, me numër të regjistrimit të biznesit (NRB) _____ si dhe numër fiskal (NRF) _____, me pronar _____, me seli të biznesit në Prishtinë, në mbështetje të nenit 136/c të Ligjit nr.02/L-222, për Administratën Tatimore dhe Procedurat. II. Ndryshohet vendimi mbi Njoftim rivlerësimet e tatimit shtesë për tatimin mbi vlerën e shtuar periudhën 09/2010 si dhe tatimin mbi të ardhurat personale për periudhat 2009 dhe 2010, ndërsa pjesa tjetër e vlerësimit mbetet e pa ndryshuar, sipas vlerësimit të kontrollit. Pjesa e mbetur pas ndryshimeve mbetet obligim pagese për tatimpaguesin. III. Procedura e ankesës nuk ndërpre në sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit nr.03/L-222.

Kundër Aktvendimit të Departamentit për ankesa të ATK, paditësi me padi inicon konflikt administrativ, në Gjykatën e shkallës së parë, e cila pas mbajtjes së seancës publike me dt._____, në prani të autorizuarit të paditësit e në mungesë të përfaqësueses ligjore të palës së paditur, dhe administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, në kuptim të nenit 81 G të ligjit nr.04/L-102, bien aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, dhe e anulon pjesërisht vendimin kontestues të organit të paditur duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të cekur si më lartë.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, ndër të tjera është theksuar se; nga provat materiale të paraqitura në procedurën e konfliktit administrativ, dhe vërejtjet që i ka dhënë paditësi ndaj draft raportit të kontrollit dhe raportit final të dt._____, gjykata konstaton se e paditura nuk ka provuar ti shqyrtoj të gjitha dokumentacionet që i paraqit paditësi në procedurën e kontrollit dhe pretendimet lidhur me qarkullimin shtesë që ka rezultuar nga kontrolli tatimor. E paditura edhe pse i ka pasur në disponim dokumentacionet e paraqitura nga paditësi si: kontrata _____, e lidhur me institutin _____, kontrata e asignacionit _____, me të cilën është lidhur kontrata për bashkëpunim mes paditësit, _____ me përfaqësi në Kosovë dhe

_____ me seli në _____, kontratat e huazimit, faturat tatimore dhe pagesat bankare, gjykata konstaton se e paditura i është shmangur veprimi për të verifikuar se vendi i furnizimit të shërbimeve sipas faturave dhe kontratave nuk është në Kosovë dhe nuk janë arsyetuar trajtimet nga huazimet si të padeklaruara. Nga provat e siguruara edhe përmes ekspertizës financiare të dt. _____, gjykata konstaton se pretendimet e paditësit janë pjesërisht të bazuara, pasi që diferencat e konstatuara nga kontrolli, dokumentacionit financiare të paraqitur nga paditësi dhe gjetjet e ekspertizës financiare dëshmojnë në mënyrë dokumentare dhe përmes bazës ligjore se në cilat periudha të kontrollit duhen bërë korrigjimet e vlerësimit të kontrollit, dhe konfirmimit të vlerësimit të kontrollit me rastin e rritjes së blerjeve të tatueshme, blerjeve nga importi pa të drejtë kreditimi për periudhat _____. Gjkata ia fali besimin mendimit profesional të ekspertit gjyqësor të datës _____, për arsye se mendimin e vet profesional e ka mbështetur në fakte dhe prova të mjaftueshme që kanë të bëjnë me dokumentacionin financiar të paraqitur nga paditësi. Nga provat materiale të administruar gjykata pranon vlerësimet e dhëna në ekspertizën financiare se konform nenit 20 par.2 të Ligjit 03/L-146 për TVSH, shërbimet sipas kontratës për caktimin e punëve të kontraktuara _____, duhet trajtuar si furnizime të përjashtuara pa të drejtë kreditimi pasi që vendi i furnizimit të blerësit _____, ka selinë në vendin ku edhe është lidhur kontrata _____, pra në _____. Rast të njëjtë ka aplikuar kontrolli kur ka trajtuar shitje të tatueshme shitjet sipas situacionit të përkohshëm nr. _____, që i dedikohet institutit IGH dhe i referohet kontratës së lartcekur e lidhur në vendin e furnizimit _____, fakt ky që legjislacioni tatimor e përjashton këtë transaksion si shitje e tatueshme.

Gjkata gjithashtu konstaton se nuk është dashur që paditësi të ngarkohet me qarkullimin shtesë mbi bazën e pozicioneve të hapura të palëve për muajin ____/____, pasi që sikurse shihet edhe nga faturat tatimore dhe pagesat bankare të lëshuara nga paditësi për përfaqësinë _____, paraqet detyrimet e paditësit ndaj furnizuesit _____, me seli në _____. Për këtë furnizim kontraktues paditësi ka paraqitur kontratën e asiguracionit nr. _____ dt. _____, të lidhur mes tij dhe furnizuesit _____, me seli në _____ përfaqësia në Kosovë. Gjkata në këtë rast ka konstatuar se e paditura nuk ka mundur të argumentoj me asnjë provë materiale se përmes faturave apo pagesave bankare mes paditësit dhe përfaqësisë _____, është kryer ndonjë furnizim reciprok mes këtyre dy subjekteve, ashtu që do të konstatohej se paditësi nuk ka deklaruar këto transaksione si të hyra, prandaj edhe gjykata konsideron se këto transaksione nuk kanë efekt për qëllime tatimore. Gjkata nga provat e administruara konsideron se paditësi, ka paraqitur para kontrollit tatimor kartelën e qarkullimit bankar dhe kontratat e huazimit për periudhat ____/____, ____/____, mirëpo kontrolli dhe e paditura nuk kanë arsyetuar me asnjë argument se huazimet nga transferet bankare kanë të bëjnë me të hyra të padeklaruara që janë kalkuluar si qarkullim shtesë. Në këtë rast është obligim i palës së paditur ATK-së, të bartë

detyrimin e vërtetimit të fakteve të cilat e mbështesin vendimin dhe kundërshtojnë kërkesën e tatimpaguesit, neni 81.F paragrafi 2 i Ligjit 04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Gjykata nuk i pranoj pretendimet e paditësit lidhur me rritjen e blerjeve të tatueshme, blerjeve nga importi pa të drejtë kreditimi për periudhat përkatëse tatimore, sepse nuk janë dhënë fakte të mjaftueshme dhe prova se këto tatime shtesë gjejnë mbështetje ligjore nga legjislacioni tatimor në fuqi. Gjykata konstaton se e paditura me të drejt ka bërë ndryshimet në blerjet e tatueshme vendore Maj-Dhjetor/2009, për arsye se është konstatuar se është bërë duplikim i blerjeve dhe se nga regjistrimi i importeve në periudhë të mëvonshme tatimore, kontrolli ka bërë rregullimet duke njohur tvsh e zbritshme nga ku ka rezultuar me rritje kreditimi për tvsh. Ndryshimet në blerjet e tatueshme Janar-Maj/2010 të cilat i ka ndryshuar kontrolli dhe konfirmuar nga eksperti gjyqësor, paditësi nuk i ka kundërshtuar.

Kolegji i Gjykatës së Apelit duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, i pranon në tërësi si të drejta dhe ligjore konkludimet juridike të gjykatës së shkallës së parë sa i përket gjendjes faktike të çështjes, e gjithashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për konflikte administrative të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i ekzaminon sipas detyrës zyrtare si në vështrim të nenit 49 të LKA dhe 194 të LPK. Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të kontestuar si në vështrim të nenit 9 dhe 44 të LKA, në drejtim të thënieve në padi, përgjigjes në padi, si dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ka vlerësuar drejtë, se kërkesë padia e paditësit është pjesërisht e bazuar, duke e anuluar pjesërisht vendimin e organit të paditur. Andaj nuk janë të qëndrueshme pretendimet në ankesë se nga gjykata e shkallës së parë janë bërë shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore sepse procedura në tërësi është zhvilluar në baza ligjore, janë administruar prova të mjaftueshme të palëve ndërgjyqëse të shtjelluara në tërësi si në arsyetim të aktgjykimit lidhur me mënyrë e vendosjes së çështjes, nga rezulton se gjykata e shkallës së parë ka nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur.

Pretendimet ankimore të paditësit lidhur me gjendjen faktike të çështjes, se gjykata nuk është bazuar në provat e bashkangjitura padisë me të cilin vërtetohet se as obligimi shtesë i pjesërishtëm nuk është i saktë se pagesat tatimore për periudhat kontestuese

_____, në lidhje me deklarin dhe pagesën e tvsh-së. Kolegji i shqyrtoi në baza ligjore dhe të njëjtat i refuzon si të pa qëndrueshme dhe gjen se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara në seancën kryesore, ekspertizës së kryer financiare, si dhe shkresave të tjera, ka nxjerrë prova të mjaftueshme si në vështrim të nenit 38 të LKA dhe në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me aprovimin pjesërisht të kërkesë padisë duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, bazuar në faktet e paraqitura si në arsyetim të aktgjykimit të mbështetura në dispozitat ligjore tatimore, ku

është vërtetuar se paditësi ka obligim ti paguaj detyrimet tatimore mbi TVSH për periudhat _____, sepse nuk janë dhënë fakte të mjaftueshme dhe prova se këto tatime shtesë gjejnë mbështetje ligjore nga legjislacioni tatimor në fuqi. Pasi që e paditura ka bërë ndryshimet në blerjet e tatueshme vendore Maj-Dhjetor/2009, për arsye se është konstatuar se është bërë duplikim i blerjeve dhe se nga regjistrimi i importeve në periudhë të mëvonshme tatimore, kontrolli ka bërë rregullimet duke njohur tvsh e zbritshme nga ku ka rezultuar me rritje kreditimi për tvsh. Ndryshimet në blerjet e tatueshme Janar-Maj/2010 të cilat i ka ndryshuar kontrolli dhe konfirmuar nga eksperti gjyqësor, paditësi nuk i ka kundërshtuar.

Mbi këtë gjendje të fakteve të cekur si më lartë, kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vendosur dhe në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale të LKA-së, dhe LPK-së, si dhe dispozitat ligjore materiale-tatimore, si në aktgjykimin e ankimuar. Andaj pasi që sipas theksimeve në ankesë aktgjykimi si i tillë nuk vihet në pyetje, ankesa e paditësit refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi vërtetohet si i drejtë dhe ligjor.

Nga sa u tha më lartë e në vështrim 49 të LKA, dhe neni 200,i LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr. _____/2019, me datë _____

**Kryetare e kolegjit,
F.F.**



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr. ____/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: M.M kryetare, D.R. dhe S.M., anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit H. O., nga fshati _____, Komuna e _____, kundër të paditurit Ministria e Punëve të Brendshme-Komisioni i Ankesave për Ri-integrim, me bazë juridike anulimin e vendimit, të organit të paditur, duke vendosur, lidhur me ankesën e të paditurit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr._____/2016, të datës _____, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë _____, merr këtë;

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** si e bazuar, ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Komisioni i Ankesave për Ri-integrim, e datës _____, **NDRYSHOHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr._____/2016, i datës _____.
- II. Refuzohet** kërkesëpadia e paditësit H. O., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Komisioni i Ankesave për Ri-integrim Nr. rend._____/2015 i datës _____.
- III.** Mbetet në fuqi vendimi i të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme-Komisioni i Ankesave për Ri-integrim Nr. rend._____/2015 i datës _____.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar, e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit H. O., ndërsa ka anuluar vendimin e të paditurës me numër ____/2015 i datës _____ dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të; shkeljes esenciale të dispozitave të

procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Aktgjykimin e goditur me këtë ankesë ta ndryshojë ose të njëjtin ta kthejë në rigjykim.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin numër ____/2015, i dt._____, e ka refuzuar si të pa bazuar, ankesën me nr. prot._____ e datës _____, e ushtruar nga paditësi, më datë _____, për mos njohjen e të drejtës për mbështetje nga Programi për Ri-integrim për vazhdimin e banimit përmes qirasë. Mbetët në fuqi vendimi Nr. _____, i dt._____, i nxjerrë nga Komisioni Komunal për Ri-integrim, i Komunës së _____.

I pa kënaqur me këtë vendim paditësi, ka ushtruar padi në gjykatë, kundër të paditurit, duke pretenduar se vendimi i të paditurës është jo ligjor. Gjykata e shkallës së parë për këtë çështje mban seancë të shqyrtimit kryesor, me dt._____, në prani të paditësit e në mungesë të palës së paditur, dhe pas administrimit të provave si dhe shkresave tjera të lëndës merr aktgjykimin e ankimuar me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se: Me vendimin e kontestuar të paditurit gabimisht është refuzuar ankesa e ankuesit me arsyetimin se e njëjta është parashtruar pas afatit të paraparë për ankesë, krejt pa e vërtetuar drejt gjendjen faktike pasi nuk ka ofruar dëshmi që dëshmon se kur ankuesit i është dorëzuar aktvendimi i organit të shkallës së parë për të mundur të vlerësohet pastaj afatshmëria e ankesës. Prandaj, në këtë gjendje të konstatuar të çështjes kur kemi kontradiktoritet sa i përket datës së pranimit me datën e lëshimit të vendimit të organit të shkallës së parë dhe dorëzimit të ankesës tek organi i shkallës së dytë nga këto arsye kjo gjykatë arsyetimin e të paditurit nuk mund ta marr si të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, duke e shqyrtuar, aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë, vendimin e organit të paditur, kërkesën për qira të paditësit të datës _____, si dhe shkresat e tjera të lëndës, sipas pretendimeve në ankesë, gjen se aktgjykimi i ankimuar me ankesë, nuk është përfshi në shkelje thelbësore nga neni 182.2 të LPK-së i zbatueshëm drejtë për drejtë përmes nenit 63 të LKA-së, ndërsa kolegji gjen se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të nenit 183 par. 1 dhe 2, sepse arsyet në të cilat bazohet Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, sa i përket vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike është jo i drejtë dhe në bazë të fakteve të cilat i ka pasur në dispozicion nuk i ka

vlerësuar drejt, andaj gabimisht ka vepruar kur ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, nuk ka vepruar drejtë kur e ka vërtetuar gjendjen faktike si në aktgjykimin e ankimuar duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe e ka anuluar vendimin e të paditurës, për arsye se vendimi i nxjerrë nga e paditura, është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, kjo për faktin se e paditura e ka refuzuar ankesën e paditësit për arsye se i njëjti ka paraqitur kërkesë jashtë afatit ligjor për të realizuar të drejtën e banimit përmes qerasë nga programi i ri-integrimit. Paditësi është ri-atdhesuar me datë _____, ndërsa kërkesën në Komunën e _____, e ka paraqitur me datë _____, e që të njëjtën kërkesë e ka refuzuar Komuna e _____, me vendimin nr. _____, të dt. _____, me arsyetimin se i njëjti nuk i plotëson kushtet e parapara me Rregulloren QRK nr.20/2013 për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Ri-integrimit, përkatësisht me nenin 2 të Rregullosës QRK nr. 20/2013 për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Ri-integrimit, përcaktohet se: “1. *Kjo Rregullore zbatohet për personat të cilët e kanë lëshuar Kosovën para datës 28 korrik të vitit 2010, dhe të cilët e kanë dorëzuar kërkesën për përfitim brenda afatit të përcaktuar me këtë Rregullore (gjashtë (6) muaj eventalisht edhe 6 muaj nga data e riatdhesimit)*”. Andaj duke u bazuar në kërkesën e paditësit, drejtuar Komunës së _____, me datë _____, i njëjti ka migruar me datë _____, ndërsa është kthyer në Kosovë me datë _____, duke u bazuar në nenin 2 të Rregullosës së lartcekur paditësi ka ushtruar kërkesë jashtë afatit të paraparë ligjor.

Gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka konstatuar faktin se e paditura e ka refuzuar ankesën e ankuesit tani paditësit, me arsyetimin se e njëjta është ushtruar pas afatit të paraparë për ankesë. Kolegji i Gjykatës së Apelit nga vendimi i nxjerrë nga ana e të paditurës nr. ____/2015, i dt. _____, vërtetoi se e paditura nuk e ka refuzuar ankesën për arsyet se e njëjta është paraqitur pas afatit të paraparë për ankesë, por e njëjta e ka refuzuar kërkesën e paditësit për qira për banim të datës _____, për arsye se i njëjti ka paraqitur kërkesë jashtë afatit ligjor për të realizuar të drejtën e banimit përmes qerasë nga programi i ri-integrimit.

Gjykata e Apelit vlerësoi që Aktgjykimi i ankimuar duhet të ndryshohet për faktin se në shkresat e lëndës është kërkesa e paditësit e parashtruar me datë _____, me të cilën ka kërkuar përkrahje për qira për banim, gjë që Gjykata e Apelit vërtetoi faktin se Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk ka pasur shkelje procedurale, të cilat kjo gjykatë i vlerëson sipas detyrës zyrtare, e të cilat e bëjnë që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe çështja të kthehet në rivendosje, Aktgjykimi është dashur të ndryshohet për arsye se nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike ngase shihet çartë nga shkresat e lëndës, se paditësi nuk e ka bërë kërkesën brenda afatit të paraparë me nenin 2 të Rregullosës së QRK-se nr.20/2013, prova të cilat janë të mjaftueshme për këtë gjykatë

që Aktgjykimin e shkallës së parë, ta ndryshoj dhe të mbetet në fuqi vendimi i organit administrativ.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe 201, pika b) dhe c), të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr. ____/2019, me datë _____

**Kryetare e kolegjit,
M.M.**

MJETET E JASHTËZAKONSHME JURIDIKE

Mjetet e jashtëzakonshme juridike palët mund ti shfrytëzojnë pasi që gjykata ka vendosë në mënyrë meritore dhe se aktgjykimi do ta merrte formën e prerë. Ligji për Konfliktet Administrative i ka përcaktuar tri mjete të jashtëzakonshme juridike dhe ato janë:

- Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor
- Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë
- Rishikimi.

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor

Kërkesa për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, si mjet juridik i jashtëzakonshëm, mund të paraqitet kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë dhe atë i dërgohet gjykatës brenda 30 dite, nga data e pranimit të vendimit të formës së prerë kundër të cilit pala paraqet kërkesën. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm sipas dispozitave të ligjit për konfliktet administrative duhet të përmbajë emërtimin e aktgjykimit të gjyqësorit, si dhe shkaqet dhe vëllimin në të cilin propozohet rishqyrtimi. Ky mjet i jashtëzakonshëm juridik mund të ushtrohet për shkak të shkeljes së dispozitave materialo-juridike si dhe për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës. Kompetente për vendosje lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të formës së prerë është Gjykata Supreme konform dispozitave të Ligjit nr.03/L-199. Nëse kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm nuk është e plotë, e pa kuptueshme ose ka të meta, gjyqtari vepron në kuptim të nenit 33 të Ligjit për Konfliktin Administrativ, duke ia kthyer ushtruesit të kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm që në afat prej 8 ditësh ti mënjanojë të metat. Nëse ushtruesi i kërkesës brenda afatit të cekur nuk i mënjanon të metat, gjykata do ta hedh poshtë kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të formës së prerë. Nëse gjykata nuk e hedh kërkesën, atëherë ajo do t'ia dërgoj palës së kundërt, e cila brenda afatit prej 15 dite, mund të jap përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm. Gjykata kundër vendimit të së cilës është paraqitur kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm kanë për detyrë që me kërkesën e gjykatës t'ia dërgojnë të gjitha shkresat e lëndës. Gjykata vendos mbi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm në seancë të mbyllur, gjersa vendimin e kundërshtuar e shqyrton vetëm brenda kufijve të kërkesës. Gjykata me aktgjykim refuzon ose e aprovon kërkesën. Me aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesa gjykata mund ta anuloj ose ta ndryshoj vendimin gjyqësor kundër të cilit është paraqitur kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm. Nëse gjykata anulon vendimin gjyqësor lënda i kthehet gjykatës, vendimi i së cilës është anuluar. Kjo gjykatë e ka për detyrë ti ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe ti shqyrtoj çështjet për të cilat e ka sugjeruar gjykata që ka vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm.

Shembulli - kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm

**GJYKATË THEMELORE NË PRISHTINË -
Departamenti për Çështje Administrative**

PËR

GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS

Paditësi: Sh. Sh. nga Prishtina, rruga “Nënë Tereza” pn.

E paditura: Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në Prishtinë.

Në bazë të nenit 24, 49 paragrafi 4 lidhur me me nenin 28, nenin 51 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (Ligji nr.03/L-202), ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr. _____, të datës _____, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____, datë _____, paraqes këtë:

K Ë R K E S Ë

Për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor

Për shkak të:

- Shkeljeve të dispozitave të Ligjit të Konfliktet Administrative dhe
- Zbatimit të gabuar të së drejtës materiale

I propozon Gjykatës së Apelit që të aprovoj si e bazuar kërkesa dhe të ndryshohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr._____, të datës _____, ashtu që të aprovet kundërpadia e paditësit Sh.Sh. nga Prishtina dhe anulohet aktvendimi i të paditurës nr. _____ të datës _____.

Respektivisht

Aprovet kërkesa e paditësit Sh.Sh. dhe të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr _____, të datës _____ dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë A.nr _____ i datës _____ dhe çështja i kthehet Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, në rigjykim.

ARSYETIM

Para Gjykatës Themelore në Prishtinë, është zhvilluar procedura sipas padisë së paditësit kundër të paditurit nën kundërshtimin e ligjshmërisë së vendimit

nr. _____ i datës _____ me pretendimet si ai si i punësuar pran Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pasi që ai ka dhënë dorëheqje për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore dhe pasi që me pastaj me kërkesë i është drejtuar punëdhënësit, për ta sistemuar në ndonjë pozitë tjetër dhe njëherit ka kërkuar që vendimin për ndërprerjen e punës e që paditësi nuk e ka pranuar.

Vendimet e kundërshtuara:

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje administrative, me Aktgjykimin A.nr. _____, të datës _____, e ka refuzuar kërkesëpadia e paditësit Sh. Sh. me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nr. _____, dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit në Prishtinë me Aktgjykimin AA.nr. _____ të datës _____, e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e paditësit Sh.Sh. nga Prishtina, ndërsa Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë e ka vërtetuar.

Argumentet:

Shkelja esenciale e dispozitave procedurale

Gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e kundërshtuar e ka nxjerrë edhe me shkelje të dispozitave të procedurës duke qenë se për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyetimin e aktgjykimit thuhet për përmbajtjen dhe vet atyre që kanë rëndësi në vendosjen meritore të çështjes.

Kështu paditësi, në AKP pozitën Zyrtal Ligjor në Departamentin _____, nga muaji Janar 2008 deri 2012 për shkaqe shëndetësore ka dhënë dorëheqje me shkrim, përmes email-it duke ofruar dokumentacionin përkatës mjekësor. Më pas me kërkesën me shkrim Nr _____, të datës _____, ka kërkuar lëshimin e aktvendimit me shkrim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës pas dorëheqjes së tij në AKP. Me datë _____, AKP përmes shkresës nr. _____, ka njoftuar paditësit se AKP-ja nuk është e obliguar të lëshoj aktvendim me shkrim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Mirëpo, në Njoftimin, me shkrim të AKP-së, nuk jepet fare Këshilla Juridike e paraparë me dispozitat ligjore, që paditësi të njoftohet për realizimin e të drejtave të tij të mëtejshme, lidhur me afatin ligjor dhe cilit organ duhet ti drejtohet me ankesë.

Paditësi, me kërkesën nr. _____ me datë _____, ka kërkuar nga punëdhënësi AKP rikthim në punë.

Gjykata nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë faktin vendimtar jokontestues se paditësi te e paditura pas dhënies së dorëheqjes së tij me shkrim për shkaqe shëndetësore ka parashtruar kërkesë me shkrim te AKP-ja, ti dorëzohet me shkrim njoftimi-vendimi mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës me datë_____. AKP përmes përgjigjes me shkrim nr._____ të datës_____, e ka njoftuar paditësin se bazuar në nenin 86 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, Dorëheqja nuk është e obliguar ligjërisht ti lejohet aktvendim me shkrim mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës punonjësit kur kemi të bëjmë me dorëheqjen me vet dëshirë te punonjësit.

Për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka ardh deri te aplikimi i gabuar i së drejtës materiale kur gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata e shkallës së parë me rastin konkret gabimisht ka konstatuar se paditësi nuk ka ofruar provë se ka parashtruar ankesë te e paditura para se ti drejtohet KPMSHCK-së pasi se në kërkesën e dytë të AKP-ja e ka kundërshtuar njoftimin dhe ka kërkuar nga organi i shkallës së dytë te AKP-ja kthimin e tij në punë te i njëjti organ me dt._____. Vetëm i ka munguar formulimi i emërimit të parashtrësës si kërkesë në vend të asaj ankesë.

Duke u nis nga këto fakte konsideroj se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, por edhe Gjykata e ka aplikuar dispozitën e nenin 12 par.3 nen par.1.3 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës se nëpunësi civil me rastin e parashtrimit të ankesës te ky organ si shërbyes civil kur ka konstatuar dhe vlerësuar gabimisht se organet administrative drejt ka zbatuar ligjin e lartpërmendur me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit për rikthim në punë.

Vlerësimi i gjykatës se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara dhe në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e të paditurës dhe provat në shkresat e lëndës është jo i drejtë dhe i ligjshëm sepse, paditësi në padi ka prezantuar prova bindëse dhe të mjaftueshme për gjykatën që kanë ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative juridike. Nga se gjykata në rastin konkret lidhur me këtë çështje administrative juridike nuk e ka vërtetuar drejtë dhe në pajtim me ligjin gjendjen faktike duke cenuar ligjin në dëm të paditëses me refuzimin e kërkesëpadisë së tij duke ia pa mundur realizimin e në të drejte themelore të drejtave të njeriut të garantuara edhe me konventën ndërkombëtare ligjin përkatës.

Për më tepër Gjykata e Apelit gabimisht ka vlerësuar se dhe në këtë kuptim të dispozitave materiale-juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë e në përputhje me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë procedurë, për kërkesën e aprovuar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, e drejta materiale është aplikuar në mënyrë të gabuar në këtë rast.

Nga sa u tha më lartë konsideroj se aktgjykimi i atakuar është i kundërligjshëm dhe si i tillë duhet prishur, ose ndryshuar apo çështja të kthehet në rigjykim, ndërsa ankesa e paditësit është e bazuar dhe duhet të aprovuar si e tillë.

Prishtinë, datë _____

Paditësi, Sh. Sh.

Shembulli 1.

Vendimi i Gjykatës supreme - Aprovohet



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ARJ-UZVP.nr. _____

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: _____, kryetar, _____ dhe _____, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional _____, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit SH. SH. nga P., kundër të paditurit – A K, për shkak të anulimit të aktit administrativ A nr..... dt....., duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. nr. _____ dt. _____, në seancën e kolegjit të mbajtur me _____, mori këtë

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit SH. SH. për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____.

ANULOHET aktgjykimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. _____ të datës _____, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë AA.nr. _____, i datës _____, lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____ të datës _____, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit SH. SH., ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr. _____ dt. _____.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____ dt. _____, paditësi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, për shkak të shkeljes së drejtës materiale dhe shkeljeve të dispozitave të procedurës, me propozim që kërkesa të aprovohet, aktgjykimi i goditur

AA.nr_____, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr._____, të anulohen, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.nr. _____ të datës _____, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit Sh. Sh., e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.U.nr._____, i datës _____, me të cilën është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit lidhur me anulimin e vendimit të paditurës nr._____.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme, tani për tani nuk mund të pranoj si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatave më të ulëta, ngase vendimet e atakuara janë përfshi me shkelje të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA).

Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta kanë bërë shkelje të nenit 182 par.2 pika (n) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së. Ky nen parashikon, në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar faktet vendimtare, ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit. Të dy gjykatat nuk kanë dhënë arsytimit të mjaftueshme mbi faktet vendimtare në të cilat bazohen aktgjykimet e tyre, ose ato arsye janë të paqarta dhe kontradiktore. Po ashtu, ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit. Pra, gjykatat e instancës më të ulët në arsyetimin e aktgjykimeve të tyre theksojnë se me aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. Rev._____ të datës_____, është pranuar revizioni i Komunës së _____dhe kërkesa e Prokurorit Publik të Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe janë ndryshuar të dy aktgjykime, në pjesën nën par.I të dispozitivit, ashtu që është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se në bazë të trashëgimisë, është pronar i paluajtshmërisë, dhe të detyrohet Komuna e _____, që të lejoj evidentimin e pronës në emër të tyre. Përkundër kësaj, në arsyetimin e gjykatave të instancës më të ulët nuk është

përmendur fakti se në këtë çështje juridike ekziston vendimi me të cilin është lejuar përsëritja e procedurës kontestimore e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë.

Gjykata Supreme tani për tani nuk mund të pranojë si të drejtë qëndrimin juridik të gjykatave të instancës më të ulët, pasi që në aktgjykimet e tyre nuk janë treguar arsyet për faktet vendimtare, ose ato të dhëna janë të paqarta dhe kontradiktore, ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit, Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, meqenëse, procedura kontestimore nuk ka përfunduar akoma sipas vendimit gjyqësor për përsëritje të procedurës, prej të cilit varet baza juridike për evidentimin e pronës pranë Drejtorisë së Gjeodezisë dhe Kadastrit në Komunën e _____, e cila nuk ka përfunduar me formë të prerë, të dy instanca gjyqësore duke e refuzuar kërkesëpadinë e paditësit kanë bërë shkelje thelbësore të dispozitave procedurale. Duke theksuar se nëse procedura nuk ka përfunduar, e baza juridike për tu evidentuar e drejta mbi pronën mbetet e paqarta, gjykata e shkallës së parë është e detyruar ta ndërpresë procedurën në konfliktin administrativ sipas kërkesëpadi së paditësit deri në përfundimin e procedurës kontestimore në bazë të vendimit për përsëritje të procedurës, fakteve dhe provave të reja. Gjykatat e instancës më të ulët nuk kanë dhënë arsyet për faktet vendimtare për mënyrën se si prona kontestuese ka kaluar prej pronës shoqërore në pronë të personave fizik në bashkëpronësi, dhe si ka ndodhur që e njëjta paluajtshmëri të evidentohet më vonë si pronë shoqërore.

Kjo gjykatë konstaton se të dy instanca gjyqësore kanë bërë shkelje të dispozitave procedurale për faktin se mungojnë arsyet vendimtare mbi të cilat mbështetin aktgjykimet e tyre ose ato arsye janë të paqarta dhe kontradiktore. Për këto arsye, kjo Gjykatë i anuloi vendimet e përmendura dhe vendosi ta kthejë çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata e shkallës së parë është e detyruar që gjatë rivendosjes, konform gjendjes faktike dhe me zbatimin e drejtë të së drejtës materiale, të merr vendim të drejtë, të bazuar në ligj, duke marr parasysh vërejtjet e dhëna në këtë aktgjykim.

Mbi këto arsye, në kuptim të nenit 54.2 dhe 3 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
ARJ.UZVP. nr. _____ dt. _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit,

Shembulli 2.

Vendimi i Gjykatës Supreme - Refuzohet



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ARJ-UZVP.nr._____

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: _____, kryetar, _____ dhe _____, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional _____, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit SH. SH.nga P., kundër të paditurit – Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSSHCK), për shkak të anulimit të aktit administrativ A nr..... dt....., duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. nr. _____ dt. _____, në seancën e kolegjit të mbajtur me _____, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa e paditësit SH. SH.për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. _____ të datës _____.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____ të datës _____, është refuzuar ankesa e paditësit SH. SH., ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për çështje administrative A.nr. _____ dt. _____, me të cilin ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurit Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës në Prishtinë (shkurt: KPMSSHCK) A.nr.... dt....., lidhur me anulimin e vendimit të Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave i Sekretariatit të Zyrës së Prokurorit të Shtetit (shkurt: SZKPSH) KA nr..... dt....., të protokoluar me Nr..... dt....., me të cilin është refuzuar si e pabazuar ankesa e SH. SH., ku objekt ankimor ishte Vendimi i Komisionit Disiplinor i (SZKPSH), me KD nr.... dt.... e protokoluar me Nr..... dt.....

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____ dt. _____, paditësi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm

për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurave dhe së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet kërkesa dhe aktgjykimet e atakuara të anulohet dhe çështja të kthehet në riprocedurë.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktgjykimin të goditur në pajtim me nenin 53 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se me vendimin e Komisionit Disiplinor të SZKPSH me KD Nr..... dt..... të protokoluar me Nr.... dt.... paditësit SH. SH.i është ndërprerë Marrëdhënia e Punës. Me vendimin e Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të SZKPSH me KA Nr.... dt.... e protokoluar me Nr.... dt..... është refuzuar si e pabazuar ankesa e Sh. Sh., ku objekt ankimor ishte anulimi i vendimit të lartpërmendur lidhur me ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës. Me vendimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (KPMSHCK) me Nr.... dt..... është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të lartpërmendur të Komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave të SZKPSH. Konflikti administrativ fillohet me padinë të cilën e paraqiti paditësi në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrativ e cila e refuzojë si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Gjykata e Apelit me aktgjykimin e atakuar AA nr. _____ dt. _____ e refuzon si të pabazuar ankesën e paditësit SH. SH.dhe e vërteton aktgjykimin e shkallës së parë.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme gjen se gjykata e shkallës së dytë drejt ka vendosur kur ka refuzuar ankesën e paditësit.

Sipas nenit 59 par 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-149 për KPMSHCK është përcaktuar se nëpunësit civil janë të detyruar të jenë të pranishëm në vendin e punës në bazë të kushteve të emërimit të tyre dhe gjatë orarit të përcaktuar për funksionimin e institucionit punëdhënës. Nëpunësit civil janë të detyruar të respektojnë orarin e punës dhe ta shfrytëzojnë atë për kryerjen e detyrave të caktuara. Nëpunësit civil janë të detyruar të informojnë eprorët e tyre për çdo mungesë nga vendi i punës. Mosinformimi ose mungesa e palajmëruar nga vendi i punës konsiderohet braktisje e vendit të punës dhe dënohet në përputhje me ligjin.

Ndërsa, Rregullorja me nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil në nenin 6 par 1 pika 1.13 përcakton se mosinformimi dhe mungesa e paarsyeshme për dy ditë pune të një pasnjëshme është shkelje e rëndë serioze.

Prandaj, duke pas parasysh dispozitat e përmendura paditësit i është ndërpre marrëdhënia e punës.

Mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë gjen se gjykatat e instancave më të ulëta kanë vendosur drejtë, dhe me të drejtë është refuzuar ankesa e paditësit, pasi që organet administrative kanë shqyrtuar dhe konstatuar (gjatë procedurës disiplinore) se paditësi ka bërë shkelje të rëndë, në kundërshtim me nenin 6.13 të Rregullores nr.04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, si dhe në kundërshtim me nenin 59 par 1 dhe 2 të Ligjit nr.03/L-149 për KPMSHCK, prandaj Komisioni vendosi për shqiptimin e masës disiplinore ndërprerja e marrëdhënies së punës. Të pabazuara janë thëniet e paditësit lidhur me shkeljet sepse i vlerësoi të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë, ngase aktgjykimi i goditur është i qartë dhe i kuptueshëm, përmban arsye të mjaftueshme dhe faktet vendimtare për marrjen e vendimeve të ligjshme. Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit dhe është bërë aplikimi i drejt të drejtës materiale.

Nga sa u tha më lartë dhe në pajtim me nenin 54.1 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

ARJ.UZVP. nr. _____ dt. _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit,

Shembulli 3.

Vendimi i Gjykatës Supreme - Hudhet



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

ARJ-UZVP.nr._____

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: _____, kryetar, _____ dhe _____, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional _____, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit SH. SH. nga P., kundër të paditurit – Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMSSHCK), për shkak të anulimit të aktit administrativ A nr..... dt....., duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH. nr. _____ dt. _____, në seancën e kolegjit të mbajtur me _____, mori këtë

A K T G J Y K I M

Hudhet poshtë si e pa lejuar kërkesa e të paditurit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH _____ të datës _____.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.UZH. nr. _____ të datës _____, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të paditurës, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.U.nr. _____ dt. _____, me të cilin është aprovuar padia e paditësit Sh.Sh. dhe është anuluar vendimi i të paditurit KPMSSHCK nr. _____ i datës _____, kurse çështja i është kthyer të paditurit në rishqyrtim dhe rivendosje.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____ dt. _____, paditësi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurave dhe së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet kërkesa dhe të ndryshohet aktgjykimi i kontestuar, ashtu që të refuzohet padia e paditësit kurse vendimi i të paditurit me nr. _____ i datës _____, mbetet në fuqi.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të goditur në pajtim me nenin 52.1 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa është e palejueshme.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr. _____, të datës _____, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të paditurit, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.U.nr. të datës _____, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh. Sh. dhe është anuluar vendimi i të paditurit A.nr. _____, i datës _____, si dhe çështja i është kthyer të paditurit në rishqyrtim dhe rivendosje.

Neni 24 i Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) parashikon se kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes së të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes. Sipas nenit 50 (LKA) kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, kjo Gjykatë gjeti se kundër vendimeve të formës së prerë për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtojë Gjykatës Supreme kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA.UZH.nr. _____, të datës _____, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të paditurit ndërsa, është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë nr. _____ të datës _____, me të cilin është aprovuar si e bazuar padia e paditësit Sh. Sh., dhe është anuluar vendimi i të paditurit nr. _____ i datës _____, dhe çështja i është kthyer të paditurit në rishqyrtim dhe rivendosje. Meqenëse, vendimi gjyqësor nuk është bërë i plotfuqishëm, pasi që lënda i është kthyer organit administrativ në rishqyrtim, kjo gjykatë e ka hedhur kërkesën si të palejueshme.

Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 52.1 lidhur me nenin 24 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

ARJ.UZVP. nr. _____ dt. _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit,

KËRKESA PËR MBROJTJE TË LIGJSHMËRISË

Prokurori i shtetit të Kosovës nëse konstaton se është shkelur ligji, dispozitat tjera apo akti i përgjithshëm ka mundësi të paraqes kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe atë në afat brenda 90 dite, nga data kur iu është dërguar palëve vendimi, kundër të cilit paraqitet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë. Bazë për paraqitjen e kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë është ekzistimi i shkeljes së ligjit pavarësisht se me aktin administrativ në favor të kujt është vendosur, të personit fizik apo personit juridik, mirëpo nëse është vendos edhe në dëm të interesit publik. Për këtë arsye të gjitha organet administrative dhe institucionet të cilat ushtrojnë autorizime publike kanë detyrim që ta njoftojnë prokurorin e shtetit të Kosovës me akte të cilat janë shkelur ligji në dëm të interesit publik. Vendimi i gjykatës i cili mund të goditet me këtë mjet juridik është aktgjykimi, përkatësisht aktvendimi i kolegjit të Gjykatës Supreme. Për të gjitha çështjet procedurale lidhur me mjetin juridik të jashtëzakonshëm siç është kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë zbatohen procedurat lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të aktgjykimit të formës së prerë.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit/Kancelarija Srzavong Tzioca/
Office of the Chief State Prosecutor

KMLC.nr. _____

Prishtinë, me datë _____

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË- Departamenti për Çështje Administrative

Për

GJYKATËN SUPREME TË KOSOVËS NË PRISHTINË

Paditësi: Sh. Sh. nga Prishtina.

I paditur: M. M në Prishtinë

Në kuptim të dispozitës së nenit 25 lidhur me nenin 50 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, kundër Aktvendimeve të Gjykatës së Apelit të Kosovës Departamentit për Çështje Administrative AA.nr. _____, të datës _____, dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr. _____, të datës _____, paraqesë:

KËRKESE

Për mbrojtjen e ligjshmërisë

Për shkak të:

Shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative

Andaj,

P r o p o z o j

Të aprovohet, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit.

Aktvendimet e atakuara, i Gjykatës së Apelit të Kosovës Departamentit për Çështje Administrative AA.nr. _____, të datës _____, dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr. _____, të datës _____, të ndryshohen duke aprovuar propozimin

e paditësit _____, për lëshimin e masës së përkohshme deri në përfundimin e plotfuqishmërisë të kësaj çështje juridike.

A r s y e t i m

Paditësi _____, ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kundër të paditurës M.M, për anulimin e vendimit të të paditurës nr. _____ datë _____, me të cilën është urdhëruar rrënimi i objekteve të ndërtuara në parcelën kadastrale nr. _____, ZK....., si i kundërligjshëm, njëkohësisht ka propozuar që Gjykata në kuptim të nenit 296 të LPK-së të caktoj masën e përkohshme shtyrjen e ekzekutimit të vendimit derisa të përfundoj procedura sipas padisë së paditësit.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative me aktvendimin e datës _____, ka refuzuar si të pa bazuar propozimin e paditësit-propozuesit Sh.Sh. për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr. _____ të datës _____, kundër këtij aktvendimi paditësi ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës ne Departamentin për Çështje Administrative dhe kolegji i të njëjtës gjykatë duke vendosur sipas kësaj anekese me datë _____, ka refuzuar si të pa bazuar ankesën e propozuesit-paditësit, ndërsa ka vërtetuar aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë A.nr. _____, të datës _____.

Që të dy gjykatat me rastin e marrjes së aktvendimeve refuzuese janë mbështetur në dispozitat e nenit 22 par.6 lidhur me par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, duke u thirrur se pretendimet ankimore nuk janë të vërtetuara, janë të pamjaftueshme dhe jo bindëse duke u thirrur në faktin se një shtyrje e këtij ekzekutimi të vendimit të paditurës do të ishte në kundërshtim me interesin publik e po ashtu se kjo shtyrje nuk do ti sjell ndonjë dëm të madh palës kundërshtare në rastin konkret propozuesit-paditësit.

Prokurori i shtetit, pasi shqyrtoi propozimin për ushtrimin e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, aktvendimet e kundërshtuara si dhe shkresat e tjera të kësaj lëndë, gjeti se ka bazë ligjore që në këtë çështje të ngritet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Me aktvendimet e atakuar gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë, kanë konstatuar se ekzekutimi i vendimit të të paditurës, do ti sillte dëm paditësit e i cili dëm me vështirësi do të riparohej, respektivisht se një shtyrje e tillë është në kundërshtim me interesin publik në rastin konkret për MM, si palë kundërshtare dhe person i interesuar për ekzekutimin e këtij vendimi, mirëpo në këtë rast nga ana e të dy gjykatave nuk është konstatuar sa do të ishte dëmi në anën e paditësit dhe a është e vështirë që i njëjti të riparohet, po ashtu, se kjo shtyrje është në kundërshtim me interesin publik, respektivisht do ti shkaktonte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare.

Prokurori i Shtetit, konsideron se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nr. _____, i datës _____, duke pasur parasysh vlerën e objektit rrënimi i të cilit kërkohet e për të cilin objekt më herët nga MM, është marr një vendim për autorizimin mjedisor lidhur me ndërtimin e shtëpisë private këtu të propozuesit-paditësit, po ashtu në momentin e ndërtimit ajo zone ka qenë pronë rurale dhe sipas rregullit në atë kohë nuk kanë lëshuar leje të ndërtimit nëpër këto zona, dëmi i cili do të shkaktohej atij me rrënimin e objektit vështirë se mund të riparohej dhe se me rrënimin e objektit mund të krijohet baza juridike për kompensimin e dëmit me çka do të dëmtohej buxheti shtetëror, po ashtu kjo shtyrje nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe se me shtyrjen e ekzekutimit nuk mund të vërtetohet se palës kundërshtare në këtë rast të paditurës do ti shkaktohej dëm i riparueshëm.

Nga të gjitha këto që u theksuan më lartë, konsideroj se gjykatat kanë zbatuar gabimisht dispozitat e neneve 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe se në rastin konkret palës paditëse iu është dashur ti lejohet shtyrja e ekzekutimit të aktit administrativ deri sa gjykata të vendosi në mënyrë meritore për çështjen kryesore.

Nga të cekurat më lartë, konsideroj se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar dhe si e tillë propozojmë që gjykata ta aprovojë.

POKURORI I SHTESTIT
S.S

Vendimet e gjykatës

Shembulli 1.

Vendimi mbi aprovimin e kërkesës



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AML.nr. _____

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: _____, kryetar, _____ dhe _____, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional _____, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit SH. SH. nga P., kundër të paditurit – M. M, në Prishtinë, lidhur me kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, nr. _____, të dt....., duke vendosur për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, të prokurorit të shtetit, të parashtruar kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë nr. _____, datë _____, në seancën e kolegjit të mbajtur me _____, mori këtë

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** kërkesa e prokurorit të shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe ndryshohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative AA.nr. _____, i datës _____.
- II. Apropohet** kërkesa e paditësit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të të paditurës M.M. **Shtyhet** ekzekutimi i vendimit të të paditurës nr. _____, i datës _____, deri në marrjen e vendimit gjyqësor sipas padisë së paditësit..

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr. _____ të datës _____, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit SH. SH., ndërsa është vërtetuar aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr. _____ dt. _____.

Prokurori i Shtetit ka parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke e kontestuar ligjshmërinë e aktvendimeve të Gjykatës së Apelit –Departamenti për

Çështje Administrative AA.nr_____, të datës_____, dhe të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr._____, të datës _____, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, me propozim që të aprovohet kërkesa, të ndryshohen aktvendimet e kontestuara dhe shtyhet ekzekutimi i vendimit nr._____ të datës_____, deri në vendosjen sipas padisë së paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të vendimeve të goditura, në pajtim me nenin 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e **bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e Gjykatës së Apelit AA.nr._____ të datës _____, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit Sh. Sh., e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr._____, i datës _____, me të cilën është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr._____, të datës_____.

Neni 22.2 i LKA-së parasheh se me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund të shtyjë ekzekutimin deri në vendimin gjyqësor, nëse ekzekutimi do ti sillte dëm paditësit i cili vështir do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar, I njëjti nen në paragrafin 6 parasheh se paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, Gjykata Supreme ka gjetur se gjykatat e instancave më të ulëta kanë bërë shkelje të dispozitave të lart përmendur, duke refuzuar kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr._____ datë_____, i cili do ti sillte dëm paditësit i cili dëm vështir do të riparohej, kurse shtyrja nuk është me interesin publik e as që do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare, andaj në rastin konkret Gjykata Supreme, vendosi ta aprovoj kërkesën e prokurorit të shtetit, duke e ndryshuar vendimet e Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative AA.nr._____, datë _____, dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr._____, datë_____.

Mbi këto arsye, në kuptim të nenit 54.1 lidhur me nenin 22.2 dhe 6 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË
AML. nr. _____ dt. _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit,

Shembulli 2.

Vendimi për refuzimin e kërkesës



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AML.nr. ____/2019

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: _____, kryetar, _____ dhe _____, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional _____, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit SH. SH. nga P., kundër të paditurit – M. M, në Prishtinë, për anulimin e vendimit të të paditurës nr. _____ të datës _____, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë së Prokurorit të Shtetit, KMLA.nr. _____, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____, të datës _____, në seancën e kolegjit të mbajtur me _____, mori këtë

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e Prokurorit të Shtetit të Kosovës KMLA.nr. _____ të datës _____, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative AA.nr. _____, i datës _____.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr. _____ të datës _____, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të paditurës M.M., paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative A.nr. _____ dt. _____, me të cilin është aprovuar si e bazuar kërkesëpapia e paditëses Shoqata e të verbërve në Gjakovë për anulimin e vendimit të të paditurës MM nr. _____, të datës _____.

Prokurori i Shtetit, ka parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, KMLA.nr _____ të datës _____, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative AA.nr _____, të datës _____, dhe të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr. _____, të datës _____.

_____, thekson se aktgjykimet e kontestuara janë të përfshira me shkelje të së drejtës materiale dhe shkelje të dispozitave të procedurës, me propozim që të aprovohet kërkesa dhe të prishen aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

Në përputhje me nenin 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, Gjykata Supreme e Kosovës mbajti seancë, dhe pasi vlerësoi aktgjykimet e kontestuara, pretendimet nga kërkesa e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës, ka gjetur se:

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është e **pa bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____ të datës _____, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të paditurës M. M., e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr. _____, i datës _____, me të cilën është aprovuar si e bazuar kërkesëpadia e paditësit për anulimin e vendimit të të paditurës M. M. Nr. _____, të datës _____.

Duke vendosur sipas kërkesës së prokurorit të shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë, të ngritur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____ të datës _____, dhe aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr. _____, të datës _____, Gjykata Supreme e Kosovës është e mendimit se gjykatat e instancave më të ulëta kanë zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit nr. 04/L-092 për Personat Verbër dhe se i kanë marr aktgjykimet e kontestuara në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

Neni 6 i Ligjit nr.03/L-092 për Personat e Verbër përcakton se personat e verbër lirohen nga cdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë. Në rast vetëpunësimi ata lirohen nga çdo detyrim fiskal, ndërsa në rast se zhvillojnë veprimtari si persona juridik, ata gëzojnë lehtësira tatimore të cilat i realizojnë sipas ligjeve në fuqi.

Nga interpretimi i drejtë të kësaj dispozite të nenit 6 të Ligjit nr.04/L-092 për Personat e Verbër, rezultojnë se qëllimi i kësaj dispozite është të rregullohet statusi ligjor i personave të verbër në Republikën e Kosovës, në veçanti detyrimet e tyre lidhur me pagesën e tatimit në pronë. Andaj, organi i paditur administrativ, M.M, kishte për detyrë që në vendimin e tij të kontestuar të shpjegojë pse konsideron se të njëjtit nuk duhet të lirohen nga detyrimi për të paguar tatimin në pronë, në vështrim të dispozitës së nenit 6 të Ligjit nr.04/L-092 për Personat e Verbër. Në vendimin e kontestuar, organi i paditur shpjegon në detaje dispozitën e nenit 8 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i cili i referohet lirimit nga tatimi mbi pronën e paluajtshme, e çfarë sipas mendimit të kësaj gjykate është absolutisht e pakontestueshme, duke mos arsyetuar dispozitën e nenit 8 të Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në

vështrim të nenit 6 të Ligjit për Personat e Verbër, si *lex specialis / lex specialis derogat legi gjenerali*- një ligj që rregullon një çështje specifike mbizotëron një ligj që rregullon vetën çështjet e përgjithshme. Kjo gjykatë konsideron si të papranueshëm konstatimin e të paditurës në arsyetimin e vendimit kontestues “që të refuzojë ankesën e paditëses në bazë të një shkresë zyrtare”. E paditura ka qenë e obliguar të zbatojë dispozitat ligjore në fuqi, e jo që vendimin e saj ta bazoj në shkresa zyrtare të personave të tretë.

Nga sa u tha më lart, rezulton se e paditura nuk ka aplikuar drejtë dispozitat e Ligjit në fuqi për Personat e Verbër, përkatësisht nuk ka vërtetuar faktet thelbësore lidhur me të drejtën e personave të verbër për tu liruar nga tatimi në pronë. Prandaj, kjo gjykatë konsideron se gjykata e instancave më të ulëta kanë vepruar drejtë dhe në mënyrë ligjore kur e aprovuan padinë e paditëses dhe e anuluan vendimin e kontestuar të të paditurës, si dhe e kthyen lëndën organit administrativ në rivendosje. Gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë e obliguan organin e paditur administrativ që, në rivendosje të shqyrtojë ankesën e paditëses në kuptim të dispozitave të Ligjit nr.04/L-092 për Personat e Verbër, dhe se pretendimet në kërkesën e Prokurorit të Shtetit për mbrojtjen e ligjshmërisë janë të pabazuara, për shkak se nuk ndikojnë në vërtetim të një gjendje tjetër faktike nga ajo se çfarë vërtetoi gjykata e shkallës së dytë. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, aktgjykimi i kontestuar i gjykatës së shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm. Në arsyetimin e aktgjykimin të kontestuar janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Gjykatë vlerëson se e drejta materiale është zbatuar drejtë dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të të paditurës.

Mbi këto arsye, në kuptim të nenit 54 paragrafi 1 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

AML. nr. _____ dt. _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit,

Shembulli 3.

Vendimi për hudhjen e kërkesës



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AML.nr. _____

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: _____, kryetar, _____ dhe _____, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional _____, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit SH. SH. nga P., kundër të paditurit – K I, për shkak të anulimit të aktit administrativ A nr..... dt....., duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, e ngritur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____ dt. _____, në seancën e kolegjit të mbajtur me _____, mori këtë

A K T V E N D I M

Hudhet poshtë si e pa lejuar kërkesa e paditësit SH SH. për mbrojtjen e ligjshmërisë, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. _____ të datës _____.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA. nr. _____ të datës _____, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr. _____ dt. _____, me të cilin është hedhur poshtë si e parregullt padia e paditësit Sh.Sh. për anulimin e vendimit të të paditurës.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____ dt. _____, paditësi ka parashtruar kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktvendimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____ të datës _____ dhe aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr. _____ të datës _____. Thekson se aktvendimet e kontestuara janë përfshirë me shkëlqje të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet kërkesa dhe të prishen aktvendimet e gjykatave të instancave të ulëta dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtrësën e tij KMLC.nr. _____, të datës _____, propozoi që të hudhet poshtë si e palejuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë në kuptim të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Në përputhje me nenin 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, Gjykata Supreme e Kosovës mbajti seancë dhe pasi vlerësoi aktvendimet e kontestuara, pretendimet nga kërkesa e paditëses për mbrojtjen e ligjshmërisë, përgjigja e Prokurorit të Shteti të Kosovës dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës, ka gjetur se:

Kërkesa e paditësit për mbrojtjen e ligjshmërisë është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezultojnë se me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr. _____, të datës _____, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit Sh. Sh., e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr. _____, të datës _____, me të cilën është hedhur poshtë si e parregullt padia e paditësit për anulimin e vendimit të të paditurës.

Neni 24 i Ligjit për Konfliktet Administrative përcakton se kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtror Gjykatës Supreme të Kosovës, kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të paraqitet vetëm për shkak të shkeljes së të drejtës materiale ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes. Neni 25 i Ligjit për Konfliktet Administrative përcakton se kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës, prokurori publik mund t'i parashtror Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse me vendim të tillë është shkelur ligji, dispozitat tjera ose akti i përgjithshëm. Neni 50 i Ligjit për Konfliktet Administrative përcakton se kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës brenda tridhjetë (3) ditësh nga dita e pranimit të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën, ndërsa kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitet brenda nëntëdhjetë (90) ditëve nga dita kur u është dërguar palëve vendimi,, kundër të cilit paraqitet kërkesa.

Duke pasur parasysh dispozitat e lartcekura të Ligjit për Konfliktet Administrative, kjo gjykatë gjeti se kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, Gjykatës Supreme të Kosovës pala mund të paraqes kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa prokurori publik mund të parashtror kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë. Nga sa u parashtrua, rezultojnë se pala nuk mund të paraqet gjykatës kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, por atë mund të bë vetëm prokurori publik, për këtë arsye kjo gjykatë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga paditësi, e hudhi si të palejuar me ligj.

Nga sa u tha më lart e në pajtim me nenin 52.1 lidhur me nenin 24 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

AML. nr. _____ **dt.** _____

Procesmbajtësi,

Kryetari i kolegjit,

RISHIKIMI

Në bazë të dispozitave të ligjit për konfliktet administrative pala e interesuar mund të kërkojë risimin e vendimit që ka marrë formën e prerë dhe atë kur plotësohen kushtet:

1. Kur pala mëson për fakte të reja, apo nëse konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja, në bazë të së cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë më të favorshme për të, po të ishin shkruar ose përdorur këto fakte, apo prova, në procedurën e mëparshme gjyqësore.
2. Vendimi i gjykatës ka ardhur si pasojë e veprës penale të gjyqtarit apo punëtorit në gjykatë ose vendimi është nxjerrë me veprim mashtrues të përfaqësuesit ose të autorizuesit të palës, të kundërshtarit të tij ose të përfaqësuesit apo të autorizuarit të kundërshtarit, kurse ky veprim përbënë vepër penale.
3. Vendimi është bazuar në aktgjykimin e nxjerrë në çështje penale apo civile kurse ky aktgjykim është anuluar më vonë me vendim gjyqësor të formës së prerë.
4. Dokumenti në të cilin bazohet vendimi është i falsifikuar, apo nëse dëshmitari, eksperti, ose pala gjatë dëgjimit para gjykatës ka dhënë deklaratë të rremë, kurse vendimi i gjykatës është bazuar në këtë deklaratë.
5. Pala konstaton apo krijon mundësi ta përdor vendimin e mëparshëm ta nxjerrë në të njëjtin konflikt administrativ.
6. Personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marr pjesë në konflikt administrativ.

Nga pika 1 deri në pikan 5 rishikimi do të lejohet vetëm nëse pala, pa faj të vetë, nuk ka pasur mundësi që këto rrethana ti shtrojë në procedurën e mëparshme.

Rishikimi i vendimeve në kushtet e cekura më lart lejohet kur ato rrethana janë vërtetuar me vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente për pikën 2 dhe 4.

Rishikimi i vendimeve mund të kërkohej jo më vonë se brenda 30 ditësh nga data kur pala të ketë mësuar për shkakun e rishikimit. Nëse pala ka mësuar për shkakun e rishikimit para se të ketë marrë fund procedura para gjykatës, gjersa për këtë shkak nuk ka mundur ta përdorë gjatë procedurës, rishikimi mund të kërkohej brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të vendimit. Afati subjektiv për ushtrimin e kërkesës për rishikim është 30 ditë, nga data kur pala të ketë mësuar për shkakun e rishikimit. Gjersa afati objektiv është pasi të kenë kaluar 3 vjet nga data kur vendimi të ketë marrë formën e

prerë, rishikimi nuk mund të kërkohet. Kompetente për të vendosur lidhur me kërkesën për rishikim vendos gjykata që ka nxjerr vendimin.

FORMA DHE PËRMBAJTJA E KËRKESËS PËR RISHIKIM

Kërkesa për rishikim duhet të përmbajë aktgjykimin ose vendimin i cili është nxjerr në procedurën e konfliktit administrativ, rishikimi i të cilit kërkohet.

Baza ligjore e rishikimit, provat dhe rrethanat që e bëjnë të besueshëm ekzistimin e kësaj baze për rishikim.

Rrethanat nga të cilat rezultojnë se kërkesa është paraqitur në afatin ligjor, dhe me cilat prova vërtetohet.

Në cilin drejtim dhe në cilin vëllim propozohet ndryshimi i aktgjykimit respektivisht i vendimit të nxjerr në procedurë, rishikimi i të cilit kërkohet.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të kërkesës për rishikim, vendosë në seancë të mbyllur. Gjykata fillimisht duhet të vërtetoj se kërkesën e ka paraqitur personi i autorizuar ose kërkesa për rishikim është ushtruar në kohën e duhur, apo pala e ka bërë të paktën të besueshëm ekzistimin e bazës ligjore për rishikim. Nëse këto tri elemente nuk janë plotësuar atëherë gjykata duhet ta hedh poshtë kërkesën me vendim. Pas vërtetimit të këtyre elementeve gjykata kërkesën për rishikim ia dërgon palës kundërshtare i cili brenda 15 ditësh duhet ti përgjigjet kërkesës për rishikim. Pas skadimit të këtij afati për përgjigje në kërkesë për rishikim, gjykata vendosë me aktgjykim mbi kërkesën për rishikim. Nëse lejohet kërkesa për rishikim do të shfuqizohet (anulohet) vendimi i atakuar me kërkesë për rishikim.

Shembulli - kërkesa për rishikim

A.nr. _____

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative

Propozues: M. M, nga Prishtina, Rr. “ Muhamet Fejza”, pn.

Kundër propozues: O. O, me numër të regjistrimit të biznesit _____, me seli në Prishtinë.

E paditur: Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Inspektorati i Punës, Prishtinë.

KËRKESË PËR RISHIKIMIN E AKTGJYKIMIT A.nr. _____

Bazuar në nenin 55 paragrafi 1.6 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative

Baza juridike e kërkesës për rishikim

Nenet 55 paragrafi 1.6, 57, 58, 60 dhe 61 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative (më tutje LKA).

Përmbledhje e fakteve dhe objekti i kërkesës

Propozuesi M. M, ka qenë në marrëdhënie pune tek kundër propozuesi O.O, nga data _____ e deri më datë _____, kur kundër propozuesi ka marr vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të propozuesit.

Me datë _____, propozuesi paraqiti ankesë pranë Inspektoratit të punës kundër vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies.

Me datë _____, Inspektorati i punës nxori vendimin me numër _____ me të cilin ka obliguar kundër propozuesin të shfuqizoj vendimin për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Vendimi administrative në shkallë të parë u vërtetuar nga organi i shkallës së dytë përmes vendimit nr. _____, datë _____.

Me datë _____, kundër propozuesi ka paraqitur padi në Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me të cilën e ka kundërshtuar vendimin e IP-së numër _____, datë _____.

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me datë _____, ka mbajtur seancë publike dhe pas shqyrtimit të padisë dhe vlerësimit të

provave ka marr aktgjykim me të cilin e ka aprovuar kërkesëpadinë e kundër propozuesit O.O, dhe ka anuluar vendimin e të paditurës MPMS-IP nr. _____ datë _____ dhe çështjen e ka kthyer te e paditura në rishqyrtim dhe rivendosje.

Me datës propozuesi, ka pranuar një kopje të aktgjykimit A.nr._____, të datës _____, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Pas leximit të të njëjtit, propozuesi kuptoi se nuk është ftuar fare dhe nuk i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në konflikt administrative.

Objekt i kësaj kërkesë është rishikimi i aktgjykimit A.nr. _____, të datës _____, për shkak se sikurse përcaktohet me nenin 55 paragrafi 1.6 të LKA-së, personit të interesuar, në këtë rast propozuesi M. M, nuk i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në konflikt administrativ.

Propozuesi M. M, kërkon nga gjykata që të aprovoj kërkesën për rishikim sit ë bazuar, të shfuqizoj aktgjykimin A.nr. _____, të datës _____, dhe të refuzojë sit ë pa bazuar padinë e kundër propozuesit të paraqitur kundër vendimit të MPMS-IP nr._____, datë _____.

ARSYETIMI JURIDIK I KËRKESËS

Aktgjykimi A.nr. _____ i datës _____, duhet të rishikohet për arsye se, sikurse përcaktohet me nenin 55 paragrafi 1.6 i LKA-së, i njëjti është marrë pa i dhënë mundësin palës së interesuar për të marrë pjesë në konflikt administrative.

Me nenin 55 paragrafi 1.6 të LKA-së është përcaktuar shkakun në bazë të të cilit propozuesi kërkon rishikimin e Aktgjykimit A.nr._____, ndërkaq në bazë të nenit 57 paragrafi 1 të LKA-së, përcaktohet që rishikimi mund të kërkohet jo më vonë se Brenda tridhjetë ditësh nga dita kur pala të ketë mësuar për shkakun e rishikimit.

Kjo dispozitë ligjore përcakton afatin subjektiv prej tridhjetë (30) ditëve për paraqitjen e kërkesës për rishikim pasi që pala të ketë mësuar për shkakun mbi bazën e të cilit kërkohet rishikimi. Në rastin konkret, propozuesi M. M. me datë _____, ka pranuar aktgjykimin, dhe i njëjti ka mësuar për shkakun e rishikimi, për faktin se nuk është ftuar për të marrë pjesë në konfliktin administrativ si palë me interes.

PROVË: *Aktgjykimi A.nr._____, datë _____, i cili nuk përmban të dhëna se pala e interesuar është ftuar për të marrë pjesë në konfliktin administrative.*

Neni 58 i LKA-së thekson se mbi kërkesën për rishikim vendos gjykata që ka nxjerrë vendimin. Në këtë rast, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, duhet të vendos mbi kërkesën për rishikim të vendimit sepse e njëjta ka nxjerrë Aktgjykimin A.nr._____.

Kjo kërkesë për rishikim paraqitet Brenda afitit të parashikuar ligjor nga neni 57 paragrafi 1 të LKA-së, kjo për faktin se propozuesi ka mësuar për shkakun në ditën e pranimit të aktgjykimit A.nr. _____, me datë _____.

PROVË: *Fletë dorëzimi i Aktgjykimit A.nr. _____, i datës _____, i cili gjendet në shkresat e lëndës.*

Propozuesi kërkon që Aktgjykimi të rishikohet në tërësinë e tij dhe në atë mënyrë që propozuesi si palë e interesuar të ketë mundësi të marrë pjesë dhe të parashtoj qëndrimet dhe argumentet e tij në konfliktin administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë ka vendosur mbi të drejtat dhe interesin juridik të propozuesit si palë e interesuar pa i dhënë mundësinë që të parashtoj qëndrimet dhe argumentet.

Propozuesi vlerëson se vendimi i IP-së është plotësisht i ligjshëm dhe i njëjti është marr në bazë të kompetencave ligjore të IP-së dhe mbi bazën e fakteve të konstatuara drejtë nga ana e Inspektoratit të Punës.

Në rastin e propozuesit, ndërprerja e marrëdhënies së punës nga ana e kundër propozuesit, është dashur të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit të Punës. Inspektorati i Punës, si organ mbikëqyrës i zbatimit të Ligjit të Punës, rezulton se ka pasur kompetencë dhe autorizim ligjor për të marrë vendimin IP nr. _____.

Përfundimi dhe kërkesa

Bazuar në argumentet dhe dëshmitë e paraqitura me këtë kërkesë për rishikim, propozuesi M.M. kërkon nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, që në përputhje me nenin 61 të LKA-së të merr:

AKTGJYKIM

Aprovohet si e bazuar kërkesa e palës së interesuar M.M. për rishikimin e aktgjykimit A.nr. _____, të datës _____.

Shfuqizohet aktgjykimi A.nr. _____ i datës _____.

Refuzohet si e pa bazuar padia e paditësit O.O. me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit të paditurës MPMS-IP nr. _____ të datës _____.

Prishtinë, me datë _____

Propozuesi, M.M

Shembulli - vendimi i gjykatës së shkallës së parë

Shembulli 1.

Refuzohet kërkesa

A.nr.____/10

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren: N.N, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit T..A.International me seli në Lipjan të cilën e përfaqëson av. _____, nga Prishtina, kundër të paditurit Organi Rishqyrtues i Prokurimit, për shkak të kërkesës për rishikimin e vendimit gjyqësorë dhe ankesës së ushtruar kundër vendimit me A.nr. ____/10 të datës 12.06.2014, jashtë seancës më dt. _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Refuzohet** kërkesa për rishikimin e aktvendimit, në çështjen e konfliktit administrativ të përfunduar me Aktvendimin e Gjykatës me nr. A.____/10 të datës 12.06.2014, e ushtruar nga ana e paditësit T. A. International, me seli në Lipjan, më datë _____, **si e pa lejuar**.
- II. Hudhet poshtë** ankesa e paditësit T.A. International, me seli në Lipjan, e ushtruar kundër të aktvendimit A.nr.____/10 të datës 12.06.2014, **si e pas afatshme**.

A r s y e t i m

Paditësi T.A. International me seli në Lipjan, ka parashtruar kërkesë për rishikimin e aktvendimit më datë _____, si dhe ankesë kundër të njëjtit aktvendim më datë _____, në çështjen e konfliktit administrativ të përfunduar me Aktvendimin e Gjykatës me nr. A.____/10 të datës _____.

Për të vlerësuar lejueshmërinë e kërkesës së parashtruar si dhe ankesës së paditësit, Gjykata u bazua në dispozitën ligjore të nenit 55 par. 1 të LKA-së, e cila përcakton se “pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësorë, që ka marrë formën e prerë”, kur:

Pika 1.1.e këtij neni përcakton se: “pala meson për fakte të reja, apo nëse konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja, në bazë të së cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë më të favorshme për të, po të ishin shtuar ose përdorë këto fakte, apo prova, në procedurën e mëparshme gjyqësore”, ndërsa

Në pikën 1.2. të po këtij neni përcaktohet se: “ vendimi i gjykatës ka ardhë si pasojë e veprës penale të gjyqëtarit apo punëtorit në gjykatë ose vendimi është nxjerrë me

veprimin mashtrues të përfaqësuesit ose të autorizuarit të pales, të kundërshtarit të tij ose të përfaqësuesit apo të autorizuarit të kundërshtarit, kurse ky veprim përbën veprë penale”;

Pika 1.3 e këtij neni përcakton se: “vendimi është bazuar në aktgjykimin e nxjerrë në çështjen penale apo civile, kurse ky aktgjykim është anuluar më vonë me vendim gjyqësorë të forms së prerë”;

Pika 1.4 përcakton se: “dokumenti në të cilin bazohet vendimi është i falsifikuar apo nëse dëshmitari eksperti, ose pala gjatë dëgjimit para gjykatës ka dhënë deklaratë të rreme, krse vendimi i gjykatës është bazuar në këtë deklaratë”;

Pika 1.5 përcakton se: “pala konstaton apo krijon mundësi ta përdorë vendimin e më parshëm të nxjerrë në të njëjtin konflikt administrativ” dhe

Pika 1.6 e po këtij neni përcakton se: “personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrative”.

Gjykata vëren se në rastin konkret Padiësi, ka parashtruar kërkesë për rishikimin e aktvendimit, në çështjen e konfliktit administrativë të përfunduar me A.____/10 të datës 12.06.2014, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative të përmendura më lartë, e qka don të thotë se nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e kërkuara në bazë të kësaj dispozite ligjore, që pastaj gjykata të lejojë rishikimin e vendimit gjyqësorë.

Gjykata vlerëson se në procedurën e konfliktit administrativë vlejné dispozitat e nenit 55 par. 1, 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të LKA-së, lidhur me lejueshmërinë e këtij mjeti juridik, e që në rastin konkret asnjëra nga kushtet e kërkuara nuk janë plotësuar, për të lejuar rishikimin e vendimit gjyqësorë.

Bazuar në dispozitat e cekura më lartë të LKA-së, del se pala e paditëse, nuk ka parqitur provat e nevojshme me të cilat do të plotësonte ndonjërin prej kushteve të kërkuara në procedurë të konfliktit administrativë, e të cilat rrethana e lejojnë rishikimin e vendimit gjyqësorë, andaj shkaqet e paraqitura në kërkesë për rishikim nga ana e paditësit, nuk paraqesin kusht ligjorë sipas të cilit do të mund të lejohet rishikimi i vendimit gjyqësorë.

Gjykata ka vlerësuar edhe ankesën e paditësit të ushtruar më datë _____, kundër të njëjtut aktvendim, mirëpo të njëjtën e hudhë si të pas afatëshme pasi që, nga fletë kthesa për dorëzim personal (përmes publikimit në tabelën e shpalljeve) vërtetohet se i paditësi, aktvendimin e gjykatës, e ka pranuar më datë _____, ndërsa ankesën kundër këtij aktgjykimi e ka dorëzuar në gjykatë, më datë _____, andaj nga kjo vërtetohet se ankesa është dorëzuar jashtë afatit të paraparë ligjor.

Nga sa u theksua më lartë, e konform nenit 55 par. 1 të LKA-së si dhe në kuptim të nenit 49 par. 2 dhe 3 e lidhur me nenin 34 par. 1 pika 1.1 të LPK-së, u vendos sin ë dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/10, më dt. _____

**Gjyqtarja,
N.N.**

Këshillat Juridike:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj Gjykate.

Shembulli 2.
Kërkesa hudhet



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.____/13

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren H.H, në çështjen juridike të paditësit, “R. H.” sh.p.k me seli në Mamushë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson _____, avokat nga Prizreni, kundër të paditurit, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPM) në Prishtinë, duke vendosur lidhur me kërkesën e palës paditëse për rishikimin e procedurës, jashtë seance, me dt. _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë kërkesa e paditësit “R. H.” sh.p.k me seli në Mamush e dt. _____, për rishikimin e procedurës në lëndën A.nr.____/13.

A r s y e t i m

Paditësi “R. H.” sh.p.k përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij, ka parashtruar kërkesë në këtë Gjykatë me dt. _____, për rishikimin dhe vazhdimin e procedurës në lëndën A.nr.____/13.

Për të vlerësuar kërkesën për rishikimin e procedurës, Gjykata iu referua nenit 55 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative I cili përcakton se “Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi, që ka marrë formë të prerë” kur: pika 1.1. “pala mëson për fakte të reja, apo nëse konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja, në bazë të së cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë më të favorshme për të, po të ishin shtruar ose përdorur këto fakte, apo prova, në procedurën e mëparshme gjyqësore”, ndërsa në pikën 1.2. të këtij neni përcaktohet se: “vendimi i gjykatës ka ardhur si pasojë e veprës penale të gjyqtarit apo punëtorit në gjykatë ose vendimi është nxjerrë me veprim mashtrues të përfaqësuesit ose të autorizuesit të palës, të kundërshtarit të tij ose të përfaqësuesit apo të autorizuesit të kundërshtarit, kurse ky veprim përbën vepër penale”, pika 1.3. e këtij neni përcakton se “vendimi është bazuar në aktgjykimin e nxjerr në çështjen penale apo civile, kurse ky aktgjykim është anuluar më vonë me vendim gjyqësor të formës së prerë”, pika 1.4. e cila përcaktonse “dokumenti në të cilin bazohet vendimi është i falsifikuar, apo nëse dëshmitari, eksperti, ose pala gjatë dëgjimit para gjykatës ka dhënë deklaratë të rreme,

kurse vendimi i gjykatës është bazuar në këtë deklaratë”, pika 1.5. pala konstaton apo krijon mundësi ta përdorë vendimin e mëparshëm të nxjerrë në të njëjtin konflikt administrative” si dhe pika 1.6. e këtij neni përcakton se “personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia për të marrë pjesë në konfliktin administrativ”.

Bazuar në dispozitat e cekura si me lartë, gjykata konstaton se paditësi me kërkesën e tij për rishikimin e procedurës në lëndën, A.nr._____/13 drejtuar kësaj gjykate nuk i ka bërë të besueshme pretendimet me ndonjë fakt të bazuar në prova konkrete se ekziston baza ligjore për rishikim të procedurës nga ndonjë bazë ligjore e përcaktuar me dispozita ligjore. Lidhur me këtë çështje juridike-administrative gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e dt._____, ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit “R. H.” sh.p.k si të pabazuar, ndërsa Gjkata e Apelit me aktgjykimin AA.nr._____/2016 të dt._____, e ka refuzuar ankesën e palës paditëse dhe ka vërtetuar vendimin e Gjykatës së shkallës së parë A.nr._____/2013 të dt._____. Lidhur me këtë çështje paditësi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm për të cilën Gjkata Supreme me vendimin e saj ARJ.nr._____/2017 të dt._____, e ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e parashtruar kundër aktgjykimin të Gjykatës së Apelit të Kosovës – Departamenti për Çështje Administrative dhe është vërtetuar sërish aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë i dt._____. Andaj, Gjkata duke e vlerësuar kërkesën e paditësit për rishikimin e procedurës dhe pretendimin e paditësit se i plotësojnë kushtet ligjore në bazë të dispozitës së nenit 55 pika 1.1 pasi që si provë e re është paraqitur aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm i dt._____, më të cilin i njëjti është liruar nga akuza për veprën penale _____ nga neni 347 par.85 lidhur me par.1 të KP-së konstaton se, procedura administrative është një procedurë e ndarë nga procedura penale dhe vendimi i paraqitur nga paditësi si një provë e re, nuk ka ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative nga ajo se si ka vendosur gjykata e shkallës së parë me vendimin A.nr._____/2013 të dt._____. Andaj, duke i marr parasysh arsyet e cekura me lartë kjo Gjykatë konstaton se paditësi nuk e arsyeton asnjëherë nga bazat ligjore që do të mundësonin rishikimin e procedurës në rastin konkret, ndërsa prova e re e paraqitur nga paditësi nuk ka ndikim në vendosje ndryshe nga ajo e vërtetuar.

Prandaj, meqenëse arsyet e paraqitura në kërkesë nga ana e paditëses, nuk lejojnë mundësin e rishikimit të procedurës kjo gjykatë e hedhë poshtë kërkesën për rishikim të procedurës pasi që pala nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e bazës ligjore që ligji e ka përcaktuar për mundësinë e rishikimit të procedurës.

Nga sa u theksua me lartë, duke ui bazuar në nenin 55,34 dhe neni 60 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktin Administrativ u vendos sin ë dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative
A.nr._____/13, dt._____

Shembulli 3.

Aprovohet kërkesa për rishikim

KARAKTERI I DETYRUESHËM I AKTGJYKIMIT NË KONFLIKTIN ADMINISTRATIV

Ligji për konfliktet administrative ka përcaktuar se kur gjykata e anulon aktin administrativ, kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ, lënda i kthehet të njëjtit organ i cili ka nxjerrë aktin e mëparshëm, të cilin gjykata tani e ka anuluar. Nëse sipas karakterit të çështjes, që ka qenë objekt i konfliktit, duhet që në vend të aktit të anuluar administrativ, të nxirret një tjetër akt sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të cilat i kishte dhënë gjykata me rastin e anulimit të aktit administrativ. Organi kompetent ka për detyrë ta nxjerrë aktin e ri për shtyrje, jo më vonë se brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të aktgjykimit.

Pas nxjerrjes së aktgjykimit, nga ana e gjykatës kompetente në konfliktin administrativ, lindin tri situata të ndryshme dhe atë:

- Organi vepron në përputhje me vërejtje dhe sugjerime të gjykatës dhe se me atë veprim nxjerr aktin e ri administrativ.
- Organi kompetent nxjerr akt të ri administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës të dhënë në aktgjykim.
- Organi në afatin e caktuar fare nuk nxjerr akt të ri administrativ edhe pse ka qenë i detyruar për këtë.

Në qoftë se organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ e nxjerr aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, paditësi mund të parashtrij paditë të re, gjykata mund të anuloj aktin e kontestuar, me aktgjykim i cili krejtësisht e zëvendëson aktin administrativ të anuluar.

Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerr aktin administrativ brenda 30 ditësh, nga data e dërgimit të aktgjykimit, pala me parashtrësë të veçantë mund të kërkoj nxjerrjen e aktit duke kërkuar nga organi administrativ që të veprojë konform dispozitës së nenit 65 të Ligjit për konfliktet administrative. Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerrë menjëherë e jo më vonë se 30 ditë, aktin e ri administrativ ose aktin në zbatimin e aktgjykimit të nxjerrë pala mund të kërkojë me parashtrësë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë. Nëse organi kompetent nuk e nxjerr aktin brenda 7 ditësh nga kjo kërkesë, pala mund të kërkojë nxjerrjen e aktit të tillë nga gjykata që ka nxjerrë aktgjykimin. Gjykata duke u bazuar në kërkesën e palës do të kërkojë nga organi kompetent njoftimin mbi shkaqet për të cilat organi administrativ nuk e ka nxjerrë aktin e ri. Organi kompetent ka për detyrë ta jap këtë njoftim menjëherë, jo më vonë se brenda 7 ditësh. Nëse organi administrativ nuk e bënë këtë, apo nëse njoftimi i dhënë sipas mendimit të gjykatës nuk e arsyeton

moszbatimin e arsytimit të gjykatës, gjykata do të nxjerrë vendimin i cili e zëvendëson aktin e organit kompetent. Vendimin e nxjerrë nga gjykata, do t'ia dërgojë organit kompetent që ushtron mbikëqyrjen. Organi administrativ kompetent për ekzekutim ka për detyrë që ta përmbarojë vendimin e gjykatës. Kur në konfliktin administrativ është nxjerrë aktgjykimi nga ana e gjykatës kompetente, gjersa organi ka nxjerrë aktin administrativ për ekzekutimin e këtij aktgjykimi, por pranë organit kërkohet rishikimi i aktgjykimit për këtë akt administrativ, rishikimi mund të lejohet nëse shkak i rishikimit ka lindur pranë organit që e ka nxjerrë aktin administrativ.

Kërkesa për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit administrati (masa e sigurisë)

Me Ligji e konfliktit Administrativ nenin 22, në par. 1 është përcaktuar se: Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe.

Me qëllim që të parandalohet shkaktimi i dëmit në dëme të palës apo në dëme të interesit të përgjithshëm shoqërorë, ky ligj, e par. 2 të po këtij neni ka përcaktuar se:

Me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do ti sillte dëm paditësit, i cili vështir do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin e përgjithshëm publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëme të madhe palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Me dispozitën e këtij neni par. 3 është paraparë se: bashkë me kërkesën për shtyrje duhet të paraqitet edhe prova, që tregon se padia është parashtruar.

Me par. 6 të këtij neni është përcaktuar se: paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në par. 2 të këtij neni.

Me këtë dispozitë ligjore është përcaktuar gjithashtu se si organi administrativ ashtu edhe gjykata, lidhur me kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit duhet të vendosin brenda afatit prej 3 (tre) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

Kërkesa për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të organit administrativ

Shembulli

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË - DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

Paditësi: Sh. Sh. nga Prishtina, rruga “Nënë Tereza” pn.

E paditura: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në Prishtinë

P A D I

Për

Hapjen e konfliktit adminsitrativ

Për anulimin e vendimit nr. _____, të datës _____, të lëshuar nga Keshilli Gjyqësor i Kosovës, në Prishtinë. Me propozim për caktimin e masës së përkohshme për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit

Përkitazi me:

- Për shkak të shkeljeve thelbësore të procedurës;
- Shkelje të ligjit material dhe
- vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

A R S Y E T I M

Përmbledhje e fakteve:

I pa kënaqur me vendimin nr. _____ të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, brenda afatit ligjor me datë _____ kam parashtruar ankesë me numër _____ në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës.

KPMSHCK, me datë _____, me përgjigjen numër _____, të datës _____, ka theksuar se “KPMSHCK nuk mund të nxjerr vendim lidhur me ankesën tuaj, sepse nga data _____, katër anëtar të Këshillit u ka skaduar mandati. Në këtë kuptim kjo e bënë të pamundur që Këshilli të vendos për ankesat e ankuesve pasi që në bazë të nenit 16 paragrafi 3 të Ligjit nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesat i shqyrton Kolegji i përbër prej 3 anëtarëve”.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 29 paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, jemi të detyruar ti drejtohem Gjykatës për mbrojtjen e të drejtave të shkelura në procedurë administrative nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Me vendimin nr. KA _____ të datës, Komisioni për zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në KGJK, ka bërë shkelje thelbësore procedurale, i njëjti ankuesin nuk e ka ftuar fare të deklarohet lidhur me pretendimet e tij ankimore, dhe nuk e ka mbajtur fare seancën për të konstatuar drejtë gjendjen faktike dhe juridike me ankesën edhe kompetencën.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i KGJK-së ka qenë i obliguar që në seancë të ftojë të dy palët në pajtim me dispozitat e nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores nr.05/2011 për Procedura e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, ku përcaktohet se: “ Kur ankesat pranohen në Komision në pajtim me nenin 5 të kësaj rregullore, Komisioni fillimisht angazhohet të zgjidhë kontestin duke i ftuar të dy palët, ankuesin dhe palën ndaj të cilës është bërë ankesë, për arritjen e kompromisit”.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i KGJK-së po ashtu ka qenë i obliguar që në seancë të ftojë të dy palët në pajtim me dispozitat e nenit 7 paragrafi 1.7 të Rregullores nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Me vendimi nr. _____, Komisioni ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës, duke lënë në fuqi vendimin nr. _____ të datës _____.

Duke marrë parasysh të gjitha shkeljet e lartcekura nga KGJK-ja lidhur me vendin e punës, dhe duke ditur faktin se KGJK-ja nuk më ka ofruar asnjë pozitë të punës dhe më ka lënë pa punë dhe pa të ardhura personale, e që tërë kjo po ndikon keq dhe po shkakon dëme të konsideruara në mirëqenën dhe shëndetin tim, në pajtim me nenin 22 paragrafi 2, 3 dhe 6 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet administrative paraqesë këtë:

KËRKESË PËR SHTYRJEN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT

Duke marrë parasysh se me vendimin e datës _____, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të KGJK-së, me të cilin është refuzuar ankesa ime dhe është vërtetuar vendimi nr. _____ i datës _____, për transferimin e paditësit në pozitë të barasvlershme, e të cilin kanë vendosur për ta shuar ose plotësuar me nëpunës tjetër e të gjitha këto veprime palës paditëse janë duke i shkaktuar dëme të pariparueshme materiale e shpirtërore, pasi po i mohohet e drejta e punës dhe e drejta e pagës, dhe duke marr parasysh qe kjo shtyrje nuk është kundërshtim me interesin publik e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar, në pajtim me dispozitat e nenit 22 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit

nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, Gjykatës i propozojë që brenda afatit ligjor të nxjerr këtë:

AKTVENDIM

Shtyhet ekzekutimi i vendimit nr. _____, datë _____, të KGJK-së, për shuarjen e pozitës _____, si dhe obligohet e paditura për pezullimin e të gjitha procedurave për plotësimin/shuarjen e pozitës _____, deri në vendosje meritore sipas padisë.

Duke marr parasysh të gjitha arsyetimet dhe dëshmitë që tregojnë se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në KGJK ka vepruar në kundërshtim me ligjin me rastin e përjashtimit tim nga e drejta e ushtrimit të punës në KGJK, dhe duke marr parasysh të gjitha shkeljet e cekura me larë që e kanë shoqëruar këtë procedurë të transferimit të nëpunësve të ZPD-së në kuadër të KGJK-së, duke u bazuar në provat e bashkangjitura dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të aplikueshme, paditësi i propozon Gjykatës që pas shqyrtimit të të gjitha provave veç e veç dhe të gjithave së bashku, të merr:

AKTGJYKIM

- Aprovohet si e bazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit Sh. Sh.
- Anulohet vendimi nr. _____, i datës _____, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i KGJK-së.
- Obligohet e paditura që paditësin Sh. Sh. ta kthej në pozitën _____, me të gjitha të drejtat dhe përgjegjësit sipas aktit të emërimit.

Prishtinë, datë _____

Paditësi, Sh. Sh.

Aktvendimi i shkallës së parë

Shembulli 1.

Aktvendimi mbi refuzimin e kërkesës



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. ____/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren N.N dhe me procesmbajtësen N. B., në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit X. X. në _____, te cilin me autorizim e përfaqëson, _____, kundër të paditurit-kundërpropozuesit Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të anulimit të vendimit me propozim për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, jashtë seancës, më datë _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET kërkesa e paditësit-propozuesit X. X. në _____, me të cilën ka kërkuar që të shtyhet ekzekutimi i vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. A _____, i datës _____, derisa të merret vendimi i plotëfuqishëm gjyqësorë sipas padisë së ushtruar në Gjykatë, lidhur me këtë çështje, **si e pabazuar**.

A r s y e t i m

Paditësi-propozuesi X. X. në _____, përmes të autorizuarit të tijë, ka ushtruar kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit me nr. A _____, i datës _____, kundër paditurit-kundërpropozuesit Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, derisa të merret vendim i plotëfuqishëm nga gjykata lidhur me këtë çështje juridike.

Me nenin 22 par. 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) është e përcaktuar se: me kërkesën e paditësit, organi akti i të cilit ekzekutohet përkatësisht organi kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në marrjen e vendimit definitiv gjyqësorë, nëse ekzekutimi do të sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do të sillte ndonjë dëm të madhë palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Me paragrafin 6 të këtij neni parshikohet se paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësorë, sipas kushteve të parapara në par. 2 të këtij neni.

Gjykata pas shqyrtimit të kërkesës së paditësit-propozuesit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, pretendimeve të propozuesit në kërkesë vlerësoi se: propozuesi nuk e ka bërë të besueshme me asgjë dhe me asnjë provë, faktin se ekzekutimi i vendimit me nr. A _____, i datës _____, do të mund ti shkaktonte ndonjë dëm të pariparueshëm, e i cili do të mund të rikuperohej me vështërsi, andaj nga e gjithë kjo vlerëson se kërkesa e paditësit- propozuesit është e **pa bazuar**.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 22.7 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____ /17, më datë _____

Gjyqtarja:

N.N.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.

Shembulli 2.

Aktvendim mbi aprovimin e kërkesës



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.177/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEPARTAMENTI PËR ÇËSHITJE ADMINISTRATIVE, me gjyqtaren, N.N, në konfliktin administrativ të paditësit–propozuesit, A. T., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, jashtë seancës gjyqësore më dt. _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET propozimi i paditësit–propozuesit, A. T., me seli në Prishtinë, dhe **SHTYHET** ekzekutimi i Vendimit, Nr. _____, i dt. _____, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, deri në vendosje lidhur me padinë e paditësit.

A r s y e t i m

Paditësi, A.T., me seli në Prishtinë, ka ushtruar padi më dt. _____, për anulimin e vendimit nr. _____, i dt. _____, me kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të të njëjtit, dhe të mbetet në fuqi vendimi i organit të shkallës së parë me nr. ____ të datës _____, i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave të _____.

Për të vlerësuar propozimin e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, gjykata iu referua nenit 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ku përcaktohet se “ me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyj ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do ti sillte dëm paditësit i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar”.

Me paragrafin 6 të Nenit 22 përcaktohet se “ paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit, deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni “.

Në rastin konkret gjykata gjen se me vendimin e kontestuar, _____, i dt. _____, i padituri e ka aprovuar ankesën e parashtrueses I. A. të datës _____, dhe e ka shfuqizuar vendimin me nr. protokollit _____, të datës _____, të organit të shkallës së parë, si dhe me të njëjtin vendim e ka anuluar procedurën e rekrutimit me nr. reference INS _____, sipas konkursit të shpallur të datës _____, për pozitën _____, si dhe të gjitha vendimet që rrjedhin nga kjo procedurë.

I pa kënaqur me këtë vendim paditësi në afat ligjorë ka ushtruar padi në Gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit si dhe duke kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, mbi bazën e asaj se vendimi i kontestuar me zbatimin e tij do të sillte dëme të riparueshëm, për punëtorët e pranuar, si dhe institucionit shpenzime të panevojshme për ri-shpalljen e konkursit, bazuar në vendimin i cili është jo ligjorë, derisa gjykata të bënë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit kontestues, respektivisht deri sa gjykatë të vendos sipas padisë së ushtruar kundër këtij vendimi.

Gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore, të përmendura më lartë e të cilat e rregullojnë çështjen e shtyrjes së ekzekutimit të vendimit, ka vlerësuar propozimin e paditësit-propozuesesit, për shtyrje të ekzekutimit të vendimit të datës _____, dhe ka konstatuar se i njëjti, e ka bërë të besueshëm pretendimin e tij, se me ekzekutimin e vendimit të goditur me padi, të njëjtit do t'i sillte dëm, si dhe tw punesuareve tjer, të punësuar me anë të këtij konkursi e të cilët marrin pagë mujore nga paditësi, i cili dëmë vështirë do të riparohej.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit ka marrë parasysh edhe faktin se shtyerja e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, nuk është në kundërshtim me interesin publik, kusht ky ligjor, i cili duhet të provohet nga paditësi-propozuesi, për të shtyer pastaj gjykata ekzekutimin e vendimit të kërkuar.

Ky vendim nuk e prejudikon vendosjen në mënyrë meritore të padisë.

Prandaj, gjykata duke u bazuar në të lartcekurat konform Nenit 22 par. 6 dhe 7 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/18 e dt. _____

Gj y q t a r j a,
N.N.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa brenda Afatit prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

Shembulli 3.

Aktvendim mbi hudhjen e kërkesës



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.nr. _____/16

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren N.N dhe me procesmbajtësen N. B., në konfliktin administrativ të paditësve-propozuesve F. B. etj. banor të ndërtesës të cilët i përfaqëson L. B. nga Prishtina rr. _____, kundër të paditurit-kundërpropozuesit X. X., me seli në Prishtinë, lidhur me propozimin për masë të përkohshme të sigurisë, jashtë seancës gjyqësore, më datë _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë propozimi i paditësve - propozuesve F. B. etj. banor të ndërtesës e cila gjendet në Prishtinë, Lagja _____, i paraqitur kundër të paditurit-kundërpropozuesit X.X., me të cilin kanë kërkuar ti ndalohej kundërshtarit të sigurimit, që të bëjë faturimin e pabazuar, me çmim të rritur 1400% përkatësisht të kthejë faturimin siç ishte në muajin janar të vitit 2016 deri në vendosjen, e kësaj çështje me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës, **si i palejuar**.

A r s y e t i m i

Paditësit-propozuesit F. B. etj., banor të ndërtesës të cilët i përfaqëson _____, nga Prishtina, më datë _____, kanë ushtruar padi, për anulimin e vendimit së bashku me propozimin për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë ndaj kundër propozuesit X.X., me të cilin kanë kërkuar ti ndalohej kundërshtarit të sigurimit, që të bëjë faturimin e pabazuar, me çmim të rritur 1400% përkatësisht të kthejë faturimin siç ishte në muajin janar të vitit 2016 deri në vendosjen, e kësaj çështje me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës.

Gjykata, pasi e shqyrtoi lejueshmërinë e propozimit të parashtruar, dhe pas shqyrtimit të së njëjtës dhe shkrësave tjera të lëndës konstatoi se: Propozimi i paditësve-propozuesve, për lëshimin e masës së përkohshme të sigurisë është i palejuar.

Me nenin 22 par. 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) është e përcaktuar se: me kërkesën e paditësit (propozuesit), organi akti i të cilit ekzekutohet përkatësisht

organi kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin e një vendimi deri në marrjen e vendimit definitiv gjyqësorë, nëse ekzekutimi do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm të madhë palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Me paragrafin 6 të këtij neni parshikohet se paditësi mund të kërkojë edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësorë, sipas kushteve të parapara në par. 2 të këtij neni.

Andaj duke u bazuar në dispozitën e nenit 22 të LKA-së, gjykata në konfliktin administrativ nuk mund të shqyrtojë kërkesat për masë të përkohshme të sigurisë përpos të atyre për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit përfundimtar të organit në procedurë administrative, e i cili vendim domosdo duhet të kërkohet të anulohet me padi, çka do të thotë se propozimi i propozuesve të sigurimit në këtë procedurë të konfliktit administrativë është i palejuar (ngase gëzon mbrojtje juridike jashtë konfliktit administrativ-në procedurë kontestimore e rregulluar me dispozitat e LPK-së).

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 22 të LKA, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

A.nr. _____/16 të datës _____

**Gjyqtari,
N.N.**

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktvendimi në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.

Ankesa kundër aktvendimit

A.nr. _____

GJYKATËS SË APELIT NË PRISHTINË DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

Përmes

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË DEPARTAMENTIT PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE

Paditësi: Sh. Sh. nga Prishtina, rruga “Nënë Tereza” pn.

E paditura: Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në Prishtinë

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 23 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative brenda afatit ligjor paraqes këtë

ANKESË

Kundër Aktvendimit A.nr. _____, të datës _____, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.

Për shkak të:

- Shkeljeve thelbësore të procedurës;
- Shkelje të ligjit material dhe
- vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.

A R S Y E T I M

Përmbledhje e fakteve:

Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktvendimin A.nr. _____ të datës _____, ka refuzuar kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, me arsyetim se paditësi me asnjë provë nuk e ka bërë të besueshme pretendimin e tij se pezullimi i ekzekutimit të vendimit të cilin e kërkon, nuk është me interes publik, kusht ky ligjor për shtyrjen e ekzekutimit i cili duhet të provohet nga paditësi.

Gjykata e shkallës së parë me këtë vendim e ka refuzuar kërkesën e paditësit, duke mos marr parasysh asnjë prej pretendimeve të paditësit se me ekzekutimit e vendimit të

datës _____, të KGJK-së për shuarjen e pozitës _____, paditësit do ti shkaktohet shkelja e të drejtës elementare për punë pra shuarja e vendit të punës dhe dëm i riparueshëm në aspektin profesional dhe materiale.

E paditura me vendimin nr. _____ të datës _____, ka bërë shkelje të dispozitave të ligjit për shërbimin civil të Kosovës, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji duke e refuzuar ankesën time dhe duke lënë në fuqi vendimin nr. _____, të datës _____.

Mos përfshirja ime në listën e nëpunësve në KGJK, dhe transferimi im në _____, është i kundërligjshëm pasi që un si punëtor i KGJK-së nuk kam dhënë pëlqimin për transfer, po ashtu nuk jam i informuar se bazuar në cilin nen të Rregullores është vendosur transferimi. Gjatë gjithë procesit të transferimit nuk jam ftuar asnjëherë në takim dhe të më informojnë për të gjithë procesin e aq më pak që të marr pëlqimin tim për transferim nga _____.

Ky veprim është në kundërshtim me nenin 8 dhe nenin 9 paragrafi 1 të Rregullores nr.06/2010 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Duke marr parasysh të gjitha arsyetimet dhe dëshmitë që tregojnë se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në KGJK ka vepruar në kundërshtim me ligjin me rastin e përjashtimit tim nga e drejta e ushtrimit të punës në KGJK, dhe duke marr parasysh të gjitha shkeljet e cekura me larë që e kanë shoqëruar këtë procedurë të transferimit të nëpunësve të ZPD-së në kuadër të KGJK-së, duke u bazuar në provat e bashkangjitura dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të aplikueshme, paditësi i propozon Gjykatës që pas shqyrtimit të të gjitha provave veç e veç dhe të gjithave së bashku, të merr:

AKTVENDIM

APROVOHET si e bazuar ankesa e paditësit Sh. Sh.

ANULOHET Aktvendimi A.nr. _____, i datës _____, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje administrative.

APROVOHET kërkesa e paditësit dhe shtyhet ekzekutimi i Vendimit nr. _____, i datës _____, si dhe obligohet e paditura për pezullimin e të gjitha procedurave për plotësimin/shuarjen e pozitës _____, deri në vendosjen meritore sipas padisë.

Prishtinë, datë _____

Paditësit, Sh. Sh.

Aktvendimi i shkallës së dytë - Gjykata e Apelit

Shembulli 1.

Aktvendimi me të cilin refuzohet ankesa



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr. ____/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: N.N kryetar, V.V dhe S.S., anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit-propozuesit “B. C”, me seli në Prizren, kundër të paditurës, Administrata Tatimore e Kosovës, me bazë juridike, anulim i vendimit, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.____/2019 të datës _____, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditurës-kundër propozueses Administrata Tatimore e Kosovës, e datës _____, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.____/2019, i datës _____, **vërtetohet.**

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, është aprovuar propozimi i paditësit-propozuesit “B. C”, me seli në Prizren, për caktimin e masës së përkohshme-pezuallimin e ekzekutimit të vendimit të paditurës ATK nr.____/18, i dt._____, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të procesit gjyqësor, sipas padisë së paditësit, të ushtruar në Gjykatë me datë _____ dhe shtyhet ekzekutimi i vendimit i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, nr.____/18, i dt._____, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të procesit gjyqësor, sipas padisë së paditësit, të ushtruar në Gjykatë me datë _____.

Kundër këtij aktvendimi ka ushtruar ankesë e paditura, me të cilën e ka kundërshtuar Aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të

plotë të gjenjdes faktike dhe zbatimit të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe aktvendimi i ankimuar të anulohet i pa bazë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar, e ka aprovuar kërkesën e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, me arsyetimin se paditësi nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e ka bërë të besueshme kërkesën e tij, se ekzekutimi i vendimit të goditur me padi do t'i sjellë dëm, i cili dëm vështir do të riparohej dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit, nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës së kundërt. Në këtë kuptim gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet nga neni 22.6, i Ligjit për Konfliktin Administrativ, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues. Gjykata ka shqyrtuar shkresat e lëndës bazën ligjore pretendimet e paditësit dhe të paditurës si dhe rekomandimet e Gjykatës Supreme dhe konstaton se në bazë të Ligjit TVSH-në nr.05/L-037, “1. *Personat e obliguar për të paguar TVSH, janë: 1.1. çdo person i tatueshëm që ofron furnizim të tatueshëm të mallrave ose shërbimeve, me përjashtim kur TVSH-ja duhet të paguhet nga personi tjetër, si në rastet e referuara në nën-paragrafët 1.2 dhe 1.3 të këtij paragrafi*”. Në bazë të faturave të lëshuara nga personi i tatueshëm për personin e tatueshëm duhet të jetë në përputhje me nenin 45 të Ligjit Nr.05/L-037 për TVSH. Sipas skemës së veçantë, furnizuesi edhe pse nuk është i obliguar të paguaj TVSH-në ai është i obliguar të lëshoj faturë tatimore. Furnizuesi duhet të cekë në faturë se pranuesi i shërbimit është i obliguar të paguaj TVSH-në duke e vendosur referencën e nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 të Ligjit apo ndonjë referencë tjetër që tregon se furnizimi i nënshtrohet procedurës së ngarkesës së kundërt. Atëherë në bazë të argumenteve ligjore dhe të provave shihet se punë kryerësi nuk i ka lëshuar faturat me referencën ligjore ashtu siç parashihet me ligje dhe po ashtu të lëshuara me TVSH i ka paguar me transaksion bankare duke përfshirë edhe TVSH. Propozuesi në kërkesën për caktimin e masës së përkohshme, ka dëshmuar me prova se pranuesi i shërbimit në këtë rast nga furnizuesi i shërbimit nuk janë lëshuar faturat në bazë të nenit 52 të Ligjit të TVSH-së, dhe si pasojë e kësaj paditësi nuk ka pas njohuri mbi ngarkesën e kundërt, rrjedhimisht ka ofruar fakte dhe dëshmi se ekziston mundësia e shkaktimit të dëmeve apo humbjeve të tilla, përkatësisht për cilat arsye caktimi i masës së përkohshme është i domosdoshëm dhe se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i riparueshëm.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë juridik të gjykatës së shkallës së parë, nga

se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Në rastin konkret propozuesi-paditësi me padi ka kërkuar shtyrjen ekzekutimit të vendimit të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, nr.____/18, i dt._____, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të procesit gjyqësor, me arsyetim se me ekzekutimin e vendimit të kontestuar propozuesit, do t'i sillte dëm të konsiderueshëm dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik e as nuk i shkakton dëme palës kundërshtare dhe personave të interesuar.

Kolegji i Apelit, njëjtë si gjykata e shkallës së parë, vlerëson se paditësi ka dëshmuar me prova se pranuesi i shërbimit në këtë rast nga furnizuesi i shërbimit nuk janë lëshuar faturat në bazë të nenit 52 të Ligjit të TVSH-së, dhe si pasojë e kësaj paditësi nuk ka pas njohuri mbi ngarkesën e kundërt, rrjedhimisht ka ofruar fakte dhe dëshmi se ekziston mundësia e shkaktimit të dëmeve apo humbjeve të tilla, përkatësisht për cilat arsye shtyrja e ekzekutimit të vendimit është i domosdoshëm dhe se është përmbushur kushti i rrezikut serioz dhe dëmi i riparueshëm, e që shtyrja nuk do t'i sillte dëm të madh palës kundërshtare, përkatësisht personit të interesuar.

Pretendimet ankimore të palës së paditur, të cekura si më lartë, dhe të shtjelluara si në arsyetim të ankesës për shkeljet e pretenduara nga gjykata e shkallës së parë, kolegji i vlerëson se janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për vendosjen e kësaj çështje në mënyrë tjetër, sepse nuk dëshmohet se aktvendimi i goditur është i nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, siç pretendon e paditura në ankesë. Ngase edhe vlerësimi i kolegjit është se janë përmbushur kushtet ligjore për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të ankimuar, siç parashihet në nenin 22 par.2 të LKA-së.

Mbi këtë gjendje të fakteve kolegji gjen se Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, në mënyrë të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e aprovimit të kërkesës së paditësit, me të cilën ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, dhe se nuk është cenuar ligji në dëm të ankuesit me rastin e aprovimit të propozimit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar. Meqë në këtë rast e paditura në ankesën e ushtruar nuk ka bërë të besueshme me asnjë provë pretendimet e saj. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate aktvendimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Andaj,

ankesa si e tillë refuzohet, ndërsa aktvendimi i ankimuar vërtetohet si i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELT E KOSOVËS NË PRISHTINË

AA.nr. _____/2019, me datë _____

**Kryetar i Kolegjit,
N. N.**

Shembulli 2.

Aktvendimi me të cilin aprovohet ankesa dhe priset aktvendimi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.____/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: U.U, kryetar, K. K. dhe G. G., anëtarë, në konfliktin administrativ sipas paditësit-propozuesit "S. T." me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson _____, avokat në Prishtinë, kundër të paditurit-kundër propozuesit, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, në Prishtinë, me bazë juridike anulimin e vendimit me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit-kundër propozuesit dhe ankesën e palës së interesuar _____, Sh.p.k., me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson _____, avokat në Prishtinë, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.____/2019, të datës _____, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

Aprovohen si të bazuara, ankesa e të paditurit-kundër propozuesit Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, e datës _____, dhe ankesa e palës së interesuar _____, Sh.p.k., me seli në Prishtinë. **Anullohet** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative A.nr.____/2019, i datës _____, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m i

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.____/2019, të datës _____, është aprovuar si e bazuar kërkesa e paditësit, "S. T.", e dt. _____ dhe shtyhet ekzekutimi i vendimit të paditurit, Ministria e Infrastrukturës në Prishtinë, numër _____, i dt. _____, deri në marrjen e aktgjykimit lidhur me kërkesëpadinë e paditësit.

Kundër këtij Aktvendimi ankesë kanë ushtruar e paditura Ministria e Infrastrukturës dhe pala e interesuar _____ Sh.p.k.

E paditura me ankesën e datës _____, ka kontestuar ligjshmërinë e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë për shkak të; shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Gjykata e Apelit të ndryshoj Aktgjykimin A.nr._____/19, të dt._____, të refuzoj në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit dhe mbetet në fuqi vendimi i të paditurës.

Pala e interesuar me ankesën e datës _____, e ka kontestuar ligjshmërinë e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë për shkak të shkeljes së dispozitave kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa e ndërhyrësit _____Sh.p.k., dhe të refuzohet kërkesa e paditësit "S. T."për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të të paditurës nr.____ i dt._____, ose prishet aktvendimi i Gjykatës Themelore ne Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr_____/2019 i dt._____, dhe çështjen juridike ta kthen në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA -së, lidhur me nenin 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për konfliktin administrativ (LKA), ka gjetur se:

Ankesat janë të **bazuara**.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar, e ka aprovuar kërkesën e paditësit-propozuesit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, me arsyetimin se paditësi nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e ka bërë të besueshme kërkesën e tij, se ekzekutimi i vendimit të goditur me padi do t'i sjellë dëm, i cili dëm vështirë do të riparohej dhe se shtyrja e ekzekutimit të vendimit, nuk është në kundërshtim me interesin publik dhe as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës së kundërt. Ngase e paditura pa u plotësuar kërkesat nga neni 17,18 dhe 19 të Udhëzimit Administrativ për Rrjetin e Linjave dhe Rendin e Udhëtimit në Transportin Ndërrurban të Udhëtarëve me Autobus, i ka bërë paditësit pezullimin e rendit të udhëtimit nr. _____, Në këtë kuptim gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet nga neni 22.6, i Ligjit për Konfliktin Administrativ, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, nuk mund ti përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me të metat thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me*

vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit". Gjykata e shkallës së parë nuk ka marr për bazë aktgjykimin AA.nr._____/2018, të datës _____, të Gjykatës së Apelit, me të cilin është aprovuar kërkesëpadia e palës së interesuar _____ Sh.p.k., Prishtinë, dhe është anuluar vendimi i të paditurës Ministria e Infrastrukturës nr._____, i datës _____, dhe e njëjta obligohet që paditësit ti kthen në disponim dhe shfrytëzim të lirë linjat e autobusit në relacionin Prishtinë -Prizren dhe anasjelltas, me fillim të nisjes nga Prishtina në orën _____, dhe kthimin në ora _____, ashtu si e ka shfrytëzuar deri me datë _____. Gjykata e shkallës së parë duke ju referuar nenit 22 par.2 të LKA se ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara në nenin e 22.2, konstatimi i Gjykatës sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit është i pa bazuar, për arsye se e njëjta nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme se me mos caktimin e masës së sigurimit palës së interesuar do të mund ti sillte dëm.

Gjykata e Apelit vlerëson se, gjykata e shkallës së parë në rastin konkret nuk i ka shqyrtuar provat të cilat i ka pasur në dispozicion e sidomos aktgjykimin e Gjykatës së Apelit AA.nr._____/2018, të datës _____, i cili e ka marr formën e prerë, e si rezultat i të cilit është nxjerr vendimi i të paditurës numër _____, i dt._____, me të cilin është pezulluar rendi i udhëtimit Nr._____, në emër të operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve NTSH "S. T." në relacionin Prishtinë - Prizren dhe anasjelltas me kohë të nisjes _____ nga Prishtina dhe kthimit nga Prizreni në ora _____.

Kolegji i kësaj gjykate vëren se, në rastin konkret paditësi me propozim ka kërkuar shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues me nr. _____, të datës _____, me të cilin është pezulluar rendi i udhëtimit Nr._____, në emër të operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve NTSH "S. T."në relacion Prishtinë –Prizren dhe anasjelltas me kohë të nisjes _____, nga Prishtina dhe kthimit nga Prizreni në ora _____, bazuar në nenin 17 par.8 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin rrugor nenin 5 të Udhëzimit Administrativ nr.06/2016 për Ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.09/2013 për Rrjetin e Linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër urban të udhëtarëve me autobus, nenit 85 të Ligjit 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e ankimuar e ka shtyrë ekzekutimin e vendimit kontestues duke u bazuar në nenin 22 të LKA-së, i cili nen flet për kushtet ligjore të kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, për të cilën arsye aktvendimi i ankimuar për shkak të parregullsive që ka nuk mund të ekzaminohet,

me që dispozitivi i aktvendimit është kontradiktor me vetveten dhe me arsyetim e tij, arsyet dhe faktet vendimtare, mungojnë dhe të njëjtat nuk paraqiten as me prova në shkresat e lëndës, andaj citimi i vetëm i dispozitës ligjore në arsyetim të vendimit të ankimuar, është i pa qëndrueshëm sepse, në mungesë të provave dhe fakteve dhe administrimit e arsyetimit të tyre e të cilat do të duhej të ishin në shkresat e lëndës, si kushte ligjore për aprovimin e kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, nuk mund të bëhet fare vlerësimi i kërkesës për shtyrje, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar kërkesën duke mos dhënë asnjë arsye, si në arsyetim të vendimit të ankimuar, e që arsyetimi i tillë është kundërthënës në raport me gjendjen e vërtetuar në shkresat të lëndës.

Arsyetimi i aktvendimit të ankimuar, sipas kolegjit të kësaj gjykate, është i mangët dhe mos vlerësimi i fakteve vendimtare, siç është mundësia e shkaktimit të dëmit të pariparueshëm apo në kundërshtim me interesin shoqëror, shihet qartë edhe nga arsyetimi i këtij aktvendimi e të cilat nuk kanë mundur të arsyetohen fare, e që e gjithë kjo bie në përfundim se gjykata e shkallës së parë, me rastin e vlerësimit të propozimit të paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, nuk ka mundur ti vlerësoj fare faktet dhe provat sepse të njëjtat nuk janë paraqitur me propozim, e duke e bërë këtë gjithashtu nuk e ka pasur mundësin të vërtetoj gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejt, siç e parasheh dispozita e nenit 22 par. 2 e LKA-së.

Në vazhdim të procedurës me rastin e rivendosjes, gjykata e shkallës së parë, bazuar në dispozitën e nenit 22. par. 2, duke e obliguar paditësin që gjykatës ti prezantoj provat apo faktet e bindshme se me ekzekutimin e vendimit kontestues do ti shkaktohet dëmi i pariparueshëm apo ekzekutimi i të njëjtit është në dëm të interesit shoqërorë, dhe pas përmbushjes së këtij kushti ligjor, duhet të vlerësoj rëndësinë dhe dëmin që mund të shkaktohet me ekzekutimin e vendimit kontestues, gjithnjë sipas dispozitës se nenit 22 par. 2 të LKA-së.

Pas vlerësimit të fakteve të paraqitura, pas përmbushjes së obligimit ligjor konform dispozitës së cekur më lartë, gjykata në bazë të provave të paraqitura të administruara dhe të vlerësuar nga palët ndërgjyqëse, duhet të vlerësojë kërkesën e propozuesit lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të vendimit si dhe kundërshtimin e palës së interesuar dhe të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj, i cili do të përmbajë arsyetimin lidhur me vendimin e marrë dhe sqarimin me hollësi se cilat nga pretendimet e paditësit janë bazuar në cilat prova e të cilat e bëjnë të ditur shkaktimin e dëmit dhe plotësimin e kushtit ligjor konform nenit përkatës, e jo vetëm citimin e dispozitave ligjore siç ka vepruar në aktvendimin e ankimuar.

Për shkak të shkeljeve esenciale, qëndrimin të gabuar juridik dhe mos arsyetimit të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë, ka lëshuar të vërtetoi faktet qenësore për zbatimin e dispozitës së nenit 22 par.2 të LKA-së, për çka ankesa

është dashtë që të aprovohet e të priset aktvendimi dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në procedurë të rigjykimit dhe rivendosjes.

Nga sa u tha më lart e në bazë të nenit 43 par.2 dhe nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 209 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELT E KOSOVËS - PRISHTINË

AA.nr. _____/2019, me datë _____

**Kryetar i kolegjit,
U.U.**

Shembulli 3.

Aktvendimi me të cilin aprovohet ankesa dhe ndryshohet aktvendimi



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr. ____/2019

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: D.D, kryetare, S. K. dhe G. T., anëtarë, në konfliktin administrativ sipas propozuesit - paditësit NTSH A. K.me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në Prishtinë, me bazë juridike anulimin e vendimit, me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr._____/2019, të datës _____, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë _____, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. Aprovohet** si e bazuar ankesa e paditësit-propozuesit NTSH A. K., me seli në Prishtinë, e ushtruar më datë _____.
- II. Ndryshohet** Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal A.nr._____/2019, i datës _____.
- III. Aprovohet** propozimi i paditësit – propozuesit NTSH A. K.me seli në Prishtinë, **Shtyhet** ekzekutimi i vendimit të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë ___/19 i dt._____, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor sipas padisë së ushtruar.

A r s y e t i m i

Me Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, është refuzuar propozimi i paditësit-propozuesit NTSH A. K., me seli në Prishtinë, për caktimin e masës së përkohshme-pezuillimin e ekzekutimit të vendimit të paditurës ATK nr.____/19 i datës _____, deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të procesit gjyqësor, sipas padisë së paditësit, të ushtruar në gjykatë me datë _____.

Kundër këtij Aktvendimi ka ushtruar ankesë paditësi-propozuesi, përmes përfaqësuesit të tij, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ta prish aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe të miratojë kërkesën e paditësit për masë të përkohshme dhe pezullohet ekzekutimi i akteve administrative që janë objekt i padisë.

Gjykata e Apeli e Kosovës, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konflike Administrative, (LKA), neni 81.H të Ligjit nr.04/L-102, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat nr.03/L-222, dhe neni 194 të LPK-së, ligj i aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e **bazuar**.

Duke shqyrtuar shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar sipas ankesës së propozuesit-paditësit, kolegji i kësaj gjykate, gjen se paditësi ka ushtruar padi në gjykatën e shkallës së parë më datë _____, kundër vendimit nr.____/19 të datës _____, të ATK-së, dhe raportit të kontrollit të datës _____.

Ndërsa me parashtresën e datës _____, paditësi i ka propozuar gjykatës caktimin e masës së përkohshme të pezullohet vendimi i të paditurës nr.____/19 i dt._____, deri në vendosjen e çështjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin nr._____/2019 të datës _____, e ka refuzuar kërkesën e paditësit-propozuesit për caktimin e masës së përkohshme, me arsyetimin se e njëjta nuk e ka bërë të besueshme me asnjë provë konkrete se ekzekutimi i vendimit kontestues, do të mund të shkakton ndonjë dëm të riparueshëm e i cili do të mund të rikuperohej me vështirësi siç e parasheh neni 22 par. 2 i LKA-së. Gjykata nuk ka vërejtur asnjë fakt të vetëm me të cilën do të arsyetohej shtyrja e ekzekutimit të vendimit.

Sipas kolegjit të kësaj gjykate, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, nuk mund ti përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me të metat thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) të zbatuara drejtë për drejtë sipas nenit 63 të LKA-së, e cila përcakton se: “në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të

vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”. Në rastin konkret paditësi-propozuesi, me propozim ka kërkuar që pezullohet ekzekutimi i vendimit të paditurës nr.____/19, për shkak të shkaktimit të dëmit të pa riparueshëm, deri në vendosjen e çështjes me vendim të plotfuqishëm gjyqësor, ndërsa gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar, në arsyetimin e të njëjtit në kundërshtim me dispozitën ligjore të cekur më lartë, ka vendosur për refuzimin shtyrjes së ekzekutimit të vendimit, duke u bazuar në nenin 22 të LKA-së, i cili nen flet për kushtet ligjore të kërkesës për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, për të cilën arsye aktvendimi i ankimuar për shkak të parregullsive që ka nuk mund të ekzaminohet, meqë dispozitivi i aktvendimit është kontradiktor me vetveten dhe me arsyetim e tij, arsyet dhe faktet vendimtare nuk janë vlerësuar fare dhe ato arsyetime që janë bërë në përshkrimin e arsyetimit janë të paqarta dhe kundërthënëse.

Gjithashtu kolegji i kësaj gjykate, vlerëson se gjykata e shkallës së parë me rastin e vërtetimit të gjendjes faktike nuk ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë siç e parasheh dispozita e nenit 183 e LPK-së, e aplikueshme sipas nenit 63 të LKA.

Kolegji i kësaj gjykate, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, nuk mund ti përkrah si të rregullta dhe të ligjshme për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë edhe me të meta juridike për shkak të qëndrim të gabuar juridik të gjykatës së shkallës së parë, të parapara me nenin 183, respektivisht 183.1 ku përcaktohet se: *“Ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare”*. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë, e ka vlerësuar në mënyrë të gabuar faktin se me mos shtyrjen e ekzekutimit të vendimit kontestues, paditësit-propozuesit nuk mund ti shkaktohet dëm i riparueshëm e gjithashtu gabimisht e ka vlerësuar edhe faktin se shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, pa e marrë parasysh dëmin i cili mund ti shkaktohet shoqërisë në përgjithësi.

Gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar faktet të cilat janë të shumta lidhur me këtë çështje e të cilat do të ndikonin direkt në shkaktimin e dëmit të riparueshëm të paditësit-propozuesit e aq më pak nuk e ka vlerësuar dëmin i cili mund ti shkaktohet shoqërisë në përgjithësi, e të cilat do të ndikonin direkt në rrezikimin e falimentimit të NTSH _____, gjithashtu gjykata e shkallës së parë në vendimin e saj nuk e ka pasur parasysh rrezikun se punëtorët të cilët janë duke punuar te tani paditësit, rrezikojnë të mbesin pa punë në rast të falimentimit të kësaj kompanie, dhe në rast se do të falimentonte kjo kompani dhe do të mbetnin pa punë këta punëtorë do të shkaktohej një dëm i përgjithshëm i pa riparueshëm, kur dihet se të njëjtët janë mbajtës të familjeve të tyre, andaj gjykata e apelit vlerësoi se rreziku ekziston për arsyet e lartcekura dhe paditësi nuk duhet të obligohet në pagesën e shumës prej _____ euro, deri në marrjen e vendimit meritator nga ana e gjykatës.

Gjykata e apelit vlerësoi se me aprovimin e shtyrjes se ekzekutimit të vendimit të ushtruar nga ana e paditësit nuk do ta dëmtonte tani të paditurën, por për kundër kësaj do të eliminonte rrezikun që kompania e menaxhuar nga paditësi mos të falimentoj dhe mos të rrezikohen punëtorët që të mbesin pa punë. E paditura duhet të presë nga ana gjykatës vendimin meritore në këtë çështje, në mënyrë që nga e njëjta të vërtetohet se vendimi i nxjerrë nga e paditura a është i ligjshëm dhe i drejtë.

Aktvendimi i Gjykatës së Apelit për aprovimin e propozimit për shtyrje të ekzekutimit të vendimit nuk e prejudikon çështjen kryesore, por ka të bëjë vetëm sa i përket ndalimit të shkaktimit të dëmit tani për tani për paditësin, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Andaj kolegji i kësaj gjykate, duke i marrë parasysh pretendimet e paraqitura me propozim si dhe të tjerat të cilat gjenden në padi dhe në shkresat e lëndës, në përputhje me nenin 49 të LKA-së, lidhur me nenin 209 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Ky vendim nuk e prejudikon vendosjen në mënyrë meritore të padisë.

GJYKATA E APELT E KOSOVËS - PRISHTINË

AA.nr. _____/2019, më datë _____

**Kryetar i kolegjit,
D.D.**

Në bazë të LPK-së, neni 310, i zbatueshëm drejtë për së drejti në bazë të nenit 63 të LKA-së, çështja e ankesës kundër masës së sigurimit në shkallë të dytë është e rregulluar me këtë nen, ndërsa decidivisht me par. 5 të këtij neni është përcaktuar se “Kundër aktvendimit mbi masën e përkohshme nuk lejohet ankimi.” I cili nen vlenë drejtë për drejtë edhe me rastin e kërkesës për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit (masës së sigurisë) në konfliktin administrative.

Përfundimi

Me Ligjin për Gjykatat Nr. 06/L-054 dhe Ligjin Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, dhe sipas strukturës organizative të gjykatave të Kosovës, Departamenti për Çështje Administrative që vepron në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe ka juridiksion për gjithë territorin e Republikës së Kosovës.

Akt administrativ është çdo vendim i ndonjë administrate publike, qeverie qendrore dhe lokale dhe organi tjetër që është rezultat i një procedure administrative mbi ushtrimin e autorizimeve publike. Gjykata vendos lidhur me ligjshmërinë e akteve administrative përfundimtare në procedure administrative.

Çdo person fizik ose juridik mund ta fillojë një konflikt administrative në Gjykatë. Konflikti administrativ mund të fillohet:

- kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurë administrative në shkallë të dytë;
- kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar; dhe
- kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, sipas kushteve të Ligjit mbi Konfliktet Administrative.

Të gjitha çështjet në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe.

Në kuadër të këtij Departamenti funksionon edhe Divizioni Fiskal, që ka kompetencë të gjykoj të gjitha paditë të ushtruara kundër vendimeve përfundimtare të Administratës tatimore dhe Doganave dhe administratës komunale lidhur me taksat, detyrimet tatimore dhe doganore dhe çdo kontribut tjetër të caktuar nga legjislacioni në fuqi.

Departamenti për Çështje Administrative funksionon edhe në shkallë të dytë dhe vepron në kuadër të Kolegjit të përbërë prej tre gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit, dhe vendos për ankesat e ushtruara kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa me mjete të jashtëzakonshme vendos kolegji i përberë prej tre gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të Kosovës.